

32004L0017

**Direktiva 2004/17/KE e Parlamentit Europian dhe e Këshillit, datë 31 mars 2004, për koordinimin e procedurave të prokurimit të subjekteve që ushtrojnë aktivitet në sektorët ujor, energjetik, të transportit dhe postar**

*Gazeta Zyrtare L 134 , 30/04/2004 fq. 0001 - 0113*

Direktivë 2004/17/KE e Parlamentit Europian dhe e Këshillit datë 31 mars 2004 për koordinimin e procedurave të prokurimit të subjekteve që ushtrojnë aktivitet në sektorët ujor, energjetik, të transportit dhe postar

**PARLAMENTI EUROPIAN DHE KËSHILLI I BASHKIMIT EUROPIAN,**

Duke pasur parasysh Traktatin Themelues të Komunitetit Europian dhe në veçanti nenin 47 pika 2 dhe nenin 55 dhe 95 të tij,

Duke pasur parasysh propozimin e Komisionit [1],

Duke pasur parasysh opinionin e Komitetit Ekonomik dhe Social [2],

Duke pasur parasysh opinionin e Komitetit të Rajoneve [3],

Duke vepruar në përputhje me procedurën e përcaktuar në nenin 251 të Traktatit [4], nisur nga teksti i përbashkët i miratuar nga Komiteti i Pajtimit më 9 dhjetor 2003,

Duke pasur parasysh se:

(1) Me rastin e ndryshimeve të reja që i janë bërë Direktivës së Këshillit 93/38/ KEE, datë 14 qershor 1993, e cila koordinon procedurat e prokurimit të subjekteve që ushtrojnë aktivitet në sektorin ujor, energjetik, të transportit dhe të telekomunikacionit [5], të cilat janë të nevojshme për të përmbushur kërkesat për thjeshtim dhe modernizim, të formuluar si nga subjektet kontraktuese ashtu dhe nga operatorët ekonomikë në kuadër të përgjigjeve të tyre ndaj Librit të Gjelhër të miratuar nga Komisioni më 27 nëntor 1996, direktiva, për hir të qartësisë, duhet të riformulohet. Kjo direktivë bazohet në praktikën gjyqësore të Gjykatës të Drejtësisë, sidomos në praktikën gjyqësore për kriteret e shpalljes së kontratës fituese, e cila qartëson mundësinë që subjektet kontraktuese të plotësojnë nevojat e publikut, duke përfshirë fushën e mjedisit dhe/ose sociale, me kusht që këto kriteret të lidhen me objektin e kontratës, të mos i japin autoritetit kontraktues liri të pakufizuar zgjedhjeje, të përmenden shprehimisht dhe të respektojnë parimet themelore të përmendura në pikën 9 të pjesës hyrëse.

(2) Një nga arsyet kryesore për prezantimin e rregullave për koordinimin e procedurave të shpalljes së kontratave fituese në këta sektorë është larmia e mënyrave me anë të të cilave autoritetet kombëtare mund të ndikojnë tek sjellja e këtyre subjekteve, duke përfshirë pjesëmarrjen në kapitalin e tyre dhe përfaqësimin në organet administrative, drejtuese ose mbikëqyrëse të subjekteve.

(3) Një tjetër arsye pse është e nevojshme të koordinohen procedurat e prokurimit që përdoren nga subjektet që veprojnë në këta sektorë është natyra e mbyllur e tregjeve ku ata veprojnë, për shkak të ekzistencës së të drejtave të veçanta apo ekskluzive që u janë dhënë nga Shtetet Anëtare në lidhje me furnizimin, sigurimin ose funksionimin e rrjeteve për ofrimin e shërbimit në fjalë.

(4) Legjisllacioni komunitar dhe sidomos Rregullorja e Këshillit (KEE) nr. 3975/87, datë 14 dhjetor 1987, e cila përcakton procedurën për zbatimin e rregullave të konkurrencës për sipërmarrjet në sektorin e transportit ajror [6] dhe Rregullorja (KEE) nr. 3976/87, datë 14 dhjetor 1987, për zbatimin e nenit 85 pika 3 të Traktatit për disa kategori të marrëveshjeve dhe praktikave të harmonizuara në

sektorin e transportit ajror [7], është hartuar për të mundësuar më shumë konkurrencë ndërmjet transportuesve që i ofrojnë publikut shërbime të transportit ajror. Prandaj, nuk është e përshtatshme përfshirja e këtyre subjekteve në fushën e veprimit të kësaj direktive. Nisur nga pozita konkurruese e transportit në Komunitet, do të ishte gjithashtu e papërshtatshme që kontratat fituese në këtë sektor t'u nënshtrohen rregullave të kësaj direktive.

(5) Fusha e veprimit e Direktivës 98/38/KEE mbulon, aktualisht, disa kontrata të shpallura fituese nga subjektet kontraktuese që veprojnë në sektorin e telekomunikacionit. Për të hapur këtë sektor është miratuar një kuadër legjislativ, siç përmendet në raportin e katërt, datë 25 nëntor 1998, për zbatimin e rregulloreve të telekomunikacionit. Një nga pasojat e tij ka qenë mundësimi në këtë sektor i konkurrencës së efektshme, si *de jure* ashtu dhe *de facto*. Komisioni, me qëllim informimi dhe nisur nga kjo situatë, ka publikuar një listë të shërbimeve të telekomunikacionit [8] të cilat mund të përjashtohen nga fusha e veprimit të direktivës në fjalë bazuar në nenin 8 të saj. Progres i mëtjeshëm është konfirmuar në raportin e shtatë, datë 26 nëntor 2001, për zbatimin e rregulloreve të telekomunikacionit. Prandaj, nuk është më e nevojshme të rregullohen blerjet nga subjektet që veprojnë në këtë sektor.

(6) Vazhdimësia e Komitetit Këshillues për Prokurimin në sektorin e telekomunikacionit të krijuar me Direktivën e Këshillit 90/531/KEE, datë 17 shtator 1990, për procedurat e prokurimit të subjekteve që veprojnë në sektorin ujor, energjetik, të transportit dhe të telekomunikacionit [9] nuk është më e përshtatshme.

(7) Megjithatë, duhet vazhduar monitorimi i zhvillimeve në sektorin e telekomunikacionit dhe të shihet përsëri situata nëse konstatohet që në këtë sektor nuk ka më konkurrencë të efektshme.

(8) Direktiva 93/38/KEE përjashton nga fusha e saj e veprimit blerjet e telefonisë zanore, teleksit, telefonisë celulare, shërbimin e dërgimit të mesazheve të shkurtra dhe ato satelitore. Këto përjashtime janë bërë për të marrë parasysh faktin që shërbimet në fjalë mund të ofrohen shpesh vetëm nga një ofrues shërbimi në një zonë të caktuar gjeografike për shkak të mungesës së konkurrencës së efektshme dhe ekzistencës së të drejtave të veçanta apo ekskluzive. Futja e konkurrencës së efektshme në sektorin e telekomunikacionit e heq justifikimin për këto përjashtime. Prandaj është e nevojshme të përfshihet prokurimi i këtyre shërbimeve të telekomunikacionit në fushën e veprimit të kësaj direktive.

(9) Për të garantuar hapjen ndaj konkurrencës, të kontratave të prokurimit publik të shpallura fituese nga subjektet që veprojnë në sektorët e shërbimeve ujore, energjetike, të transportit dhe ato postare, këshillohet hartimi i dispozitave për koordinimin komunitar të kontratave mbi një vlerë të caktuar. Ky koordinim bazohet në kërkesat që dalin nga nenet 14, 28 dhe 49 të Traktatit të KE-së dhe nga neni 97 i Traktatit EUROATOM, përkatësisht parimi i trajtimit të barabartë, për të cilin parimi i mosdiskriminimit nuk është më shumë se një shprehje specifike, parimi i njohjes së ndërsjellë, parimi i përpjesëtueshmërisë, si dhe parimi i transparencës. Nisur nga natyra e sektorëve që preken nga ky koordinim, ky i fundit, ndërsa ruhet zbatimi i këtyre parimeve, duhet të krijojë një kuadër për praktikë të qëndrueshme tregtare dhe duhet të lejojë fleksibilitet maksimal.

Për kontratat publike vlera e të cilave është më pak se ajo që kërkon zbatimin e dispozitave të koordinimit komunitar, këshillohet të merret parasysh praktika gjyqësore e Gjykatës së Drejtësisë sipas të cilës zbatohen rregullat dhe parimet e Traktateve të përmendura më sipër.

(10) Për të siguruar hapjen e tregut dhe një ekuilibër të drejtë në zbatimin e rregullave të prokurimit në sektorin e shërbimit ujor, energjetik, të transportit dhe postar është e nevojshme që subjektet e përfshira të identifikohen mbi një bazë që nuk ka të bëjë me statusin e tyre ligjor. Prandaj, duhet siguruar që të mos preket trajtimi i barabartë i subjekteve kontraktuese në sektorin publik dhe atyre që veprojnë në sektorin privat. Gjithashtu është e nevojshme të sigurohet që, në përputhje me nenin 295 të Traktatit, të mos cenohen rregullat për sistemin e të drejtave mbi pronën në Shtetet Anëtare.

(11) Shtetet Anëtare duhet të sigurojnë që pjesëmarrja e një organi që rregullohet nga e drejta publike si ofertues në një procedurë për fitimin e kontratës të mos shkaktojë shtrembërim të konkurrencës kundrejt ofertuesve privatë.

(12) Sipas nenit 6 të Traktatit, kërkesat e mbrojtjes mjedisore duhet të integrohen gjatë hartimit dhe zbatimit të politikave dhe veprimtarive komunitare të përmendura në nenin 3 të Traktatit, në veçanti për të nxitur zhvillim e qëndrueshëm. Prandaj kjo direktivë qartëson sesi mund të kontribuojnë subjektet kontraktuese në mbrojtjen e mjedisit dhe nxitjen e zhvillimit të qëndrueshëm, duke siguruar ndërkohë mundësinë për të marrë vlerën më të mirë monetare për kontratat e tyre.

(13) Asnjë dispozitë e kësaj direktive nuk duhet të pengojë vendosjen ose zbatimin e masave të nevojshme për të mbrojtur moralin publik, politikat publike, sigurinë publike, shëndetin, jetën e njeriut dhe të kafshëve ose ruajtjen e jetës së bimëve sidomos me qëllim arritjen e zhvillimit të qëndrueshëm me kusht që këto masa të jenë në përputhje me Traktatin.

(14) Vendimi i Këshillit 94/800/KE, datë 22 dhjetor 1994, për lidhjen, në emër të Komunitetit European, sa u përket çështjeve brenda kompetencës së tij, e Marrëveshjeve të arritura me negociatat shumëpalëshe të Raundit të Uruguait (1986-1994) [10], miraton në veçanti Marrëveshjen e OBT-së për Prokurimin Publik (quajtur më poshtë “Marrëveshja”), qëllimi i së cilës është të krijojë një kuadër shumëpalësh të të drejtave dhe detyrimeve të ekuilibruara në lidhje me kontratat publike për të arritur liberalizimin dhe zgjerimin e tregtisë botërore. Nga këndvështrimi i të drejtave dhe angazhimeve kombëtare që merr përsipër Komuniteti si rezultat i pranimit të Marrëveshjes, rregullimet që duhet të zbatohen për ofertuesit dhe produktet nga vende të treta nënshkruese janë ato që përcakton Marrëveshja. Marrëveshja nuk ka efekt të drejtpërdrejtë. Subjektet kontraktuese që mbulon Marrëveshja të cilat respektojnë këtë direktivë dhe e zbatojnë këtë të fundit për operatorët ekonomikë të vendeve të treta që janë palë nënshkruese të Marrëveshjes, duhet ta respektojnë Marrëveshjen. Gjithashtu është me vend që kjo direktivë të garantojë për operatorët ekonomikë të Komunitetit kushtet për pjesëmarrje në prokurimin publik, që janë po aq favorizuese sa ato që rezervohen për operatorët ekonomikë të vendeve të treta të cilat janë palë nënshkruese të Marrëveshjes.

(15) Përpara fillimit të një procedure prokurimi, subjektet kontraktuese, me anë të dialogut teknik, mund të kërkojnë ose pranojnë këshilla të cilat mund të përdoren në përgatitjen e specifikimeve, me kusht që këto këshilla të mos pengojnë konkurrencën.

(16) Nisur nga larmia e kontratave për punë subjektet kontraktuese duhet të jenë në gjendje të parashikojnë kontrata për projektim dhe ekzekutim të punëve të cilat lidhen veçmas ose bashkërisht. Kjo direktivë nuk ka për qëllim të përcaktojë kontrata fituese të përbashkëta apo të veçanta. Vendimi për kontratën fituese, veçmas ose bashkërisht, duhet të merret në bazë të kriterëve ekonomike dhe cilësore, që mund të përcaktohen nga legjislacioni kombëtar.

Një kontratë mund të konsiderohet kontratë për punë vetëm nëse objekti i saj mbulon në mënyrë specifike kryerjen e veprimtarive të renditura në Shtojcën XII, dhe nëse kontrata mbulon ofrimin e shërbimeve të tjera të nevojshme për kryerjen e këtyre veprimtarive. Kontratat e shërbimeve, në veçanti në fushën e shërbimeve të administrimit të pronave, në disa rrethana mund të përfshijnë punime. Megjithatë, nëse këto punime janë të rastësishme për objektin parësor të kontratës, dhe janë pasojë e mundshme e tyre ose plotësim i tyre, fakti që këto punime janë përfshirë në kontratë nuk justifikon cilësimin e kontratës si kontratë për punë.

Për të llogaritur vlerën e çmuar të kontratës për punë, duhet që si bazë të merret vlera e vetë punimeve si dhe vlera e çmuar e materialeve dhe shërbimeve, nëse ka, që vihet në dispozicion të sipërmarrësve nga subjektet kontraktuese në masën që këto shërbime a materiale të jenë të nevojshme për ekzekutimin e punimeve në fjalë. Duhet kuptuar që, për qëllim të këtij paragrafi, shërbimet në fjalë janë ato që ofrohen nga subjektet kontraktuese nëpërmjet stafit të tyre. Nga ana tjetër, llogaritja e vlerës së kontratave për shërbime, që duhen vënë apo jo në dispozicion të një sipërmarrësi për ekzekutimin e mëpasshëm të punimeve, ndjek rregullat e zbatueshme për kontratat e shërbimeve.

(17) Me qëllim zbatimin e rregullave procedurale të kësaj direktive dhe monitorimin, fusha e shërbimeve është e kufizuar më mirë, duke i ndarë në nënkategori që u përkojnë zërave të veçantë të një klasifikimi të përbashkët, dhe duke i bashkuar ato në dy shtojca, XVII A dhe XVII B, në përputhje me regjimin të cilit i nënshtrohen. Në lidhje me shërbimet e Shtojcën XVII B, dispozitat përkatëse të kësaj direktive nuk duhet të prekin zbatimin e rregullave të Komunitetit që janë specifike për shërbimet në fjalë.

(18) Në lidhje me kontratat e shërbimeve, zbatimi i plotë i kësaj direktive për një periudhë kalimtare duhet kufizuar për kontratat për të cilat dispozitat e kësaj direktive do të lejojnë realizimin e potencialit të plotë për tregtinë e rritur ndër-kufitare. Kontratat për shërbimet e tjera duhet të monitorohen gjatë kësaj periudhe kalimtare përpara se të merret një vendim për zbatimin e plotë të kësaj direktive. Në këtë drejtim, duhet të përcaktohet mekanizmi për këtë monitorim. Në të njëjtën kohë, ky mekanizëm bën të mundur që palët e interesuara të kenë mundësi shikimi të informacioneve përkatëse.

(19) Duhet të shmangen pengesat për ofrimin e shërbimeve falas. Rrjedhimisht, ofrues të shërbimeve mund të jenë persona fizikë ose juridikë. Megjithatë, kjo direktivë nuk duhet të prekë, në nivel kombëtar, zbatimin e rregullave në lidhje me kushtet për ushtrimin e një veprimtarie ose profesioni, nëse ato janë në përputhje me të drejtën komunitare.

(20) Po zhvillohen në vazhdimësi teknika të reja të blerjeve elektronike. Këto teknika ndihmojnë rritjen e konkurrencës dhe efektshmërisë së blerjes publike, sidomos sa u përket kursimeve në parë dhe kohë që do të mundësojë përdorimi i tyre. Subjektet kontraktuese mund të përdorin teknika të blerjes elektronike, me kusht që përdorimi i tyre të respektojë rregullat e kësaj direktive, parimet e trajtimit të barabartë, mosdiskriminimit dhe transparencës. Në këtë masë, oferta e paraqitur nga ofertuesi, sidomos në bazë të një marrëveshjeje kuadër ose kur përdoret sistemi dinamik i blerjes, mund të marrë formën e katalogut elektronik të ofertuesit, nëse ky i fundit përdor mjetet e komunikimit të zgjedhura nga subjekti kontraktues në përputhje me nenin 48.

(21) Nisur nga shtrirja e shpejtë e sistemeve të blerjes elektronike, duhet të prezantohen rregullat e duhura që të bëjnë të mundur që subjektet kontraktuese të përfitojnë plotësisht nga mundësitë e ofruara nga këto sisteme. Në këtë kuadër, është e nevojshme të përcaktohet një sistem tërësisht elektronik dinamik blerjeje elektronike për blerje të zakonshme, si edhe të përcaktohen rregullat specifike për krijimin dhe funksionimin e një sistemi të tillë që të sigurojë trajtim të drejtë të çdo operatori ekonomik që dëshiron të bashkohet. Çdo operator ekonomik që paraqet një ofertë orientuese në përputhje me specifikimet dhe plotëson kriteret e përzgjedhjes duhet të lejohet të futet në këtë sistem. Kjo teknikë blerjeje i jep mundësi subjektit kontraktues, nëpërmjet krijimit të një liste të ofertuesve të përzgjedhur më parë dhe mundësisë që u jepet ofertuesve të rinj për të hyrë në sistem, të ketë një gamë veçanërisht të gjerë ofertash, si rezultat i lehtësirave elektronike në dispozicion, dhe të sigurojë në këtë mënyrë përdorimin optimal të fondeve nëpërmjet konkurrencës me bazë të gjerë.

(22) Meqë ka të ngjarë të rritet përdorimi i teknikës së ankandeve elektronike, këtyre ankandeve duhet t'u bëhet një përkufizim komunitar dhe të rregullohen nga rregulla specifike me qëllim që të sigurohet funksionimi i tyre i plotë në përputhje me parimet e trajtimit të barabartë, mosdiskriminimit dhe transparencës. Për këtë qëllim, duhet parashikuar që këto ankande elektronike të trajtojnë vetëm kontratat për punë, furnizime ose shërbime për të cilat mund të përcaktohen me saktësi specifikimet. I tillë mund të jetë sidomos rasti i kontratave të përsëritura për shërbime, punë dhe furnizime. Me të njëjtin objekt, duhet të mundësohet gjithashtu përcaktimi i renditjes përkatëse të ofertuesve në çdo fazë të ankandit elektronik. Përdorimi i ankandeve elektronike bën të mundur që subjektet kontraktuese t'u kërkojnë ofertuesve të paraqesin çmime të reja më të ulëta dhe të përmirësojnë gjithashtu disa elemente të ofertave, përveç çmimeve, në rastin kur kontratën e ka fituar oferta me përfitim më të madh ekonomik. Për të garantuar respektimin e parimit të transparencës, objekt i ankandit elektronik mund të jenë vetëm elementet e përshtatshëm për vlerësim automatik nëpërmjet mjeteve elektronike, pa ndërhyrje dhe/ose vlerësim nga subjekti kontraktues, pra, vetëm elementet që janë të matshme në mënyrë që të mund të shprehen në shifra ose përqindje. Nga ana tjetër, ato aspekte të ofertave që nënkuptojnë një vlerësim të elementeve jo sasiore nuk duhet të jenë objekt i

ankandeve elektronike. Rrjedhimisht, disa kontrata për punë dhe disa kontrata shërbimesh që kanë si objekt punën intelektuale, si projektimi i punimeve, nuk duhet të jenë objekt i ankandeve elektronike.

(23) Në Shtetet Anëtare janë zhvilluar disa teknika të përqendruara blerjeje. Disa autoritete kontraktuese janë përgjegjëse për blerje ose për shpalljen fituese të kontratës /marrëveshjes kuadër për subjektet kontraktuese. Nisur nga vëllimi i madh i blerë, këto teknika duhet të ndihmojnë në rritjen e konkurrencës dhe efektshmërisë së blerjes publike. Prandaj duhet parashikuar një përkufizim komunitar për organet qendrore blerëse të përdorura nga subjektet kontraktuese. Duhet të përkufizohen edhe kushtet sipas të cilave, në përputhje me parimet e mosdiskriminimit dhe trajtimit të barabartë, subjektet kontraktuese që blejnë punë, furnizime dhe/ose shërbime nëpërmjet një organi qendror blerës, të konsiderohen se e respektojnë këtë direktivë.

(24) Me qëllim që të merren parasysh rrethanat e ndryshme në Shtetet Anëtare, duhet të lejohen Shtetet Anëtare, të zgjedhin nëse subjektet kontraktuese mund të përdorin organe qendrore blerëse, sisteme dinamike blerjeje ose ankande elektronike, siç përkufizohet dhe rregullohet në këtë direktivë.

(25) Duhet të bëhet një përkufizim i duhur i konceptit të të drejtave të veçanta apo ekskluzive. Rrjedhje e përkufizimit është fakti se rasti kur një subjekt, për qëllim të ndërtimit të rrjeteve ose lehtësive portuale ose aeroportuale, mund të përfitojë nga një procedurë shpronësimi ose përdorimi prone, ose mund të vendosë pajisje rrjeti për rrugën automobilistike, nën rrugën automobilistike ose mbi rrugën automobilistike, nuk përbën në vetvete të drejta ekskluzive apo të veçanta sipas kuptimit të kësaj direktive. As fakti që një subjekt furnizon me ujë të pijshëm, energji, gaz, apo ngrohje një rrjet që përdoret nga një subjekt i cili gëzon të drejta të veçanta apo ekskluzive, të cilat ia ka dhënë një autoritet kompetent i Shtetit Anëtar në fjalë, nuk përbën në vetvete të drejta ekskluzive apo të veçanta sipas kuptimit të kësaj direktive. Nuk konsiderohen të drejta të veçanta apo ekskluzive as të drejtat që jepen nga një Shtet Anëtar në çfarëdo forme edhe nëpërmjet akteve të koncesionit, për një numër të kufizuar ndërmarrjesh në bazë të kriterëve objektive, proporcionale dhe mosdiskriminuese, të cilat bëjnë të mundur që çdo palë e interesuar që plotëson këto kritere, të gëzojë këto të drejta.

(26) Duhet që subjektet kontraktuese të zbatojnë procedurat e përbashkëta të prokurimit në lidhje me veprimtaritë e tyre që lidhen me ujërat, dhe që këto rregulla të zbatohen kur autoritetet kontraktuese sipas kuptimit të kësaj direktive shpallin kontratat fituese në lidhje me projektet e tyre në fushën e inxhinierisë hidrologjike, ujitjes, drenazhimit të tokës, ose depozitim dhe trajtimin e ujërave të zeza. Megjithatë, rregullat e prokurimit të llojit të propozuar për furnizimin e mallrave janë të papërshtatshme për blerjen e ujit, nisur nga nevoja për të prokuruar ujë nga burime pranë zonës ku do të përdoret.

(27) Subjekte të caktuara që ofrojnë shërbime transporti për publikun janë përjashtuar tashmë nga fusha e veprimit e Direktivës 93/38/KEE. Këto subjekte duhet të përjashtohen gjithashtu nga fusha e veprimit të kësaj direktive. Për t'i paraprirë shumëllojshmërisë së rregullave specifike që zbatohen vetëm për sektorë të caktuar, procedura e përgjithshme që lejon marrjen parasysh të efekteve të hapjes së konkurrencës duhet të zbatohet edhe për subjektet që ofrojnë shërbime të transportit urban të cilat nuk përjashtohen nga fusha e veprimit e Direktivës 93/38/KEE sipas nenit 2 pika 4 të saj.

(28) Duke pasur parasysh hapjen e mëtejshme ndaj konkurrencës së shërbimeve postare të Komunitetit dhe faktin që këto shërbime ofrohen nëpërmjet një rrjeti nga autoritetet kontraktuese, ndërmarrjet publike dhe ndërmarrje të tjera, kontratat e shpallura fituese nga subjekte kontraktuese që ofrojnë shërbime postare duhet t'i nënshtrohen rregullave të kësaj direktive, përfshirë ato të nenit 30, të cilat, në mbrojtje të zbatimit të parimeve të përmendura në pikën 9 të pjesës hyrëse, krijojnë një kuadër për praktika të qëndrueshme tregtare, dhe lejojnë fleksibilitet më të madh sesa ai që ofron Direktiva 2004/18/KE e Parlamentit Europian dhe e Këshillit, datë 31 mars 2004, për koordinimin e procedurave për shpalljen fituese të kontratave publike për punë, furnizime dhe shërbime [11]. Për një përkufizim të veprimtarive në fjalë, është e nevojshme të merren parasysh përkufizimet e Direktivës 97/67/KE të Parlamentit Europian dhe të Këshillit, datë 15 dhjetor 1997, për rregullat e përbashkëta për zhvillimin e tregut të brendshëm të shërbimeve postare të Komunitetit dhe për përmirësimin e cilësisë së shërbimit [12].

Cilido qoftë statusi ligjor i subjekteve që ofrojnë shërbime postare, ato nuk u nënshtrohen aktualisht rregullave të përcaktuara në Direktivën 93/38/KEE. Prandaj, përshtatja e procedurave të shpalljes së kontratës fituese me këtë direktivë mund të kërkojë më shumë kohë që të zbatohet për këto subjekte, sesa për subjektet që tashmë u nënshtrohen këtyre rregullave të cilat thjesht do të duhet të përshtatin procedurat e tyre me ndryshimet e bëra nga kjo direktivë. Prandaj duhet të lejohet ndalimi i zbatimit të kësaj direktive në funksion të kohës së nevojshme që kërkon kjo përshtatje. Nisur nga situatat e ndryshme të këtyre subjekteve, Shtetet Anëtare duhet të kenë mundësinë të parashikojnë një periudhë kalimtare për zbatimin e kësaj direktive për subjektet kontraktuese që veprojnë në sektorin e shërbimeve postare.

(29) Mund të lidhen kontrata me qëllim plotësimin e kërkesave të disa veprimtarive, të cilat ka të ngjarë t'u nënshtrohen regjimeve të ndryshme juridike. Duhet qartësuar që regjimi juridik i zbatueshëm për një kontratë të vetme, e cila synon të mbulojë disa veprimtari, duhet t'u nënshtrohet rregullave që zbatohen për veprimtarinë e cila përbën objektin parësor të saj. Konstatimi i veprimtarisë që përbën objektin parësor të kontratës mund të mbështetet në analizimin e kërkesave që duhet të plotësojë kontrata në fjalë; këtë analizë e bën subjekti kontraktues me qëllim që të llogaritet vlera e kontratës dhe të hartohen dokumentet e tenderit. Në disa raste, si në rastin e blerjes së një pjese të vetme të pajisjes për ndjekjen e veprimtarive për të cilat nuk do të gjendej informacioni i cili bën të mundur vlerësimin e normave përkatëse të përdorimit, mund të jetë objektivisht e pamundur që të konstatohet se cila veprimtari përbën objektin parësor të kontratës. Duhet bërë të qarta rregullat e zbatueshme në raste të tilla.

(30) Pa cenuar angazhimet ndërkombëtare të Komunitetit, është e nevojshme të thjeshtohet zbatimi i kësaj direktive, sidomos duke thjeshtuar kufijtë monetarë dhe duke bërë të zbatueshme për të gjitha subjektet kontraktuese, pavarësisht sektorit ku veprojnë, dispozitat në lidhje me informacionin që u jepet pjesëmarrësve për vendimet e marra mbi procedurat e shpalljes së kontratës fituese dhe rezultatet e tyre. Gjithashtu, në kuadër të Bashkimit Monetar, këta kufij monetarë duhet të përcaktohen në euro, në mënyrë të tillë që të thjeshtohet zbatimi i këtyre dispozitave duke siguruar në të njëjtën kohë respektimin e kufijve monetarë të përcaktuar në Marrëveshje, të shprehur në Të Drejtat e Veçanta të Tërheqjes (SDR). Në këtë kontekst, duhen parashikuar dhe rishikime të vazhdueshme të kufijve monetarë të shprehur në euro për t'i përshtatur ato, kur është e nevojshme, sipas luhatjeve të mundshme të vlerës së euros kundrejt SDR-së. Gjithashtu, kufijtë monetarë të zbatueshëm për konkurse projektimi duhet të jenë njësoj me ato që zbatohen për kontratat e shërbimeve.

(31) Duhet parashikuar rastet kur mund të mos zbatohen masat për koordinimin e procedurave për arsye që lidhen me sigurinë ose sekretin shtetëror që rrjedhin nga marrëveshje ndërkombëtare, në lidhje me stacionimin e trupave, ose që janë specifike për organizatat ndërkombëtare.

(32) Është më me vend përjashtimi i disa kontratave shërbimesh, furnizimesh, dhe punësh të fituara nga një pjesëmarrje që ka si veprimtari parësore ofrimin e këtyre shërbimeve, furnizimeve ose punëve për grupin ku bën pjesë, dhe jo për në treg. Gjithashtu, është me vend përjashtimi i kontratave të shërbimeve, furnizimeve dhe punëve, furnizime dhe punë që një subjekt kontraktues shpall fituese një sipërmarrjeje të përbashkët të formuar nga disa subjekte kontraktuese për të kryer veprimtaritë që mbulon kjo direktivë dhe ku bën pjesë ai subjekt. Megjithatë, duhet siguruar që ky përjashtim të mos çojë në shtrembërim të konkurrencës dhe përfitim të ndërmarrjeve ose ndërmarrjeve të përbashkëta që janë pjesëmarrje të subjekteve kontraktuese; duhet siguruar një tërësi e përshtatshme rregullash, sidomos në lidhje me kufijtë maksimalë brenda të cilëve ndërmarrjet mund të fitojnë një pjesë të xhiros së tyre nga tregu, dhe jashtë të cilëve ato do të humbin mundësinë për të fituar kontratat pa ftesën për konkurrim, përbërjen e sipërmarrjeve të përbashkëta dhe stabilitetin e hallkave ndërmjet këtyre sipërmarrjeve të përbashkëta dhe subjekteve kontraktuese nga të cilat përbëhen.

(33) Në kuadër të shërbimeve, kontratat për blerjen ose marrjen me qira të pronës së paluajtshme ose të drejtave mbi këto prona, kanë karakteristika të veçanta që e bëjnë të papërshtatshëm zbatimin e rregullave të prokurimit.

(34) Shërbimet e arbitrazhit dhe të pajtimit zakonisht ofrohen nga organe ose individë të përcaktuar ose të përzgjedhur, në një mënyrë që nuk mund të rregullohen nga rregullat e prokurimit.

(35) Në përputhje me Marrëveshjen, shërbimet financiare që mbulon kjo direktivë nuk përfshijnë kontratat në lidhje me emetimin, blerjen, shitjen ose transferimin e letrave me vlerë ose instrumenteve të tjera financiare në veçanti, nuk mbulojnë transaksionet nga subjektet kontraktuese për të siguruar fonde ose kapital.

(36) Kjo direktivë duhet të mbulojë ofrimin e shërbimeve vetëm nëse bazohet në kontrata.

(37) Sipas nenit 163 të Traktatit, inkurajimi i kërkimit dhe zhvillimit teknologjik është mjet për forcimin e bazës shkencore dhe teknologjike të industrisë së Komunitetit dhe hapja e kontratave të shërbimeve kontribuon për këtë qëllim. Kjo direktivë nuk duhet të mbulojë bashkëfinancimin e programeve të kërkimit dhe zhvillimit: po kështu kjo direktivë nuk mbulon kontratat për kërkim dhe zhvillim pa përfshirë ato në të cilat përfitimet i përkasin në mënyrë ekskluzive subjektit kontraktues që t'i përdorë në kryerjen e veprimtarive të tij, me kushtin që shërbimi i ofruar të shpërblehet tërësisht nga subjekti kontraktues.

(38) Për të shmangur përhapjen e rregullave specifike të zbatueshme vetëm për disa sektorë, rregullat e veçanta aktuale të krijuara me nenin 3 të Direktivës 93/38/KEE dhe nenin 12 të Direktivës 94/22/KEKE të Parlamentit Europian dhe të Këshillit, datë 30 maj 1994, për kushtet e dhënies dhe përdorimit të autorizimit për zbulimin, eksplorimin dhe prodhimin e hidrokarbureve [13] që rregullon subjektet që shfrytëzojnë një zonë gjeografike për qëllim të shfrytëzimit ose nxjerrjes së naftës, gazit, qymyrgurit ose lëndëve të tjera djegëse të ngurta, duhet të zëvendësohen me procedurën e përgjithshme që lejon përjashtime të sektorëve, të cilët janë drejtpërdrejt të ekspozuar ndaj konkurrencës. Megjithatë, kjo nuk duhet të cenojë Vendimin e Komisionit 93/676/KEE, datë 10 dhjetor 1993, që përcakton se shfrytëzimi i zonave gjeografike për qëllim të shfrytëzimit ose nxjerrjes së naftës apo gazit në Vendet e Ulëta nuk përbën një veprimtari të përcaktuar në nenin 2 pika 2 shkronja (b) paragrafi (i) të Direktivës së Këshillit 90/531/KEE, dhe që subjektet të cilat kryejnë një veprimtari të tillë në Vendet e Ulëta nuk duhet të konsiderohen si subjekte që veprojnë me të drejta të veçanta apo ekskluzive sipas kuptimit të nenit 2 pika 3 shkronja (b) të direktivës [14]; Vendimin e Komisionit 97/367/KE, datë 30 maj 1997, që përcakton se shfrytëzimi i zonave gjeografike për qëllim të shfrytëzimit ose nxjerrjes së naftës ose gazit në Mbretërinë e Bashkuar nuk përbën një veprimtari të përcaktuar në nenin 2 pika 2 shkronja (b) paragrafi (i) të Direktivës së Këshillit 93/38/KEE, dhe që subjektet që kryejnë një veprimtari të tillë nuk duhet të konsiderohen në Mbretërinë e Bashkuar si subjekte që veprojnë me të drejta të veçanta apo ekskluzive sipas nenit 2 pika 3 shkronja (b) të direktivës [15]; Vendimin e Komisionit 2002/205/KE datë 4 mars 2002, pas një kërkesë nga Austria për zbatimin e një regjimi të veçantë të parashikuar në nenin 3 të Direktivës 93/38/KEE [16] dhe Vendimin e Komisionit 2004/73/KE mbi një kërkesë të Gjermanisë për të zbatuar procedurën e veçantë të përcaktuar në nenin 3 të Direktivës 93/38/KEE [17].

(39) Punësimi dhe profesioni janë elemente kyçe në garantimin e mundësive të barabarta për të gjithë dhe kontribuojnë për integrimin në shoqëri. Në këtë kontekst, qendrat e punës dhe programet e punësimit në qendra pune kontribuojnë në mënyrë të efektshme në integrimin ose riintegrimin e personave me aftësi të kufizuara në tregun e punës. Megjithatë, këto qendra pune mund të mos jenë në gjendje të sigurojnë kontrata në kushtet normale të konkurrencës. Rrjedhimisht, duhet të parashikohet që Shtetet Anëtare të rezervojnë për këto qendra pune të drejtën për të marrë pjesë në procedura të shpalljes së kontratave fituese ose të rezervojnë zbatimin e kontratave në kontekstin e programeve të punësimit në qendrat e punës.

(40) Kjo direktivë nuk duhet zbatuar as për kontratat që synojnë të lejojnë kryerjen e një veprimtarie të përmendur në nenin 3 deri në 7, as për konkurset e projektimit të organizuara për ndjekjen e një veprimtarie të tillë nëse, në Shtetet Anëtare ku është kryer kjo veprimtari, ajo është drejtpërdrejt e ekspozuar ndaj konkurrencës në tregje ku hyrja nuk është kufizuar. Prandaj duhet parashikuar një procedurë e zbatueshme në të gjithë sektorët që mbulon kjo direktivë, që do të bëjë të mundur

marrjen parasysh të pasojave të hapjes aktuale ose të ardhme ndaj konkurrencës. Kjo procedurë duhet të ofrojë sigurinë juridike për subjektet e përfshira, si dhe një proces të duhur vendimmarrjeje, duke garantuar, brenda afateve të shkurtra, zbatimin uniform të së drejtës komunitare në këtë fushë.

(41) Ekspozimi i drejtpërdrejtë ndaj konkurrencës duhet vlerësuar në bazë të kritereve objektive, duke pasur parasysh karakteristikat specifike të sektorit në fjalë. Zbatimi i legjislacionit të përshtatshëm komunitar që hap një sektor të caktuar, ose një pjesë të tij, do të konsiderohet se ofron arsye të mjaftueshme për të menduar për hyrje të lirë në tregun në fjalë. Ky legjislacion i duhur duhet të identifikohet në një shtojcë që mund të përditësohet nga Komisioni. Komisioni, gjatë përditësimit, merr veçanërisht parasysh miratimin e mundshëm të masave që përfshijnë një hapje reale ndaj konkurrencës së sektorëve, pa përfshirë ata për të cilët është përmendur tashmë legjislacioni në Shtojcën XI, siç është sektori i transportit hekurudhor. Nëse hyrja e lirë në një treg të caktuar nuk rezulton nga zbatimi i legjislacionit të duhur komunitar, duhet të tregohet që kjo hyrje është e hapur, *de jure* dhe *de facto*. Për këtë qëllim, zbatimi nga një Shtet Anëtar i një direktive, siç është Direktiva 94/22/KE që hap një sektor të caktuar ndaj konkurrencës, ndaj një sektori tjetër, siç është sektori i qymyrgurit, është një rrethanë që duhet të merret parasysh për qëllimet e nenit 30.

(42) Specifikimet teknike të hartuara nga blerësit duhet të lejojnë që prokurimi publik të jetë i hapur ndaj konkurrencës. Për këtë qëllim, duhet të jetë e mundur paraqitja e ofertave që pasqyrojnë larminë e zgjidhjeve teknike. Në këtë linjë, duhet të jetë i mundur hartimi i specifikimeve teknike sa u përket kërkesave dhe zbatimit funksional performancës dhe, aty ku bëhet lidhja me standardet europiane, ose me standarde kombëtare në mungesë të të parave, subjektet kontraktuese duhet të konsiderojnë ofertat bazuar në rregulla të tjera të barasvlefshme të cilat plotësojnë kërkesat e subjekteve kontraktuese dhe janë të njëjta sa i përket sigurisë. Për të treguar barasvlerën, ofertuesit duhet të lejohen të përdorin çdo lloj prove. Subjektet kontraktuese duhet të jenë në gjendje të japin arsye për çdo vendim për mosekzistencën e barasvlerës në një rast të caktuar. Subjektet kontraktuese që dëshirojnë të përcaktojnë kërkesa mjedisore për specifikime teknike në një kontratë të caktuar mund të përcaktojnë karakteristikat mjedisore, si për shembull një metodë të caktuar prodhimi, dhe/ose pasojat specifike mjedisore të grupeve ose shërbimeve të prodhimit. Ato mund të përdorin, por nuk janë të detyruara të përdorin, specifikimet e duhura që janë përcaktuar në eko-etiketë, siç janë eko-etiketa europiane, eko-etiketa (shumë-) kombëtare dhe çdo eko-etiketë tjetër nëse kërkesat për etiketë hartohen dhe miratohen në bazë të informacionit specifik, nëpërmjet një procedure sipas të cilës mund të marrin pjesë, aktorët, që mund të jenë organet e qeverisë, konsumatorët, prodhuesit, shpërndarësit dhe organizatat mjedisore dhe me kusht që etiketa të jetë e dukshme dhe në dispozicion të palëve të interesuara. Subjektet kontraktuese, kur është e mundur, duhet të përcaktojnë specifikime teknike për të marrë parasysh mundësinë e përdorimit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimit për të gjithë përdoruesit. Specifikimet teknike duhet të tregohen qartë, në mënyrë që të gjithë ofertuesit të dinë se çfarë mbulojnë kërkesat e përcaktuara nga subjekti kontraktues.

(43) Për të inkurajuar përfshirjen e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme në tregun e prokurimit të kontratave publike, këshillohet të përfshihen dispozitat e nënkontraktimit.

(44) Kushtet e zbatimit të kontratës janë në përputhje me direktivën nëse nuk janë direkt apo tërthorazi diskriminuese dhe nëse tregohen në njoftimin e përdorur për ftesën për konkurrim ose në specifikime. Ato, në veçanti, mund të synojnë inkurajimin e trajnimit profesional në terren, punësimin e personave që kanë vështirësi të veçantë me integrimin, luftën kundër papunësisë ose mbrojtjen e mjedisit. Për shembull, duhen përmendur kërkesat e zbatueshme gjatë zbatimit të kontratës për të rekrutuar punëkërkuar afatgjatë ose për të zbatuar masa trajnimi për të papunët ose për të rinjtë, me qëllim që të respektohen në thelb dispozitat e konventave bazë të Organizatës Ndërkombëtare të Punës (ONP), duke supozuar që këto dispozita nuk janë zbatuar në të drejtën kombëtare dhe për të rekrutuar persona me aftësi të kufizuara fizike më shumë sesa kërkohet sipas legjislacionit kombëtar.

(45) Ligjet, rregulloret dhe marrëveshjet kolektive, në nivel kombëtar dhe komunitar, që janë në fuqi në fushat e kushteve të punësimit dhe të sigurisë në punë, zbatohen gjatë zbatimit të kontratës, nëse këto rregulla dhe zbatimi i tyre, përputhen me të drejtën komunitare. Në situata ndërkufitare, ku



punëtorët nga një Shtet Anëtar ofrojnë shërbime në një Shtet tjetër Anëtar me qëllim zbatimin e një kontrate, Direktiva 96/71/KE e Parlamentit Europian dhe e Këshillit, datë 16 dhjetor 1996, në lidhje me dërgimin e punëtorëve në kuadër të ofrimit të shërbimeve [18] përcakton kushtet minimale që duhen respektuar nga vendi pritës në lidhje me këta punëtorë të dërguar. Nëse legjislacioni kombëtar përmban dispozita për këtë qëllim, mosrespektimi i këtyre detyrimeve mund të konsiderohet faj i rëndë ose shkelje në lidhje me sjelljen profesionale të operatorit ekonomik të përfshirë, që çon në përjashtimin e atij operatori ekonomik nga procedura për fitimin e kontratës.

(46) Nisur nga zhvillimet e reja në teknologjinë e informacionit dhe telekomunikacionit dhe thjeshtimet që këto mund të sjellin në lidhje me publikimin e kontratave dhe efikasitetin dhe transparencën e procedurave të prokurimit, mjetet elektronike duhet të vihen në një nivel me mjetet tradicionale të komunikimit dhe shkëmbimit të informacionit. Sa të jetë e mundur, mjetet dhe teknologjia e zgjedhur duhet të përputhen me teknologjitë e përdorura në Shtete të tjera Anëtare.

(47) Përdorimi i mjeteve elektronike çon në kursimin e kohës. Si rezultat, duhet parashikuar shkurtimi i afateve minimale nëse përdoren mjetet elektronike, që megjithatë i nënshtrohen kushtit që duhet të jenë në përputhje me mënyrën specifike të transmetimit të parashikuar në nivel komunitar. Megjithatë, është e nevojshme të sigurohet që tërësia e shkurtimeve të afateve kohore të mos çojnë në afate jashtëzakonisht të shkurtra.

(48) Direktiva 1999/93/KE e Parlamentit Europian dhe e Këshillit, datë 13 dhjetor 1999, për një kuadër komunitar për nënshkrimet elektronike [19] dhe Direktiva 2000/31/KE e Parlamentit Europian dhe e Këshillit, datë 8 qershor 2000, për disa aspekte ligjore të shërbimeve të shoqërisë së informacionit, sidomos tregtisë elektronike, në tregun e brendshëm (Direktiva për tregtinë elektronike) [20] në kontekst të kësaj direktive, duhet të zbatohen për përcjelljen e informacionit me mjete elektronike. Procedurat e prokurimit publik dhe rregullat e zbatueshme për konkurse shërbimi kërkojnë një nivel sigurie dhe konfidencialiteti më të lartë se ai që kërkohet nga këto direktiva. Në këtë linjë, pajisjet për marrjen elektronike të ofertave, kërkesave për pjesëmarrje dhe planeve dhe projekteve duhet të jenë në përputhje me kërkesa specifike shtesë. Për këtë qëllim, duhet të inkurajohet, sa më shumë të jetë e mundur, përdorimi i nënshkrimeve elektronike, sidomos nënshkrimeve elektronike të avancuara. Gjithashtu, skemat e akreditimit vullnetar duhet të përbëjnë një kuadër të favorshëm për të rritur nivelin e ofrimit të shërbimit të certifikimit për këto pajisje.

(49) Pjesëmarrësit duhet që në një procedurë për shpalljen e kontratës fituese të vihen në dijeni të vendimeve për lidhjen e një marrëveshjeje kuadër ose për fitimin e një kontrate ose për braktisjen e procedurës brenda afateve që janë mjaft të shkurtra për të mos bërë të pamundur paraqitjen e kërkesave për rishikim; prandaj ky informacion duhet dhënë sa më shpejt që të jetë e mundur dhe në përgjithësi brenda 15 ditëve pas vendimit.

(50) Duhet qartësuar se subjektet kontraktuese që përcaktojnë kriteret përzgjedhjeje në një procedurë të hapur duhet ta bëjnë këtë në përputhje me rregullat dhe kriteret objektive, ashtu siç duhet të jenë objektive kriteret e përzgjedhjes në procedura të kufizuara dhe me negociim. Këto rregulla dhe kriteret objektive, siç janë kriteret e përzgjedhjes, jo domosdoshmërisht nënkuptojnë shkallë rëndësie.

(51) Është e rëndësishme të merret parasysh praktika gjyqësore e Gjykatës së Drejtësisë në rastet kur një operator ekonomik kërkon aftësitë ekonomike, financiare ose teknike të subjekteve të tjera, cilado qoftë natyra ligjore e lidhjes ndërmjet tij dhe këtyre subjekteve, për të plotësuar kriteret e përzgjedhjes, ose në kontekst të sistemeve të kualifikimit, për të mbështetur aplikimin e tij për kualifikim. Në rastin e fundit, i takon operatorit ekonomik të provojë që këto burime në fakt do të jenë në dispozicion gjatë gjithë periudhës së vlefshmërisë së kualifikimit. Për qëllimet e kualifikimit, një subjekt kontraktues mund të përcaktojë nivelin e kërkesave që duhet të plotësohen dhe sidomos, për shembull nëse operatori shtron pretendime për gjendjen financiare të një subjekti tjetër, mund të kërkojë që ai subjekt të jetë përgjegjës, nëse është e nevojshme, bashkërisht dhe veçmas.

Sistemet e kualifikimit duhet të përdoren në përputhje me rregullat dhe kriteret objektive, që me zgjedhjen e subjekteve kontraktuese, mund të përfshijnë kapacitetet e operatorëve ekonomikë dhe/ose

karakteristikat e punimeve, furnizimeve ose shërbimeve që mbulon sistemi. Për qëllim të kualifikimit, subjektet kontraktuese mund të kryejnë testimet e tyre për të vlerësuar karakteristikat e punimeve, furnizimeve ose shërbimeve në fjalë, sidomos sa i përket pajtueshmërisë dhe sigurisë.

(52) Zbatohen rregullat përkatëse komunitare për njohjen e ndërsjellë të diplomave, dëshmimeve ose provave të tjera të kualifikimeve formale nëse për pjesëmarrje në një procedurë prokurimi ose një konkurs projektimi kërkohet prova për një kualifikim të veçantë.

(53) Në rastet e duhura, ku natyra e punimeve dhe/ose shërbimeve justifikon zbatimin e masave ose skemave të menaxhimit mjedisor gjatë zbatimit të një kontrate, mund të kërkohet zbatimi i këtyre masave ose skemave. Skema të menaxhimit mjedisor, të regjistruara apo jo sipas instrumenteve komunitare të tilla si Rregullore (KE) nr. 761/2001 (EMAS) [21], mund të tregojnë që operatori ekonomik ka aftësinë teknike për të zbatuar kontratën. Gjithashtu, një përshkrim i masave të zbatuara nga operatori ekonomik për të siguruar të njëjtin nivel të mbrojtjes mjedisore duhet të pranohet si alternativë për skemat e regjistrimit të menaxhimit mjedisor si një lloj prove.

(54) Duhet të shmangët shpallja e kontratave fituese të operatorëve ekonomikë që kanë marrë pjesë në organizata kriminale, ose që janë shpallur fajtorë për korrupsion ose mashtrim në dëm të interesave financiare të Komuniteteve Europiane ose për pastrim parash. Meqë subjektet kontraktuese që nuk janë autoritete kontraktuese, mund të mos kenë të drejtë të shikimit të informacionit për provimin e padiskutueshëm të kësaj çështjeje, duhet që t'u lihet subjekteve kontraktuese të zgjedhin aplikimin apo jo të kritereve të përjashtimit të renditura në nenin 45 pika 1 të Direktivës 2004/18/KE. Prandaj detyrimi për të zbatuar nenin 45 pika 1 duhet të zbatohet vetëm për subjektet kontraktuese që janë autoritete kontraktuese. Sipas rastit, subjektet kontraktuese duhet t'iu kërkojnë aplikantëve për kualifikim, kandidatëve ose ofertuesve të paraqesin dokumente përkatëse dhe, kur kanë dyshime për situatën personale të këtyre operatorëve ekonomikë, ato mund të kërkojnë bashkëpunimin e autoriteteve kompetente të Shtetit Anëtar të përfshirë. Përjashtimi i këtyre operatorëve ekonomikë duhet të bëhet sapo autoriteti kontraktues të vihet në dijeni për një vendim në lidhje me vepra penale të kryera sipas legjislacionit kombëtar që ka forcën *res judicata*.

Nëse legjislacioni kombëtar përmban dispozita për këtë qëllim, mosrespektimi i legjislacionit mjedisor ose i legjislacionit për marrëveshjet e paligjshme në kontrata, i cili ka qenë subjekt i një vendimi të formës së prerë ose një vendimi që ka efekt të njëjtë mund të konsiderohet shkelje në lidhje me sjelljen profesionale të operatorit ekonomik në fjalë ose faj i rëndë.

Mosrespektimi i dispozitave kombëtare në zbatim të Direktivave të Këshillit 2000/78/KE [22] dhe 76/207/KEE [23] në lidhje me trajtimin e barabartë të punonjësve, që ka qenë objekt i një vendimi të formës së prerë ose vendimi me efekt të njëjtë mund të konsiderohet shkelje në lidhje me sjelljen profesionale të operatorit ekonomik në fjalë ose faj i rëndë.

(55) Kontratat duhet të shpallen fituese në bazë të kritereve objektive që sigurojnë respektimin e parimit të transparencës, mosdiskriminimit dhe trajtimin të barabartë dhe që garantojnë vlerësimin e ofertave në kushtet e konkurrencës së efektshme. Si rezultat, duhet të lejohet zbatimi vetëm i dy kritereve për shpalljen e fituesit: “çmimi më i ulët” dhe “oferta me përfitim më të madh ekonomik”.

Për të siguruar respektimin e parimit të trajtimin të barabartë në shpalljen e kontratës fituese, duhet përcaktuar detyrimi – i krijuar nga praktika gjyqësore - për të siguruar transparencën e nevojshme, me qëllim që të gjithë ofertuesit të informohen në mënyrë të arsyeshme për kriteret dhe rregullat që do të zbatohen për të identifikuar ofertën me përfitim më të madh ekonomik. Prandaj është përgjegjësia e subjekteve kontraktuese që të përcaktojnë kriteret për shpalljen e kontratës fituese dhe shkallën e rëndësisë relative që i jepet secilit kriter në kohë të mjaftueshme që ofertuesit të jenë në dijeni për to në kohën e përgatitjes së ofertës. Subjektet kontraktuese mund të shmangin përcaktimin e shkallës së rëndësisë së kritereve për shpalljen e kontratës fituese në raste të justifikuar për të cilat duhet të jenë në gjendje të japin arsyet, kur shkalla e rëndësisë nuk mund të përcaktohet paraprakisht, sidomos për shkak të kompleksitetit të kontratës. Në këto raste, ato duhet të diktojnë rendin zbritës të shkallës së rëndësisë së kritereve.

Nëse subjektet kontraktuese zgjedhin të shpallin kontratën fituese për ofertën me përfitim më të madh ekonomik, ato duhet të vlerësojnë ofertat, me qëllim që të përcaktojnë se cila prej tyre ofron përfitimin më të madh kundrejt vlerës së parave. Për të bërë këtë, ato duhet të përcaktojnë kriteret ekonomike dhe cilësore që, të marra në tërësi, duhet të bëjnë të mundur përcaktimin e ofertës me përfitim më të madh ekonomik për subjektin kontraktues. Përcaktimi i këtyre kriterëve varet nga objekti i kontratës pasi ato duhet të lejojnë që niveli i zbatimit i ofruar nga çdo ofertë të vlerësohet nën dritën e objektit të kontratës, siç e përcaktojnë specifikimet teknike, dhe që të llogaritet vlera e çdo oferte. Për të garantuar trajtim të barabartë, kriteret për shpalljen e kontratës fituese duhet të mundësojnë krahasimin dhe vlerësimin e ofertave në mënyrë objektive. Nëse plotësohen këto kushte, kriteret ekonomike dhe cilësore për fitimin e kontratës, si plotësimi i kriterëve mjedisore, mund të bëjnë të mundur që subjekti kontraktues të plotësojë nevojat e publikut të përfshirë, siç përcaktohet në specifikimet e kontratës. Në të njëjtat kushte, një subjekt kontraktues mund të përdorë kriteret që synojnë plotësimin e kërkesave sociale, sidomos në përgjigje të nevojave - të përcaktuara në specifikimet e kontratës - të grupeve të personave veçanërisht në disavantazh të cilëve u përket marrja/përdorimi i punimeve, furnizimeve ose shërbimeve që janë objekt i kontratës.

(56) Kriteret e shpalljes së fituesit nuk duhet të cenojnë zbatimin e dispozitave kombëtare për shpërblimin e shërbimeve të caktuara, siç janë shërbimet që ofrojnë arkitektët, inxhinierët ose avokatët.

(57) Për llogaritjen e afateve kohore që përmban kjo direktivë duhet të zbatohet Rregullorja e Këshillit (KEE, Euratom) nr. 1182/71, datë 3 qershor 1971, që përcakton rregullat e zbatueshme për periudhat, datat dhe afatet ligjore [24].

(58) Kjo direktivë nuk duhet të cenojë detyrimet ndërkombëtare ekzistuese të Komunitetit ose të Shteteve Anëtare dhe nuk duhet të cenojë zbatimin e dispozitave të Traktatit, sidomos nenin 81 dhe 86 të tij.

(59) Kjo direktivë nuk duhet të cenojë afatin kohor të përcaktuar në Shtojcën XXV, brenda të cilit Shteteve Anëtare u kërkohet të transpozojnë dhe zbatojnë Direktivën 93/38/KEE.

(60) Masat e nevojshme për zbatimin e kësaj direktive duhet të miratohen në përputhje me Vendimin e Këshillit 1999/468/KE, datë 28 qershor 1999, që përcakton procedurat për ushtrimin e kompetencave zbatuese që i janë dhënë Komisionit, [25].

## KANË MIRATUAR KËTË DIREKTIVË:

### PËRMBAJTJA

### TITULLI I DISPOZITA TË PËRGGJITHSHME TË ZBATUESHME PËR KONTRATAT DHE KONKURSET E PROJEKTIMIT

#### KAPITULLI I Termat bazë

##### Neni 1 Përkufizime

#### KAPITULLI II Përkufizimi i veprimtarive dhe subjekteve që mbulohen

##### Seksioni 1 Subjektet

##### Neni 2 Subjektet kontraktuese

##### Seksioni 2 Veprimtaritë

##### Neni 3 Gazi, ngrohja dhe energjia elektrike

##### Neni 4 Uji

##### Neni 5 Shërbimet e transportit

Neni 6 Shërbimet postare

Neni 7 Shfrytëzimi ose nxjerrja e naftës, gazit, qymyrgurit apo lëndëve të tjera djegëse të ngurta, si edhe portet dhe aeroportet

Neni 8 Listat e subjekteve kontraktuese

Neni 9 Kontrata që përfshijnë disa veprimtari

KAPITULLI III Parime të përgjithshme

Neni 10 Parimet e shpalljes së kontratës fituese

TITULLI II RREGULLAT E ZBATUESHME PËR KONTRATAT

KAPITULLI I Dispozita të Përgjithshme

Neni 11 Operatorët ekonomikë

Neni 12 Kushtet në lidhje me marrëveshjet e lidhura në kuadër të Organizatës Botërore të Tregtisë

Neni 13 Konfidencialiteti

Neni 14 Marrëveshjet kuadër

Neni 15 Sistemet dinamike të blerjes

KAPITULLI II Kufijtë monetarë dhe dispozita përjashtimi

Seksioni 1 Kufijtë monetarë

Neni 16 Kufijtë monetarë të kontratës

Neni 17 Metodatat e llogaritjes së vlerës së çmuar të kontratave, marrëveshjeve kuadër dhe sistemeve dinamike të blerjes

Seksioni 2 Kontratat dhe koncesionet dhe kontratat që u nënshtrohen rregullave të veçanta

Nëseksioni 1

Neni 18 Koncesionet për punë dhe shërbime

Nëseksioni 2 Përjashtimet e zbatueshme për të gjitha subjektet kontraktuese dhe për të gjitha llojet e kontratave

Neni 19 Kontratat e shpallura fituese për qëllime rishitjeje ose qiradhënieje të tretë

Neni 20 Kontratat e shpallura fituese për qëllime të tjera të ndryshme nga ndjekja e një veprimtarie të mbuluar ose për ndjekjen e një veprimtarie të tillë në një vend të tretë

Neni 21 Kontratat e fshehta ose që kërkojnë masa të veçanta sigurimi

Neni 22 Kontratat e shpallura fituese sipas rregullave ndërkombëtare

Neni 23 Kontratat e fituara nga një pjesëmarrje, sipërmarrje e përbashkët ose subjekt kontraktues pjesë e një sipërmarrjeje të përbashkët

Nëseksioni 3 Përjashtimet e zbatueshme për të gjitha subjektet kontraktuese, vetëm për kontratat e shërbimit

Neni 24 Kontrata në lidhje me disa shërbime të përjashtuara nga fusha e veprimit të kësaj direktive

Neni 25 Kontratat e shërbimit të fituara në bazë të një të drejte ekskluzive

Nëseksioni 4 Përjashtime të zbatueshme vetëm për disa subjekte kontraktuese

Neni 26 Kontratat e shpallura fituese nga disa subjekte kontraktuese për blerjen e ujit dhe për furnizimin me energji ose lëndë djegëse për prodhimin e energjisë

Nëseksioni 5 Kontratat që u nënshtrohen rregullave të veçanta, dispozitave në lidhje me organet qendrore të blerjes dhe procedurave të përgjithshme në rast të ekspozimit të drejtpërdrejtë ndaj konkurrencës

Neni 27 Kontratat që u nënshtrohen rregullave të veçanta

Neni 28 Kontratat e rezervuara

Neni 29 Kontratat dhe marrëveshjet kuadër të shpallura fituese nga organe qendrore blerëse

Neni 30 Procedurat që përdoren për të parë nëse një veprimtari e caktuar është drejtpërdrejt e ekspozuar ndaj konkurrencës

KAPITULLI III Rregullat e zbatueshme për kontratat e shërbimeve

Neni 31 Kontratat e shërbimeve të renditura në Shtojcën XVII A

Neni 32 Kontratat e shërbimeve të renditura nga Shtojcën XVII B

Neni 33 Kontratat e përziera të shërbimeve që përfshijnë shërbimet e renditura në Shtojcën XVII A dhe shërbimet e renditura në Shtojcën XVII B

KAPITULLI IV Rregullat specifike që rregullojnë specifikimet dhe dokumentet e kontratës

Neni 34 Specifikimet teknike

Neni 35 Komunikimi i specifikimeve teknike

Neni 36 Variantet

Neni 37 Nënkontraktimi

Neni 38 Kushtet e zbatimit të kontratave

Neni 39 Detyrimet në lidhje me tatimet, mbrojtjen mjedisore, dispozitat e mbrojtjes së marrëdhënieve të punës dhe kushtet e punës

KAPITULLI V Procedurat

Neni 40 Përdorimi i procedurave të hapura, të kufizuara dhe me negociim

## KAPITULLI VI Rregullat për publikimin dhe transparencën

### Seksioni 1 Publikimi i njoftimeve

Neni 41 Njoftimet periodike orientuese dhe njoftimet për ekzistencën e një sistemi kualifikimi

Neni 42 Njoftimet e përdorura si mjete për të ftuar për konkurrim

Neni 43 Njoftimet e kontratës fituese

Neni 44 Forma dhe mënyra e publikimit të njoftimeve

### Seksioni 2 Afatet kohore

Neni 45 Afatet kohore për marrjen e kërkesave për pjesëmarrje dhe për marrjen e ofertave

Neni 46 Procedurat e hapura: specifikimet, dokumentet dhe informacioni shtesë

Neni 47 Ftesa për ofertë ose për negociim

### Seksioni 3 Komunikimi dhe informacioni

Neni 48 Rregullat e zbatueshme për komunikimin

Neni 49 Informacion për aplikantët për kualifikim, kandidatët dhe ofertuesit

Neni 50 Informacioni që duhet ruajtur në lidhje me kontratat e shpallura fituese

## KAPITULLI VII Zhvillimi i procedurës

Neni 51 Dispozita të përgjithshme

### Seksioni 1 Kualifikimi dhe përzgjedhja cilësore

Neni 52 Njohja e ndërsjellë në lidhje me kushtet administrative, teknike ose financiare dhe vërtetimet, testimet dhe provat

Neni 53 Sistemet e kualifikimit

Neni 54 Kriteret për përzgjedhjen cilësore

### Seksioni 2 Shpallja e kontratës fituese

Neni 55 Kriteret për shpalljen e kontratës fituese

Neni 56 Përdorimi i ankandeve elektronike

Neni 57 Ofertat jonormale të ulëta

Seksioni 3 Ofertat që përfshijnë produkte me origjinë nga vende të treta dhe marrëdhëniet me këto vende

Neni 58 Oferta që përfshijnë produkte me origjinë nga vende të treta

Neni 59 Marrëdhëniet me vendet e treta në lidhje me kontratat për punë, furnizime dhe shërbime

### TITULLI III RREGULLAT QË RREGULLOJNË KONKURSET E PROJEKTIMIT

Neni 60 Dispozita të përgjithshme

Neni 61 Kufijtë monetarë

Neni 62 Konkursset e projektimit të përjashtuara

Neni 63 Rregullat për shpalljen dhe transparencën

Neni 64 Mjetet e komunikimit

Neni 65 Rregullat për organizimin e konkurseve të projektimit, përzgjedhjen e pjesëmarrësve dhe jurisë

Neni 66 Vendimet e jurisë

### TITULLI IV DETYRIME STATISTIKORE, KOMPETENCA EKZEKUTIVE DHE DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 67 Detyrime statistikore

Neni 68 Procedura në Komitet

Neni 69 Rishikimi i kufijve monetarë

Neni 70 Ndryshimet

Neni 71 Zbatimi i direktivës

Neni 72 Mekanizmat e monitorimit

Neni 73 Shfuqizimi

Neni 74 Hyrja në fuqi

Neni 75 Adresa

Shtojca I Subjekte kontraktuese në sektorët e transportit ose shpërndarjes së gazit ose ngrohjes

Shtojca II Subjekte kontraktuese në sektorët e prodhimit, transportit ose shpërndarjes së energjisë

Shtojca III Subjekte kontraktuese në sektorët e prodhimit, transportit ose shpërndarjes së ujit të pijshëm

Shtojca IV Subjekte kontraktuese në fushën e shërbimeve hekurudhore

Shtojca V Subjekte kontraktuese në fushën e shërbimeve hekurudhore urbane, me tramvaj, autobus elektrik ose autobus

Shtojca VI Subjekte kontraktuese në sektorin e shërbimit postar

Shtojca VII Subjekte kontraktuese në sektorët e eksplorimit dhe nxjerrjes së naftës ose gazit

Shtojca VIII Subjekte kontraktuese në sektorët e shfrytëzimit dhe nxjerrjes së qymyrgurit dhe lëndëve të tjera djegëse të ngurta

Shtojca IX Subjekte kontraktuese në portet detare ose të brendshme ose struktura të tjera terminale

Shtojca X Subjekte kontraktuese për instalimet në aeroport

Shtojca XI Lista e legjislacionit komunitar përmendur në nenin 30 pika 3

Shtojca XII Lista e veprimtarive të përcaktuara në nenin 1 pika 2, shkronja b paragrafi 1

Shtojca XIII Informacion që duhet të përfshihet në njoftimet e kontratës

A. Procedurat e hapura

B. Procedurat e kufizuara

C. Procedurat me negociim

D. Njoftimi i thjeshtuar i kontratës për t'u përdorur në një sistem dinamik blerjeje

Shtojca XIV Informacioni që duhet të përfshihet në njoftimin për ekzistencën e një sistemi kualifikimi

Shtojca XV A Informacion që duhet të përfshihet në njoftimin periodik orientues

Shtojca XV B Informacion që duhet të përfshihet në njoftime të publikimit të një njoftimi periodik orientues në profilin e blerësit, të cilat nuk përdoren si mjet për të ftuar për konkurrim

Shtojca XVI Informacion që duhet të përfshihet në njoftimin e kontratës fituese

Shtojca XVII A Shërbime sipas kuptimit të nenit 31

Shtojca XV B Shërbime sipas kuptimit të nenit 32

Shtojca XVIII Informacion që duhet të përfshihet në njoftimin për konkursin e projektimit

Shtojca XIX Informacion që duhet të përfshihet në rezultatet e njoftimeve të konkurseve të projektimit

Shtojca XX Veçori në lidhje me publikimin

Shtojca XXI Përkufizimi i disa specifikimeve teknike

Shtojca XXII Tabelë përmbledhëse e afateve kohore të përcaktuara në nenin 45 Shtojca XXIII dispozita të së drejtës ndërkombëtare të punës sipas kuptimit të nenit 59 pika 4

Shtojca XXIV Kërkesat në lidhje me marrjen elektronike të ofertave, kërkesave për pjesëmarrje, aplikimeve për kualifikim si dhe planeve dhe projekteve në konkurse

Shtojca XXV Afatet kohore për transpozim dhe zbatim

Shtojca XXVI Tabela e përputhshmërisë

## TITULLI I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME TË ZBATUESHME PËR KONTRATAT DHE KONKURSET E PROJEKTIMIT

### KAPITULLI I Termet bazë

#### Neni 1



## Përkufizime

1. Në kuptim të kësaj direktive zbatohen përkufizimet e përcaktuara në këtë nen.

2. (a) "Kontrata furnizimi, punimesh dhe shërbimesh" janë kontratat me interes monetar, të cilat lidhen me shkrim ndërmjet një ose më shumë subjekteve kontraktuese të përmendura në nenin 2 pika 2, dhe ndërmjet një ose më shumë sipërmarrësve, furnitorëve, ose ofruesve të shërbimeve.

(b) "Kontrata e punimeve" janë kontratat që kanë si objekt të tyre ekzekutimin ose projektimin dhe realizimin e punimeve që lidhen me një nga veprimtaritë sipas kuptimit të Shtojcës XII ose me një vepër apo realizimi me çfarëdolloj mjeti të një vepre që u korrespondon kërkesave të specifikuar nga subjekti kontraktues. "Vepër" "Punë" është përfundimi i një tërësie ndërtimi apo punimesh civile të mjaftueshëm për përmbushjen e një funksioni ekonomik ose teknik.

(c) "Kontrata furnizimi" janë kontratat që nuk përfshijnë ato që parashikon shkronja (b) të cilat kanë si objekt marrjen në përdorim të produkteve përmes blerjes, qirasë ose pagesës me këste periodike me apo pa të drejtë blerjeje.

Kontrata me objekt furnizimin e produkteve, që mbulon gjithashtu, në mënyrë plotësuese, vendosjen dhe instalimin vlerësohet si "kontratë furnizimi";

(d) "Kontrata shërbimi" janë kontratat që nuk përfshijnë kontratat e punimeve ose të furnizimeve që kanë objekt ofrimin e shërbimeve të përmendura në Shtojcën XVII.

Një kontratë që ka objekt si produktet ashtu dhe shërbimet sipas kuptimit të Shtojcës XVII konsiderohet "kontratë shërbimi" nëse vlera e shërbimeve në fjalë kalon vlerën e produkteve që mbulon kontrata.

Një kontratë që ka objekt shërbime, sipas kuptimit të Shtojcës XVII, dhe përfshin veprimtari sipas kuptimit të Shtojcës XII që janë thjesht plotësuese për objektin parësor të kontratës, konsiderohet kontratë shërbimi.

3. (a) "Koncesioni për punë" është kontrata e punëve, në të cilën kryerja e punimeve konsiston ose vetëm në të drejtën e shfrytëzimit të veprës ose në këtë të drejtë plus një pagesë;

(b) "Koncesioni për shërbim" është kontrata për shërbime në të cilën ofrimi i shërbimit konsiston ose vetëm në të drejtën e shfrytëzimit të shërbimit ose në këtë të drejtë plus një pagesë;

4. "Marrëveshja kuadër" është marrëveshja ndërmjet një ose më shumë subjekteve kontraktuese të përmendura në nenin 2 pika 2 dhe një ose më shumë operatorëve ekonomikë, qëllimi i së cilës është të përcaktojë kushtet që rregullojnë kontratat të cilat duhet të shpallen fituese gjatë një periudhe të caktuar sidomos në lidhje me çmimin dhe, sipas rastit, sasitë e parashikuara.

5. "Sistemi dinamik blerjeje" është një procedurë tërësisht elektronike për të bërë blerje të zakonshme, karakteristikat e të cilave, siç gjenden përgjithësisht në treg, plotësojnë kërkesat e subjektit kontraktues, me kohëzgjatje të kufizuar dhe i hapur gjatë gjithë vlefshmërisë së tij ndaj çdo operatori ekonomik që përmbush kriteret e përzgjedhjes dhe që ka paraqitur një ofertë orientuese e cila iu përmbahet specifikimeve.

6. "Ankand elektronik" është një proces i përsëritur që përfshin një pajisje elektronike për paraqitjen e çmimeve të reja, të ulura, dhe/ose vlerat e reja në lidhje me disa elemente të ofertës, i cili ndodh pas një vlerësimi të plotë fillestar të ofertave, duke mundësuar renditjen e tyre nëpërmjet metodave automatike të vlerësimit. Rrjedhimisht, disa kontrata për shërbim dhe disa kontrata për punë që kanë si objekt performancën intelektuale, siç janë projektimi i punimeve, nuk mund të jenë objekt i ankandeve elektronike.

7. Termat "sipërmarrës", "furnizues" ose "ofrues shërbimi" nënkuptojnë një person fizik ose juridik ose një subjekt kontraktues sipas kuptimit të nenit 2 pika 2 shkronja (a) ose (b), ose një grup personash të tillë apo/edhe subjektsh të tillë që ofrojnë në treg, përkatësisht, ekzekutimin e punimeve dhe/ose një punim, produkte ose shërbime.

Termi "operator ekonomik" mbulon po kështu konceptet e sipërmarrësit, furnizuesit dhe ofruesit të shërbimit. Ky term përdoret thjesht për lehtësim.

"Ofertues" është operatori ekonomik që paraqet një ofertë dhe "kandidat" është ai që ka kërkuar ftesë për pjesëmarrje në një procedurë të kufizuar ose me negociim.

8. "Organ qendror blerës" është autoriteti kontraktues sipas kuptimit të nenit 2 pika 1 shkronja (a) ose autoriteti kontraktues sipas kuptimit të nenit 1 pika 9 të Direktivës 2004/18/KE i cili:

- siguron furnizime dhe/ose shërbime për subjekte kontraktuese ose
- shpall kontratat fituese ose lidh marrëveshje kuadër për punë, furnizime ose shërbime të caktuara për subjektet kontraktuese.

9. "Procedurë e hapur, e kufizuar dhe me negociim" janë procedurat e prokurimit që përdoren nga subjektet kontraktuese, sipas të cilave:

- (a) në rastin e procedurave të hapura, çdo operator ekonomik i interesuar mund të paraqesë një ofertë;
- (b) në rastin e procedurave të kufizuara, çdo operator ekonomik mund të kërkojë të marrë pjesë dhe vetëm kandidatët e ftuar nga subjekti kontraktues mund të paraqesin ofertë;
- (c) në rastin e procedurave me negociim, subjekti kontraktues konsulton operatorët ekonomikë për vendimin e tij dhe negociacion kushtet e kontratës me një ose më shumë prej tyre.

10. "Konkurse projektimi" janë ato procedura që bëjnë të mundur që subjekti kontraktues të sigurojë, kryesisht në fushën e planifikimit urban dhe rural, arkitekturës, inxhinierisë ose përpunimit të të dhënave, një plan ose projekt të përzgjedhur nga një juri pasi është paraqitur për konkurrim, me apo pa çmim.

11. "E shkruar" ose "me shkrim" është çdo shprehje me fjalë ose shifra që mund të lexohet, riprodhohet dhe rrjedhimisht të komunikohet. Mund të përmbajë informacion që përcillet dhe ruhet me mjete elektronike.

12. "Mjete elektronike" janë mjetet elektronike që përdoren për përpunimin (përfshirë kompresimin dixhital) dhe ruajtjen e të dhënave që transmetohen, përçohen dhe merren me kabëll, radio, mjete optike ose mjete të tjera elektromagnetike.

13. "Fjalori i Përbashkët për Prokurimin" është nomenklatura referencë e zbatueshme për kontratat publike e miratuar me Rregulloren (KE) nr. 2195/2002, datë 5 nëntor 2002 të Parlamentit Europian dhe të Këshillit për Fjalorin e Përbashkët për Prokurimin (FPP) [26] duke siguruar njëjtësimin me nomenklatura të tjera ekzistuese.

Në rast të interpretimeve të ndryshme të fushës së veprimit të kësaj direktive për shkak të dallimeve të mundshme ndërmjet nomenklaturës së FPP-së dhe KSVE-së të renditura në Shtojcën XII ose ndërmjet nomenklaturës FPP dhe CPC (variant i përkohshëm) të renditura në Shtojcën XVII, epërsi do të kenë përkatësisht nomenklatura KSVE ose CPC.

## KAPITULLI II

### Përkufizimi i veprimtarive dhe subjekteve që mbulohen

#### Seksioni 1 Subjektet

##### Neni 2

#### **Subjektet kontraktuese**

1. Për qëllimet e kësaj direktive,

(a) "Autoritete kontraktuese" janë autoritetet shtetërore, rajonale ose lokale, organe që rregullohen nga e drejta publike, shoqata të krijuara nga një ose disa autoritete ose një ose disa organe të tilla që i rregullon e drejta publike.

"Organ i rregulluar nga e drejta publike" është organi:

- i krijuar për qëllimin specifik të plotësimit të nevojave me interes të përgjithshëm, i cili nuk ka karakter industrial apo tregtar,
- me personalitet juridik dhe

- i financiar, në pjesën më të madhe, nga autoritetet shtetërore, rajonale ose lokale ose organet e tjera që i rregullon e drejta publike; ose niveli drejtues i të cilit i nënshtrohet mbikëqyrjes nga këto organe; ose që ka këshill administrativ, drejtues apo mbikëqyrës, ku më shumë se gjysma e anëtarëve janë emëruar nga autoritetet shtetërore, rajonale ose lokale, ose nga organe të tjera që i rregullon e drejta publike;

(b) "ndërmarrje publike" është ndërmarrja mbi të cilën autoritetet kontraktuese mund të ushtrojnë direkt ose tërthorazi ndikim dominues për shkak të pronësisë së tyre mbi të, pjesëmarrjes së tyre financiare në të, ose rregullave që e rregullojnë.

Ndikimi dominues nga ana e autoriteteve kontraktuese vlerësohet kur këto autoritete, drejtpërdrejt ose tërthorazi, në lidhje me një ndërmarrje:

- kanë shumicën e kapitalit të nënshkruar të ndërmarrjes, ose
- kontrollojnë shumicën e votave që u korrespondojnë aksioneve të emetuara nga ndërmarrja, ose
- mund të emërojnë më shumë se gjysmën e organit administrativ, drejtues ose mbikëqyrës të ndërmarrjes.

2. Kjo direktivë zbatohet për subjektet kontraktuese:

(a) të cilat janë autoritete kontraktuese ose ndërmarrje publike dhe ndjekin një nga veprimtaritë e përmendura në nenet 3 deri në 7;

(b) të cilat, nëse nuk janë autoritete kontraktuese ose ndërmarrje publike, kanë si një nga veprimtaritë e tyre një nga veprimtaritë e përmendura në nenet 3 deri në 7, ose një ndërthurje të tyre dhe veprojnë në bazë të të drejtave të veçanta apo ekskluzive që u jepen nga një autoritet kompetent i një Shteti Anëtar.

3. Në kuptim të kësaj direktive "të drejta të veçanta apo ekskluzive" janë të drejtat që autoriteti kompetent i një Shteti Anëtar u jep një ose më shumë subjekteve me anë të normave ligjore apo nënligjore, efekti i të cilave është kufizimi i ushtrimit të veprimtarive të përkufizuara në nenet 3 deri në 7 dhe që prek në thelb aftësinë e subjekteve të tjera për ta kryer këtë veprimtari.

## Seksioni 2 Veprimtaritë

### Neni 3

#### **Gazi, ngrohja dhe energjia elektrike**

1. Sa i përket gazit dhe ngrohjes, kjo direktivë zbatohet për veprimtaritë e mëposhtme:

(a) sigurimin ose shfrytëzimin e rrjeteve të palëvizshme për të ofruar një shërbim për publikun në lidhje me prodhimin, transportin ose shpërndarjen e gazit a të ngrohjes; ose

(b) furnizimin e këtyre rrjeteve me gaz ose ngrohje.

2. Furnizimi me gaz ose ngrohje i rrjeteve që ofrojnë një shërbim për publikun nga një subjekt kontraktues që nuk është autoriteti kontraktues, nuk konsiderohet veprimtari sipas kuptimit të pikës 1 nëse:

(a) prodhimi i gazit ose ngrohjes nga subjekti në fjalë është pasojë e pashmangshme e kryerjes së një veprimtarie të ndryshme nga ato që përmenden në pikën 1 ose 3 të këtij neni ose në nenet 4 deri në 7; dhe

(b) furnizimi i rrjetit publik synon vetëm shfrytëzimin ekonomik të këtij prodhimi dhe arrin jo më shumë se 20% të xhiros së subjektit duke pasur parasysh mesataren e tre viteve të fundit, përfshirë edhe vitin aktual.

3. Sa i përket energjisë elektrike, kjo direktivë zbatohet për veprimtaritë e mëposhtme:

(a) sigurimin ose shfrytëzimin e rrjeteve të palëvizshme për të ofruar një shërbim për publikun në lidhje me prodhimin, transportin ose shpërndarjen e energjisë elektrike; ose

(b) furnizimin e këtyre rrjeteve me energji elektrike.

4. Furnizimi me energji elektrike i rrjeteve që ofrojnë shërbim për publikun nga një subjekt kontraktues që nuk është autoriteti kontraktues, nuk konsiderohet veprimtari sipas kuptimit të pikës 3 nëse:

(a) prodhimi i energjisë elektrike nga subjekti në fjalë është pasojë e pashmangshme e kryerjes së një veprimtarie të ndryshme nga ato që përmenden në pikën 1 ose 3 të këtij neni ose në nenet 4 deri në 7; dhe

(b) furnizimi i rrjetit publik varet vetëm nga konsumi vetjak dhe nuk tejkalon 30% të prodhimit total të energjisë nga subjekti duke pasur parasysh mesataren e tre viteve të fundit, përfshirë edhe vitin aktual.

#### Neni 4

##### Uji

1. Kjo direktivë zbatohet për veprimtaritë e mëposhtme:

(a) sigurimin ose shfrytëzimin e rrjeteve të palëvizshme për të ofruar një shërbim për publikun në lidhje me prodhimin, transportin ose shpërndarjen e ujit të pijshëm;

(b) furnizimin e këtyre rrjeteve me ujë të pijshëm.

2. Kjo direktivë zbatohet gjithashtu për kontratat ose konkurset e projektimit të fituara ose të organizuara nga subjektet që ndjekin një veprimtari të përmendur në pikën 1 dhe që lidhen me:

(a) projekte të inxhinierisë hidrologjike, ujitjen ose drenazhimin, me kusht që vëllimi i ujit që do të përdoret për furnizimin me ujë të pijshëm të përbëjë më shumë se 20% e vëllimit total të ujit që vihet në dispozicion nga këto projekte ose instalime për ujitje apo drenazhim, ose

(b) depozitimin ose trajtimin e ujërave të zeza.

3. Furnizimi me ujë të pijshëm i rrjeteve që ofrojnë shërbim për publikun nga subjekti kontraktues që nuk është autoriteti kontraktues nuk konsiderohet veprimtari sipas kuptimit të pikës 1 nëse:

(a) prodhimi i ujit të pijshëm nga subjekti në fjalë bëhet sepse konsumi i tij është i nevojshëm për të kryer një veprimtari të ndryshme nga ato që përmenden në nenet 3 deri në 7; dhe

(b) furnizimi i rrjetit publik varet vetëm nga konsumi vetjak i subjektit dhe nuk tejkalon 30% të prodhimit total të ujit të pijshëm nga subjekti, duke pasur parasysh mesataren e tre viteve të fundit, përfshirë edhe vitin aktual.

#### Neni 5

##### Shërbimet e transportit

1. Kjo direktivë zbatohet për veprimtaritë që lidhen me sigurimin ose funksionimin e rrjeteve që ofrojnë një shërbim për publikun në fushën e transportit hekurudhor, sistemeve të automatizuara, transportit me tramvaj, trolejbus, autobus ose teleferik.

Në lidhje me shërbimet e transportit, konsiderohet se ekziston një rrjet nëse shërbimi ofrohet në kushte pune të përcaktuara nga një autoritet kompetent i një Shteti Anëtar, siç janë kushtet për rrugët e ofrimit të shërbimit, kapaciteti për t'u vënë në dispozicion ose shpeshtësia e ofrimit të shërbimit.

2. Kjo direktivë nuk zbatohet për subjekte që ofrojnë për publikun shërbime të transportit me autobus, të cilat janë të përjashtuara nga fusha e veprimit të Direktivës 93/38/KEE sipas nenit 2 pika 4 e saj.

#### Neni 6

##### Shërbimet postare

1. Kjo direktivë zbatohet për veprimtaritë që lidhen me ofrimin e shërbimeve postare ose, sipas kushteve të përcaktuara në pikën 2 shkronja (c), për shërbime të tjera që nuk janë shërbime postare.

2. Për qëllim të kësaj direktive dhe pa cenuar Direktivën 97/67/KE:

(a) "artikull postar" është një artikull me adresë, i gatshëm për t'u dërguar, pavarësisht peshës. Përveç artikujve të letërkëmbimit, artikuj të tillë përfshijnë gjithashtu për shembull libra, katalogë, gazeta, botime periodike dhe pako postare, me mallra, me apo pa vlerë tregtare, pavarësisht peshës;

(b) "shërbime postare" janë shërbimet që kanë të bëjnë me zhdoganimin, ndarjen, kanalizimin dhe lëvrimin e artikujve postarë. Këto shërbime përfshijnë:

- "shërbime të rezervuara postare": shërbime postare që janë ose mund të rezervohen në bazë të nenit 7 të Direktivës 97/67/KE,
- "shërbime të tjera postare" shërbime postare që janë ose mund të rezervohen në bazë të nenit 7 të Direktivës 97/67/KE; dhe
- (c) "shërbime të tjera të ndryshme nga shërbimet postare" janë shërbimet e ofruara në fushat e mëposhtme:
  - shërbime të menaxhimit të shërbimit postar (shërbime para dhe pas dërgimit, siç janë shërbimet e menaxhimit të protokollit),
  - shërbime me vlerë të shtuar që lidhen me dhe ofrohen tërësisht nëpërmjet mjeteve elektronike (përfshirë transmetimin e sigurt të dokumenteve të koduara me anë të mjeteve elektronike, shërbime të menaxhimit të adresave dhe transmetim të postës elektronike të regjistruar),
  - shërbime në lidhje me artikuj postarë që nuk përfshihen në shkronjën (a), siç janë dërgesat e drejtpërdrejta që nuk kanë adresë,
  - shërbime financiare siç përkufizohen në kategorinë 6 të Shtojcës XVII dhe në nenin 24 shkronja (c) dhe që përfshijnë në veçanti urdhërpagesat postare dhe urdhërxhirimet postare,
  - shërbime filatelike, dhe
  - shërbime logjistike (shërbime që ndërthurin dorëzimin fizik dhe/ose ruajtjen me funksione të tjera jo postare),

me kushtin që këto shërbime të ofrohen nga një subjekt që ofron gjithashtu shërbime postare sipas kuptimit të shkronjës (b), paragrafi i parë ose i dytë, dhe me kushtin që kushtet e përcaktuara në nenin 30 pika 1 të mos plotësohen në lidhje me shërbimet që përfshihen në këto paragrafë.

#### Neni 7

### **Shfrytëzimi ose nxjerrja e naftës, gazit, qymyrgurit apo lëndëve të tjera djegëse të ngurta, si edhe portet dhe aeroportet**

Kjo direktivë zbatohet për veprimtaritë që lidhen me shfrytëzimin e një zone gjeografike me qëllim:

- (a) shfrytëzimin ose nxjerrjen e naftës, gazit, qymyrgurit ose lëndëve djegëse të ngurta, ose
- (b) sigurimin e aeroporteve dhe porteve detare, liqenore a lumore ose strukturave të tjera terminale për transportuesit në rrugë ajrore, detare ose ujore të brendshme.

#### Neni 8

### **Listat e subjekteve kontraktuese**

Listat joshtruese të subjekteve kontraktuese sipas kuptimit të kësaj direktive jepen në Shtojcën I deri në X. Shtetet Anëtare njoftojnë rregullisht Komisionin për ndryshimet në listat e tyre.

#### Neni 9

### **Kontrata që përfshijnë disa veprimtari**

1. Kontrata që synon të përfshijë disa veprimtari u nënshtrohet rregullave të zbatueshme për veprimtarinë për të cilën është synuar në fillim.

Megjithatë, zgjedhja ndërmjet shpalljes së një kontrate fituese të vetme dhe të disa kontratave fituese të veçanta nuk mund të bëhet me qëllim përjashtimin e saj nga fusha e veprimit të kësaj direktive, ose sipas rastit, Direktivës 2004/18/KE.

2. Nëse një nga veprimtaritë për të cilën është synuar kontrata i nënshtrohet kësaj direktive dhe Direktivës 2004/18/KE të sipërpërmendur dhe nëse është objektivi i pamundur të përcaktohet veprimtaria për të cilën është synuar kontrata në fillim, kontrata shpallet fituese në përputhje me Direktivën 2004/18/KE e sipërpërmendur.

3. Nëse një nga veprimtaritë për të cilën është synuar kontrata i nënshtrohet kësaj direktive dhe tjetra nuk i nënshtrohet as kësaj direktive as Direktivës 2004/18/KE të sipërpërmendur, dhe është objektivisht e pamundur të përcaktohet veprimtaria për të cilën është synuar kontrata në fillim, kontrata shpallet fituese në përputhje me këtë direktivë.

### KAPITULLI III Parime të përgjithshme

#### Neni 10 **Parimet e shpalljes së kontratës fituese**

Subjektet kontraktuese i trajtojnë operatorët ekonomikë njësoj dhe pa diskriminim dhe veprojnë në mënyrë transparente.

### TITULLI II RREGULLAT E ZBATUESHME PËR KONTRATAT

#### KAPITULLI I Dispozita të përgjithshme

#### Neni 11 **Operatorët ekonomikë**

1. Kandidatët ose ofertuesit që, sipas ligjit të Shtetit Anëtar ku janë vendosur, kanë të drejtë të ofrojnë shërbimin përkatës, nuk refuzohen vetëm për arsyen se sipas ligjit të Shtetit Anëtar ku është shpallur fituese kontrata, atyre do u kërkohej të ishin persona fizikë ose juridikë.

Megjithatë, në rastin e kontratave të shërbimeve dhe punimeve si dhe të kontratave furnizimeve që mbulojnë gjithashtu shërbime dhe/ose vendosje dhe instalime, personave juridikë mund t'u kërkohej të tregojnë, në ftesën ose kërkesën për pjesëmarrje, emrat dhe kualifikimet përkatëse profesionale të personelit që do të jetë përgjegjës për zbatimin e kontratës në fjalë.

2. Grupet e operatorëve ekonomikë mund të paraqesin oferta ose të dalin vetë si kandidatë. Për të paraqitur një ofertë ose kërkesë për pjesëmarrje, subjektet kontraktuese nuk mund t'u kërkojnë këtyre grupeve që të marrin një formë specifike ligjore; megjithatë, grupit të përzgjedhur mund t'i kërkohej kjo pasi të jetë shpallur kontrata fituese, në masën që ky ndryshim të jetë i nevojshëm për zbatimin e kënaqshëm të kontratës.

#### Neni 12

#### **Kushtet në lidhje me marrëveshjet e lidhura në kuadër të Organizatës Botërore të Tregtisë**

Shtetet Anëtare në marrëdhëniet e tyre, për qëllim të shpalljes së kontratave fituese nga subjekte kontraktuese, zbatojnë kushte po aq të favorshme sa ato që u vendosin operatorëve ekonomikë të vendeve të treta në zbatimin e Marrëveshjes. Për këtë qëllim, Shtetet Anëtare konsultojnë njëra-tjetrën brenda Komitetit Këshillues për Kontratat Publike në lidhje me masat që duhen marrë sipas Marrëveshjes.

#### Neni 13 **Konfidencialiteti**

1. Subjektet kontraktuese në kontekstin e sigurimit të specifikimeve teknike për operatorët ekonomikë të interesuar, kualifikimit dhe përzgjedhjes së operatorëve ekonomikë dhe shpalljes së kontratave fituese, mund të vendosin kërkesa me qëllim mbrojtjen e natyrës konfidenciale të informacionit që ato vënë në dispozicion.

2. Autoriteti kontraktues, pa cenuar dispozitat e kësaj direktive, sidomos ato në lidhje me detyrimet për shpalljen e kontratave fituese dhe për informacionin për kandidatët dhe ofertuesit e përcaktuar në

nenin 43 dhe 49, dhe në përputhje me të drejtën kombëtare të cilës i nënshtrohet subjekti kontraktues, nuk zbulon informacionin e dërguar nga operatorët ekonomikë të cilin ato e kanë përcaktuar si konfidencial; ky informacion përfshin, sidomos, të fshehta teknike ose tregtare dhe aspekte konfidenciale të ofertave.

#### Neni 14

### **Marrëveshjet kuadër**

1. Subjektet kontraktuese mund ta konsiderojnë marrëveshjen kuadër si kontratë sipas kuptimit të nenit 1 pika 2 dhe ta shpallin atë fituese në përputhje me këtë direktivë.
2. Nëse subjektet kontraktuese shpallin fituese një marrëveshje kuadër në përputhje me këtë direktivë, ato mund të përdorin nenin 40 pika 3 shkronja (i) nëse shpallin kontrata fituese që bazohen në marrëveshjen kuadër në fjalë.
3. Nëse një marrëveshje kuadër nuk është shpallur fituese në përputhje me këtë direktivë, subjektet kontraktuese nuk mund të përdorin nenin 40 pika 3 shkronja (i).
4. Subjektet kontraktuese nuk mund t'i keqpërdorin marrëveshjet kuadër për të fshehur, kufizuar ose shtrembëruar konkurrencën.

#### Neni 15

### **Sistemet dinamike të blerjes**

1. Shtetet Anëtare mund të parashikojnë që subjektet kontraktuese të përdorin sisteme dinamike blerjeje.
2. Subjektet kontraktuese, për të krijuar një sistem dinamik blerjeje, ndjekin rregullat e procedurës së hapur në të gjitha fazat deri në shpalljen e kontratave fituese që duhet të lidhen sipas këtij sistemi. Të gjithë ofertuesit që plotësojnë kriteret e përzgjedhjes dhe që kanë paraqitur një ofertë orientuese e cila respekton specifikimet dhe ndonjë dokument shtesë të mundshëm pranohen në sistem; ofertat orientuese mund të përmirësohen në çdo kohë nëse vazhdojnë të jenë në përputhje me specifikimin. Me qëllim krijimit të sistemit dhe shpalljen e kontratave fituese sipas tij, subjektet kontraktuese përdorin vetëm mjete elektronike në përputhje me nenin 48 pika 2 deri në 5.
3. Për qëllim të krijimit të sistemit dinamik të blerjes, subjektet kontraktuese:
  - (a) publikojnë një njoftim kontrate duke e bërë të qartë që është i përfshirë një sistem dinamik blerjeje;
  - (b) tregojnë në specifikim, mes çështjeve të tjera, natyrën e blerjeve të parashikuar sipas atij sistemi, si edhe të gjithë informacionin e nevojshëm në lidhje me sistemin e blerjes, pajisjen elektronike të përdorur dhe rregullat dhe specifikimet e lidhjes teknike;
  - (c) ofrojnë me anë të mjeteve elektronike, pas publikimit të njoftimit dhe deri në mbarim të afatit të sistemit, liri-hyrje të pakufizuar, të drejtpërdrejtë dhe të plotë në specifikimin dhe çdo dokument tjetër shtesë dhe tregojnë në njoftim adresën e internetit ku mund të shihen këto dokumente.
4. Subjektet kontraktuese i japin çdo operatori ekonomik gjatë gjithë periudhës së sistemit dinamik të blerjes mundësinë të paraqesë një ofertë orientuese dhe të pranohet në sistem sipas kushteve të përmendura në pikën 2. Ato e plotësojnë vlerësimin brenda afatit maksimal prej 15 ditësh nga data e paraqitjes së ofertës orientuese. Megjithatë, ato mund ta zgjasin periudhën e vlerësimit nëse nuk ka dalë ndërkohë ndonjë ftesë për ofertë.  
Subjektet kontraktuese njoftojnë ofertuesin e përmendur në paragrafin e parë, sa më shpejt që të jetë e mundur, për pranimin e tij në sistemin dinamik të blerjes ose për refuzimin e ofertës së tij orientuese.
5. Çdo kontratë specifike do të ketë një ftesë për ofertë të veçantë. Përpara nxjerrjes së ftesës për ofertë, subjektet kontraktuese publikojnë një njoftim të thjeshtuar kontrate, duke ftuar të gjithë operatorët ekonomikë të interesuar të paraqesin një ofertë orientuese në përputhje me pikën 4, brenda

një afati kohor që nuk mund të jetë më pak se 15 ditë nga data e dërgimit të njoftimit të thjeshtuar. Subjektet kontraktuese nuk mund të vijojnë me tenderimin deri në përfundimin e vlerësimit të të gjithë ofertave orientuese të marra brenda afatit kohor.

6. Subjektet kontraktuese ftojnë të gjithë ofertuesit e pranuar në sistem të paraqesin oferta për çdo kontratë specifike të fituar sipas sistemit. Për këtë qëllim, ato përcaktojnë një afat kohor për paraqitjen e ofertave.

Ato shpallin fituese kontratën e ofertuesit që paraqiti ofertën më të mirë në bazë të kritereve për shpalljen e kontratës fituese të përcaktuara në njoftimin e kontratës për krijimin e sistemit dinamik të blerjes. Këto kritere, sipas nevojës, mund të formulohen me më tepër saktësi në ftesën e përmendur në paragrafin e parë.

7. Sistemi dinamik i blerjes nuk mund të zgjasë më shumë se katër vjet, përveçse në raste përjashtimore të justifikuara.

Subjektet kontraktuese nuk mund të përdorin këtë sistem për të parandaluar, kufizuar ose shtrembëruar konkurrencën.

Operatorëve ekonomikë ose palëve të sistemit nuk mund t'u kërkohet pagesë.

## KAPITULLI II

### Kufijtë monetarë dhe dispozita përjashtimi

#### SEKSIONI 1

#### Kufijtë monetarë

##### Neni 16

#### **Kufijtë monetarë të kontratës**

Kjo direktivë zbatohet për kontratat që, përveç rasteve të përjashtimit në nenet 19 deri në 26 ose sipas nenit 30, në lidhje me ndjekjen e veprimtarisë në fjalë, kanë një vlerë që përjashton tatimin mbi vlerën e shtuar (TVSH-në) të llogaritur jo më pak se kufijtë e mëposhtëm monetarë:

- (a) 499.000 euro në rastin e kontratave të furnizimeve dhe shërbimeve;
- (b) 6.242.000 euro në rastin e kontratave për punë;

##### Neni 17

#### **Metodat e llogaritjes së vlerës së çmuar të kontratave, marrëveshjeve kuadër dhe sistemeve dinamike të blerjes**

1. Llogaritja e vlerës së çmuar të kontratës bazohet në shumën e plotë të pagueshme, pa TVSH-në, të çmuar nga subjekti kontraktues. Në llogaritje merret parasysh shuma totale e çmuar, përfshirë çdo mundësi dhe ripërtëritje të kontratës.

Nëse subjekti kontraktues parashikon çmime ose pagesa për kandidatët ose ofertuesit, i merr ato parasysh kur llogarit vlerën e çmuar të kontratës.

2. Subjektet kontraktuese nuk mund ta anashkalojnë këtë direktivë përmes ndarjes së projekteve të punimeve ose të blerjeve të propozuara të një sasive të caktuar materialesh dhe/ose shërbimesh apo përmes përdorimit të metodave të veçanta për llogaritjen e vlerës së çmuar të kontratave.

3. Në lidhje me marrëveshjet kuadër dhe sistemet dinamike të blerjes, vlera e çmuar që duhet të merret parasysh është vlera totale e çmuar pa TVSH-në e të gjitha kontratave të parashikuara për të gjithë kohëzgjatjen e marrëveshjes ose sistemit.

4. Për qëllimet e nenit 16, subjektet kontraktuese përfshijnë në vlerën e çmuar të kontratave të punimeve si koston e punimeve ashtu dhe vlerën e materialeve ose shërbimeve të nevojshme për ekzekutimin e punimeve, që i vënë në dispozicion të sipërmarrësit.



5. Vlera e materialeve ose shërbimeve që nuk janë të nevojshme për zbatimin e një kontratë të veçantë punimesh nuk mund t'i shtohet vlerës së kontratës së punimeve nëse kjo do të çonte në mospërfshirjen e prokurimit të këtyre materialeve ose shërbimeve nga fusha e veprimtimit të direktivës.

6. (a) Nëse një punë e propozuar ose blerje e shërbimeve mund të rezultojë në kontrata të shpallura fituese në të njëjtën kohë në formën e loteve të veçanta, merret parasysh vlera totale e çmuar e të gjitha këtyre loteve.

Nëse shuma gjithsej e loteve është e njëjtë me kufirin e përcaktuar në nenin 16 ose tejkalon kufirin në fjalë, kjo direktivë zbatohet për shpalljen e fituesit të çdo loti.

Megjithatë, subjektet kontraktuese mund të mos e zbatojnë këtë për lotet vlera e llogaritur e të cilave, pa TVSH, është më pak se 80.000 euro për shërbimet ose 1 milion euro për punimet, me kusht që shuma gjithsej e këtyre loteve të mos kalojë 20% të shumës gjithsej të loteve në tërësi.

(b) Nëse një propozim për blerjen e furnizimeve të ngjashme mund të rezultojë në kontrata të shpallura fituese në të njëjtën kohë në formën e loteve të veçanta, merret parasysh vlera totale e llogaritur e të gjitha loteve kur zbatohet neni 16.

Nëse vlera agregate e loteve është e njëjtë me kufirin e përcaktuar në nenin 16 ose tejkalon kufirin në fjalë, kjo direktivë zbatohet për shpalljen e fituesit të çdo loti.

Megjithatë, subjektet kontraktuese mund të mos e zbatojnë këtë për lotet vlera e çmuar e të cilave, pa TVSH, është më pak se 80.000 euro, me kusht që kostoja gjithsej e këtyre loteve të mos kalojë 20% të shumës gjithsej të loteve në tërësi.

7. Në rastin e kontratave furnizimeve ose shërbimeve që kanë natyrë të rregullt ose mendohet të rishikohen brenda një periudhe të caktuar, llogaritja e vlerës së çmuar të kontratës bazohet në sa më poshtë:

(a) ose në vlerën totale faktike të kontratave të njëpasnjëshme të të njëjtit lloj të shpallura fituese gjatë dymbëdhjetë muajve të fundit ose vitit financiar, e përshtatur, nëse është e mundur, për të marrë parasysh ndryshimet në sasi ose vlerë që do të ndodhnin gjatë 12 muajve pas kontratës së parë;

(b) ose në vlerën totale të çmuar të kontratave të njëpasnjëshme të shpallura fituese gjatë 12 muajve pas lëvrimit të parë, ose gjatë vitit financiar nëse ky është më shumë se 12 muaj.

8. Baza për llogaritjen e vlerës së çmuar të kontratës duke përfshirë si materialet ashtu edhe shërbimet është vlera totale e materialeve dhe shërbimeve, pavarësisht pjesës së tyre përkatëse. Llogaritja përfshin vlerën e vendosjes dhe instalimit.

9. Sa u përket kontratave të furnizimit në lidhje me marrjen me qira ose blerjen me këste, qiramarrjen apo qiradhënien e produkteve, vlera që duhet marrë si bazë për të llogaritur vlerën e çmuar të kontratës është si vijon:

(a) në rastin e kontratave me afat të përcaktuar, nëse ky afat është më pak ose i barabartë me 12 muaj, merret për bazë vlera totale e çmuar për afatin e kontratës, ose nëse afati i kontratës është më shumë se 12 muaj, merret për bazë vlera totale duke përfshirë vlerën e mbetur të çmuar;

(b) në rastin e kontratave pa afat të caktuar ose afati i të cilave nuk mund të përcaktohet, merret për bazë vlera mujore e shumëfishuar me 48.

10. Për qëllime të llogaritjes së vlerës së çmuar të kontratës së shërbimit, merren parasysh shumat e mëposhtme, sipas rastit:

(a) primi i pagueshëm dhe format e tjera të pagesës, në rastin e shërbimeve të sigurimit;

(b) tarifat, komisionet, interesi dhe format e tjera të pagesës, në rastin e shërbimeve bankare dhe shërbimeve të tjera financiare;

(c) tarifat, komisionet e pagueshme dhe format e tjera të pagesës, në rastin e kontratave që përfshijnë detyra projektimi.

11. Në rastin e kontratave të shërbimit që nuk tregojnë një çmim total, vlera që duhet përdorur si bazë për llogaritjen e vlerës së çmuar të kontratës është:

(a) në rastin e kontratave me afat të përcaktuar, nëse ky afat është më pak ose i barabartë me 48 muaj: vlera totale për afatin e tyre të plotë;

(b) në rastin e kontratave pa një afat të përcaktuar ose me një afat më të gjatë se 48 muaj: vlera mujore e shumëfishuar me 48.

## SEKSIONI 2

Kontratat dhe koncesionet dhe kontratat që u nënshtrohen rregullave të veçanta

### NËNSEKSIONI 1

Neni 18

#### **Koncesionet për punë dhe shërbime**

Kjo direktivë nuk zbatohet për koncesionet për punë dhe shërbime që janë shpallur fituese nga subjektet kontraktuese të cilat kryejnë një ose më shumë veprimtari të përmendura në nenin 3 deri në 7, nëse këto koncesione fitohen për të kryer këto veprimtari.

### NËNSEKSIONI 2

Përfshirjet e zbatueshme për të gjitha subjektet kontraktuese dhe për të gjitha llojet e kontratave

Neni 19

#### **Kontratat e shpallura fituese për qëllime rishitjeje ose qiradhënieje të tretë**

1. Kjo direktivë nuk zbatohet për kontratat e shpallura fituese për qëllime të rishitjes ose qiradhënies të tretë, nëse subjekti kontraktues nuk gëzon të drejtën e veçantë apo ekskluzive për të shitur ose dhënë me qira objektin e këtyre kontratave, dhe nëse subjekte të tjera janë të lira ta shesin ose ta japin me qira me të njëjtat kushte si subjekti kontraktues.

2. Subjektet kontraktuese e informojnë Komisionin më kërkesën e këtij të fundit për të gjitha kategoritë e produkteve ose veprimtarive që i konsiderojnë të përjashtuara sipas pikës 1. Komisioni mund të publikojë rregullisht për informim në Gazetën Zyrtare të Bashkimit Europian listat e kategorive të produkteve dhe veprimtarive që konsiderohen se përfshihen në këtë përjashtim. Në këtë mënyrë, Komisioni, respekton çdo aspekt tregtar delikat që mund të vënë në dukje subjektet kontraktuese kur përcjellin informacion.

Neni 20

#### **Kontratat e shpallura fituese për qëllime të tjera të ndryshme nga ndjekja e një veprimtarie të mbuluar ose për ndjekjen e një veprimtarie të tillë në një vend të tretë**

1. Kjo direktivë nuk zbatohet për kontratat që subjektet kontraktuese shpallin fituese për qëllime të ndryshme nga ndjekja e veprimtarive të tyre siç e përshkruajnë nenet 3 deri në 7 ose për ndjekjen e këtyre veprimtarive në një vend të tretë, në rrethana që nuk përfshijnë përdorimin fizik të një rrjeti ose të një zone gjeografike brenda Komunitetit.

2. Subjektet kontraktuese njoftojnë Komisionin, me kërkesë të tij, për çdo veprimtari që e konsiderojnë të përjashtuar sipas pikës 1. Komisioni mund të publikojë rregullisht në Gazetën Zyrtare të Bashkimit Europian për qëllim informacioni, listat e kategorive të veprimtarive që i konsideron të mbuluara nga ky përjashtim. Në këtë mënyrë, Komisioni respekton çdo aspekt tregtar delikat që mund të vënë në dukje subjektet kontraktuese kur përcjellin informacion.

Neni 21

#### **Kontratat e fshehta ose që kërkojnë masa të veçanta sigurimi**

Kjo direktivë nuk zbatohet për kontratat kur shpallen të fshehta nga një Shtet Anëtar, kur përmbushja e tyre duhet të shoqërohet nga masa të veçanta sigurimi në përputhje me aktet ligjore ose aktet nënligjore në fuqi në Shtetin Anëtar përkatës, ose kur e kërkon mbrojtja e interesave bazë të sigurimit të këtij Shteti Anëtar.

Neni 22

## **Kontratat e shpallura fituese sipas rregullave ndërkombëtare**

Kjo direktivë nuk zbatohet për kontratat që rregullohen nga rregulla të ndryshme procedurale dhe që shpallen fituese:

- (a) sipas një marrëveshjeje ndërkombëtare të lidhur në përputhje me Traktatin ndërmjet një Shteti Anëtar dhe një ose më shumë vendeve të treta, dhe që mbulon furnizime, punë, shërbime ose konkurse projektimi të synuara për zbatim të përbashkët ose shfrytëzim të një projekti nga shtetet nënshkruese; të gjitha marrëveshjet i komunikohen Komisionit i cili mund të konsultohet me Komitetin Këshillues për Kontratat Publike të përmendura në nenin 68;
- (b) sipas një marrëveshjeje ndërkombëtare në lidhje me stacionimin e trupave dhe që ka të bëjë me ndërmarrjet e një Shteti Anëtar ose një vendi të tretë;
- (c) sipas procedurës së veçantë të një organizate ndërkombëtare.

### Neni 23

#### **Kontratat e fituara nga një pjesëmarrje, sipërmarrje e përbashkët ose subjekt kontraktues pjesë e një sipërmarrjeje të përbashkët**

1. Në kuptim të këtij neni, "pjesëmarrja" është ajo ndërmarrje llogaritë vjetore të së cilës konsolidohen me ato të subjektit kontraktues në përputhje me kërkesat e Direktivës së Shtatë të Këshillit 83/349/KEE, datë 13 qershor 1983, bazuar në nenin 44 pika 2 shkronja (g) të Traktatit për llogaritë e konsoliduara [27][28] ose në rastin e subjekteve që nuk i nënshtrohen kësaj direktive, pjesëmarrja është ajo ndërmarrje mbi të cilën subjekti kontraktues mund të ushtrojë, drejtpërdrejt ose tërthorazi, ndikim dominues sipas kuptimit të nenit 2 pika 1 shkronja (b) të kësaj direktive, ose është ajo ndërmarrje që mund të ushtrojë ndikim dominues mbi subjektin kontraktues ose që, njësoj si subjekti kontraktues, i nënshtrohet ndikimit dominues të një ndërmarrjeje tjetër për shkak të pronësisë, pjesëmarrjes financiare ose rregullave që e rregullojnë.

2. Nëse plotësohen kushtet e pikës 3, kjo direktivë nuk zbatohet për kontratat e shpallura fituese:

- (a) nga një subjekt kontraktues për një pjesëmarrje, ose
- (b) nga një sipërmarrje e përbashkët, e krijuar ekskluzivisht nga disa subjekte kontraktuese për qëllim të kryerjes së veprimtarive sipas kuptimit të nenit 3 deri ne 7, për një sipërmarrje që është pjesëmarrje e njëres nga këto subjekte kontraktuese.

3. Pika 2 zbatohet:

- (a) për kontratat e shërbimeve nëse të paktën 80% e xhiros mesatare të pjesëmarrjes në lidhje me shërbimet për tre vitet paraprirëse rrjedh nga ofrimi i këtyre shërbimeve për ndërmarrjet për të cilat është pjesëmarrje;
- (b) për kontratat e furnizimit nëse të paktën 80% e xhiros mesatare të pjesëmarrjes në lidhje me furnizime për tre vitet paraprirëse rrjedh nga ofrimi i këtyre furnizimeve për ndërmarrjet për të cilat është pjesëmarrje;
- (c) për kontratat e punimeve nëse të paktën 80% e xhiros mesatare të pjesëmarrjes në lidhje me punimet për tre vitet paraprirëse rrjedh nga ofrimi i këtyre punëve për ndërmarrjet për të cilat është pjesëmarrje.

Nëse, për shkak të datës së krijimit ose të fillimit të veprimtarive të një filiali, nuk vihet në dispozicion xhiroja për tre vitet paraprirëse, mjafton që ndërmarrja të tregojë që xhiroja e përmendur në shkronjat (a), (b) ose (c) është e besueshme, sidomos me anë të parashikimeve të biznesit.

Nëse një ose më shumë pjesëmarrje të një subjekti kontraktues ofron shërbime, furnizime apo punime të njëjta ose të ngjashme, përqindjet e mësipërme llogariten duke pasur parasysh xhiron totale që rrjedh përkatësisht nga ofrimi i shërbimeve, furnizimeve ose punëve nga pjesëmarrjet.

4. Kjo direktivë nuk zbatohet për kontratat e shpallura fituese:

- (a) nga një sipërmarrje e përbashkët, e formuar ekskluzivisht nga disa subjekte kontraktuese për qëllim të kryerjes së veprimtarive sipas kuptimit të nenit 3 deri ne 7 për një nga këto sipërmarrje, ose
- (b) nga një subjekt kontraktues për një sipërmarrje të tillë të përbashkët, ku ai bën pjesë, nëse sipërmarrja e përbashkët është krijuar për të kryer veprimtarinë në fjalë për një periudhë të paktën

trevjeçare dhe nëse instrumenti që krijon sipërmarrjen e përbashkët përcakton që subjektet kontraktuese, që e përbëjnë atë, të jenë pjesë e saj për të paktën të njëjtën periudhë.

5. Subjektet kontraktuese vënë në dijeni Komisionin, me kërkesë të tij, për informacionin e mëposhtëm në lidhje me zbatimin e pikave 2, 3 dhe 4:

- (a) emrat e ndërmarrjeve ose sipërmarrjeve të përbashkëta të përfshira,
- (b) natyrën dhe vlerën e kontratave të përfshira,
- (c) provën që mund të gjykohet e nevojshme nga Komisioni që marrëdhënia ndërmjet ndërmarrjes ose sipërmarrjes së përbashkët fituese të kontratës dhe subjektit kontraktues është në përputhje me kërkesat e këtij neni.

### NËNSEKSIONI 3

Përfshirjet e zbatueshme për të gjitha subjektet kontraktuese, vetëm për kontratat e shërbimit

#### Neni 24

#### **Kontrata në lidhje me disa shërbime të përjashtuara nga fusha e veprimit të kësaj direktive**

Kjo direktivë nuk zbatohet për kontratat e shërbimit për:

- (a) blerjen ose dhënien me qira, me çfarëdo mjeti financiar, të tokës, ndërtesave ekzistuese, ose pasurive të tjera të paluajtshme ose të drejtave në lidhje me to; megjithatë, kontratat e shërbimeve financiare të lidhura në të njëjtën kohë, përpara ose pas kontratës për blerjen ose qiradhënien, në çfarëdo formë, i nënshtrohen kësaj direktive;
- (b) shërbime arbitrazhi dhe pajtimi;
- (c) shërbime financiare në lidhje me emetimin, shitjen, blerjen ose transferimin e letrave me vlerë a instrumenteve të tjera financiare, sidomos transaksione nga subjektet kontraktuese për të siguruar mjete monetare ose kapital;
- (d) kontrata punësimi;
- (e) shërbime kërkim-zhvillimi, që nuk përfshijnë ato ku përfitimet akumulohen veçanërisht për subjektin kontraktues për t'u përdorur nga ky i fundit në kryerjen e veprimtarive të veta, me kusht që shërbimi i ofruar të shpërblehet tërësisht nga subjekti kontraktues.

#### Neni 25

#### **Kontratat e shërbimit të fituara në bazë të një të drejte ekskluzive**

Kjo direktivë nuk zbatohet për kontratat e shërbimit të shpallura fituese nga një subjekt që është vetë autoritet kontraktues sipas kuptimit të nenit 2 pika 1 shkronja (a), ose nga një shoqatë e autoriteteve kontraktuese në bazë të një të drejte ekskluzive që gëzojnë sipas një akti ligjor, a akti nënligjor të publikuar, e cila është në përputhje me Traktatin.

### NËNSEKSIONI 4

Përfshirjet e zbatueshme vetëm për disa subjekte kontraktuese

#### Neni 26

#### **Kontratat e shpallura fituese nga disa subjekte kontraktuese për blerjen e ujit dhe për furnizimin me energji ose lëndë djegëse për prodhimin e energjisë**

Kjo direktivë nuk zbatohet:

- (a) për kontratat për blerjen e ujit nëse janë shpallur fituese nga subjekte kontraktuese të përfshira në një ose dy nga veprimtaritë e përmendura në nenin 4 pika 1.
- (b) për kontratat e furnizimit me energji ose lëndë djegëse për prodhimin e energjisë, nëse janë shpallur fituese nga subjektet kontraktuese të përfshira në veprimtarinë e përmendur në nenin 3 pika 1, nenin 3 pika 3, ose nenin 7 shkronja (a).

### NËNSEKSIONI 5

Kontratat që u nënshtrohen rregullave të veçanta, dispozitave në lidhje me organet qendrore të blerjes dhe procedurave të përgjithshme në rast të ekspozimit të drejtpërdrejtë ndaj konkurrencës

## Neni 27

### **Kontratat që u nënshtrohen rregullave të veçanta**

Pa cenuar nenin 30, Mbretëria e Vendeve të Ulëta, Mbretëria e Bashkuar, Republika e Austrisë dhe Republika Federale e Gjermanisë sigurojnë, me anë të kushteve të autorizimit ose masave të tjera të përshtatshme, që çdo subjekt që vepron në sektorët e përmendur në Vendimet 93/676/KEE, 97/367/KEE, 2002/205/KE dhe 2004/73/KE:

(a) të respektojë parimin e mosdiskriminimit dhe prokurimit konkurrues në lidhje me shpalljen e kontratave fituese për furnizime, punë dhe shërbime, sidomos për sa i përket informacionit që subjekti u vë në dispozicion operatorëve ekonomikë në lidhje me synimet e tij për prokurimin;

(b) t'i komunikojë Komisionit, sipas kushteve të përcaktuara në Vendimin e Komisionit 93/327/KEE që përcakton kushtet sipas të cilave subjektet kontraktuese që shfrytëzojnë zonat gjeografike për qëllim të eksplorimit ose nxjerrjes së naftës, gazit, qymyrit ose lëndëve të tjera djegëse të ngurta duhet t'i komunikojnë Komisionit informacionin për kontratat e shpallura fituese [29].

## Neni 28

### **Kontratat e rezervuara**

Shtetet Anëtare mund të rezervojnë të drejtën të marrin pjesë në procedura për shpalljen e kontratës fituese nga qendrat e punës ose të parashikojnë që këto kontrata të zbatohen në kontekstin e programeve të punësimit në qendra pune, ku shumica e punonjësve janë persona me aftësi të kufizuara fizike të cilët, për shkak të shkallës së aftësisë së kufizuar, nuk mund të vazhdojnë të punojnë në kushte normale.

Njoftimi i përdorur për ftesën për konkurrim i referohet këtij neni.

## Neni 29

### **Kontratat dhe marrëveshjet kuadër të shpallura fituese nga organe qendrore blerëse**

1. Shtetet Anëtare mund të përcaktojnë që autoritetet kontraktuese të blejnë punë, furnizime dhe/ose shërbime nga ose nëpërmjet një organi qendror blerës.

2. Subjektet kontraktuese që blejnë punime, furnizime dhe/ose shërbime nga/ose nëpërmjet një organi qendror blerës, në rastet e përcaktuara në nenin 1 pika 8, konsiderohen se e kanë përmbushur këtë direktivë sa kohë që organi qendror blerës e ka respektuar këtë direktivë ose, sipas rastit, Direktivën 2004/18/KE.

## Neni 30

### **Procedurat që përdoren për të parë nëse një veprimtari e caktuar është drejtpërdrejt e ekspozuar ndaj konkurrencës**

1. Kontratat që synojnë të mundësojnë zhvillimin e një veprimtarie të përmendur në nenin 3 deri në 7 nuk i nënshtrohen kësaj direktive nëse në Shtetin Anëtar ku zbatohet, veprimtaria është drejtpërdrejt e ekspozuar ndaj konkurrencës në tregje me hyrje të lirë.

2. Në kuptim të pikës 1, çështja nëse një veprimtari ekspozohet drejtpërdrejt ndaj konkurrencës vendoset në bazë të kritereve që janë në përputhje me dispozitat e Traktatit për konkurrencën, siç janë karakteristikat e mallrave ose shërbimeve në fjalë, ekzistenca e mallrave ose shërbimeve zëvendësuese, çmimet dhe prania aktuale ose e mundshme e më shumë se një furnizuesi mallrash ose shërbimesh në fjalë.

3. Në kuptim të pikës 1, hyrja në treg konsiderohet e lirë nëse Shteti Anëtar ka zbatuar dispozitat e legjislacionit komunitar të përmendur në Shtojcën XI.

Nëse hyrja e lirë në një treg të caktuar nuk mund të prezumohet në bazë të paragrafit të parë, duhet treguar që hyrja në tregun në fjalë është e lirë *de facto* dhe *de jure*.

4. Nëse një Shtet Anëtar konsideron që, në përputhje me pikat 2 dhe 3, pika 1 është e zbatueshme për një veprimtari të dhënë, ai njofton Komisionin dhe e vë në dijeni për të gjitha faktet e rëndësishme dhe sidomos për çdo akt ligjor, nënligjor a administrativ ose marrëveshje, në lidhje me respektimin e kushteve të përcaktuara në pikën 1, sipas rastit së bashku me qëndrimin e mbajtur nga një autoritet kombëtar i pavarur që është kompetent në lidhje me veprimtarinë në fjalë.

Kontratat që synojnë të mundësojnë zhvillimin e veprimtarisë në fjalë nuk i nënshtrohen më kësaj direktive nëse Komisioni:

- ka miratuar një vendim që përcakton zbatueshmërinë e pikës 1 në përputhje me pikën 6 dhe brenda periudhës që parashikon, ose

- nuk ka miratuar një vendim në lidhje me këtë zbatueshmëri brenda kësaj periudhe.

Megjithatë, nëse, në bazë të paragrafit të parë të pikës 1 prezumohet se ka hyrje të lirë në një treg të caktuar dhe nëse një autoritet kombëtar i pavarur që është kompetent për veprimtarinë në fjalë përcakton zbatueshmërinë e pikës 1, kontratat që synojnë të mundësojnë zhvillimin e veprimtarisë në fjalë, nuk i nënshtrohen më kësaj direktive nëse Komisioni nuk ka përcaktuar moszbatueshmërinë e pikës 1 me një vendim të miratuar në përputhje me pikën 6 dhe brenda periudhës që parashikon.

5. Subjektet kontraktuese, në rastet e parashikuara në legjislacionin e një Shteti Anëtar, mund t'i kërkojnë Komisionit të përcaktojë zbatueshmërinë e pikës 1 për një veprimtari të caktuar nëpërmjet një vendimi në përputhje me pikën 6. Në këtë rast, Komisioni njofton menjëherë Shtetin Anëtar të përfshirë.

Ky Shtet Anëtar, duke pasur parasysh pikën 2 dhe 3, njofton Komisionin për të gjitha faktet e rëndësishme dhe sidomos për çdo akt ligjor, a akt nënligjor ose marrëveshje në lidhje me plotësimin e kushteve të përcaktuara në pikën 1, sipas rastit, së bashku me qëndrimin e mbajtur nga një autoritet kombëtar i pavarur që është kompetent për veprimtarinë.

Komisioni gjithashtu mund të fillojë procedurën për miratimin e një vendimi që përcakton zbatueshmërinë e pikës 1 për një veprimtari të caktuar me nismën e tij. Në këtë rast, Komisioni njofton menjëherë Shtetin Anëtar të përfshirë.

Nëse, në përfundim të periudhës së përcaktuar në pikën 6, Komisioni nuk ka miratuar një vendim në lidhje me zbatueshmërinë e pikës 1 për një veprimtari të caktuar, pika 1 nuk konsiderohet e zbatueshme.

6. Komisionit, për miratimin e një vendimi sipas këtij neni, në përputhje me procedurën sipas nenit 68 pika 2 i lejohej një periudhë tremujore duke filluar nga dita e parë e punës pas datës së marrjes së njoftimit ose kërkesës. Megjithatë, kjo periudhë mund të zgjatet një herë deri në tre muaj për arsye të justifikuar si duhet, në veçanti nëse informacioni që përmban njoftimi ose kërkesa ose dokumente shtojcë të tij, është i paplotë ose i pasaktë, ose nëse faktet e raportuara ndryshojnë ndjeshëm. Kjo zgjatje kufizohet në një muaj nëse një autoriteti kombëtar i pavarur, përgjegjës për veprimtarinë e përfshirë, ka përcaktuar zbatueshmërinë e pikës 1 në rastet e parashikuara sipas paragrafit të tretë të pikës 4.

Nëse në një Shtet Anëtar të caktuar një veprimtari i nënshtrohet procedurës sipas këtij neni, kërkesat e mëtejshme në lidhje me të njëjtin veprimtari në të njëjtin Shtet Anëtar përpara mbarimit të periudhës së përcaktuar në lidhje me kërkesën e parë nuk konsiderohen si procedura të reja dhe trajtohen në kontekst të kërkesës së parë.

Komisioni miraton rregulla të detajuara për zbatimin e pikës 4, 5 dhe 6 në përputhje me procedurën sipas nenit 68 pika 2.

Këto rregulla përfshijnë të paktën:

(a) botimin në Gazetën Zyrtare, për dijeni, të datës së fillimit të periudhës tremujore të përmendur në paragrafin e parë dhe, në rast të zgjatjes së kësaj periudhe, të datës së zgjatjes dhe periudhës me të cilën është zgjatur;

(b) botimin e zbatueshmërisë së mundshme të pikës 1 në përputhje me paragrafin e dytë ose të tretë të pikës 4, ose në përputhje me paragrafin e katërt të pikës 5; dhe

(c) rregullat për përcjelljen e qëndrimeve të miratuara nga një autoritet i pavarur që është kompetent për veprimtarinë në fjalë, për çështje në lidhje me pikën 1 dhe 2.

### KAPITULLI III

#### Rregullat e zbatueshme për kontratat e shërbimeve

Neni 31

### **Kontratat e shërbimeve të renditura në Shtojcën XVII A**

Kontratat që kanë për objekt shërbimet e renditura në Shtojcën XVII A shpallen fituese në përputhje me nenet 34 deri në 59.

Neni 32

### **Kontratat e shërbimeve të renditura nga Shtojcën XVII B**

Kontratat që kanë si objekt shërbimet e renditura në Shtojcën XVII B rregullohen vetëm nga neni 34 dhe neni 43.

Neni 33

### **Kontratat e përziera të shërbimeve që përfshijnë shërbimet e renditura në Shtojcën XVII A dhe shërbimet e renditura në Shtojcën XVII B**

Kontratat që kanë si objekt shërbimet e renditura si në Shtojcën XVII A ashtu dhe në Shtojcën XVII B shpallen fituese në përputhje me nenet 34 deri në 59 nëse vlera e shërbimeve të renditura në Shtojcën XVII A është më e madhe se vlera e shërbimeve të renditura në Shtojcën XVII B. Në raste të tjera, kontratat shpallen fituese në përputhje me nenin 34 dhe 43.

## **KAPITULLI IV**

Rregullat specifike që rregullojnë specifikimet dhe dokumentet e kontratës

Neni 34

### **Specifikimet teknike**

1. Specifikimet teknike siç e përcakton paragrafi 1 i Shtojcës XXI përcaktohen në dokumentacionin e kontratës, siç janë njoftimet e kontratës, dokumentet e kontratës ose dokumente shtesë. Subjektet kontraktuese, kur është e mundur, duhet të përcaktojnë specifikimet teknike për të marrë parasysh mundësinë e përdorimit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit.
2. Specifikimet teknike ofrojnë të njëjtën mundësi pjesëmarrjeje për ofertuesit dhe nuk kanë efektin e krijimit të pengesave të pajustificuara për hapjen e prokurimit publik ndaj konkurrencës.
3. Pa cenuar rregullat teknike kombëtare të detyrueshme me ligj, në masën që janë në përputhje me legjislacionin komunitar, specifikimet teknike formulohen:
  - (a) ose duke u mbështetur në specifikimet teknike të përcaktuara në Shtojcën XXI dhe, sipas radhës së preferencës, në standardet kombëtare që transpozojnë standardet europiane, aprovimet teknike europiane, specifikimet e përbashkëta teknike, standardet ndërkombëtare, sisteme të tjera mbështetëse teknike, të krijuara nga organe standardizimi europiane ose - nëse këto nuk ekzistojnë – duke u mbështetur në standardet kombëtare, aprovimet teknike kombëtare, ose specifikimet tekniket kombëtare në lidhje me projektimin, llogaritjen dhe ekzekutimin e punimeve dhe përdorimin e produkteve. Sa herë që bëhet lidhja me sa më lart, kjo shoqërohet me fjalët “ose i barasvlershëm”;
  - (b) ose në lidhje me kërkesat e zbatimit apo funksionale; këto të fundit mund të përfshijnë karakteristika mjedisore. Megjithatë, këto parametra duhet të jenë mjaftueshëm të sakta që të bëjnë të mundur që ofertuesit të përcaktojnë objektin e kontratës dhe të lejojnë subjektet kontraktuese të shpallin fituese një kontratë;
  - (c) ose në lidhje me kërkesat e zbatimit apo funksionale siç përmendet në shkronjën (b), duke u mbështetur në specifikimet e përmendura në shkronjën (a) si mjet për të prezumuar përputhjen me këto kërkesa zbatimi ose funksionale;
  - (d) ose duke u mbështetur në specifikimet e përmendura në shkronjën (a) për disa karakteristika dhe në kërkesat e zbatimit ose ato funksionale të përmendura në shkronjën (b) për karakteristika të tjera.
4. Nëse një subjekt kontraktues mbështetet te specifikimet e përmendura në pikën 3 shkronja (a), ai nuk mund ta refuzojë ofertën me arsyen që produktet dhe shërbimet e tenderuara nuk i përmbushin specifikimet te të cilat mbështetet ai, nëse ofertuesi në ofertën e tij i provon në mënyrë të kënaqshme

subjektit kontraktues, me çfarëdo mjeti të duhur, që zgjidhjet që propozon plotësojnë në mënyrë të barasvlershme kërkesat e përcaktuara në specifikimet teknike.

Mjetet e duhura mund të përbëhen nga një dosje teknike nga prodhuesi ose një raport testimi nga një organ i njohur.

5. Nëse një subjekt kontraktues përdor mundësinë e parashikuar në pikën 3 të përcaktimit të kërkesave të zbatimit, ose funksionale, ai nuk mund të refuzojë një ofertë për produkte, shërbime ose punë që përmbush një standard kombëtar i cili transponon një standard evropian, një aprovim teknik evropian, një specifikim teknik të përbashkët, një standard ndërkombëtar, një sistem reference teknike të krijuar nga një organ evropian standardizimi, nëse këto specifikime trajtojnë kërkesat e zbatimit ose funksionale që ai ka përcaktuar.

Në ofertën e tij, ofertuesi i provon në mënyrë të kënaqshme subjektin kontraktues dhe me mjete të duhura që produkti, shërbimi ose puna në përputhje me standardet plotëson kërkesat e zbatimit ose funksionale të subjektit kontraktues.

Mjetet e duhura mund të përbëhen nga një dosje teknike nga prodhuesi ose një raport testimi nga një organ i njohur.

6. Nëse subjektet kontraktuese përcaktojnë karakteristika mjedisore në lidhje me kërkesat e zbatimit ose funksionale, siç përmenden në pikën 3 shkronja (b), ato mund të përdorin specifikime të detajuara, ose nëse është e nevojshme, pjesë të tyre, siç e përcaktojnë eko-etiketat (shumë) kombëtare ose europiane ose një tjetër eko-etiketë, nëse:

- këto specifikime janë të duhura për të përcaktuar karakteristikat e furnizimeve ose shërbimeve që janë objekt i kontratës,

- kërkesat për etiketë janë hartuar në bazë të informacionit shkencor,

- eko-etiketat miratohen duke përdorur një procedurë ku mund të marrin pjesë të gjithë aktorët, si organet e qeverisë, konsumatorët, prodhuesit, shpërndarësit dhe organizatat mjedisore, dhe

- të gjitha palët e interesuara mund t'i përdorin.

Subjektet kontraktuese mund të tregojnë që produktet dhe shërbimet që kanë eko-etiketën prezumohen se plotësojnë kërkesat teknike të përcaktuara në dokumentet e kontratave; ato duhet të pranojnë mjete të tjera të përshtatshme vërtetimi, si një dosje teknike nga prodhuesi ose një raport testimi nga një organ i njohur.

7. "Organe të njohura" sipas kuptimit të këtij neni janë laboratorët e testimit dhe kalibrimit dhe organe certifikimi dhe inspektimi që përmbushin standardet e zbatueshme europiane.

Subjektet kontraktuese pranojnë certifikatat nga organet e njohura të krijuara në Shtete të tjera Anëtare.

8. Specifikimet teknike, nëse nuk justifikohen nga objekti i kontratës, nuk duhet të kërkojnë një prodhim a burim specifik, ose një proces të veçantë, ose marka tregtare, patenta, lloje a një origjinë a prodhim specifik me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa ndërmarrjeve ose disa produkteve. Kjo kërkesë lejohet, në raste përjashtimore, nëse nuk është i mundur një përshkrim mjaft i saktë dhe i kuptueshëm i objektit të kontratës sipas pikave 3 dhe 5; kjo kërkesë duhet të shoqërohet me fjalën "ose i barasvlershëm".

Neni 35

### **Komunikimi i specifikimeve teknike**

1. Subjektet kontraktuese me kërkesë të operatorëve ekonomikë të interesuar për fitimin e një kontrate vënë në dispozicion specifikimet teknike të përmendura rregullisht në kontratat e tyre të furnizimit, punës ose shërbimit, ose specifikimet teknike që synojnë të përdorin për kontratat që i mbulojnë njoftimet orientuese periodike sipas kuptimit të nenit 41 pika 1.

2. Nëse specifikimet teknike bazohen në dokumente në dispozicion të operatorëve ekonomikë të interesuar, mjafton të bëhet lidhja me këto dokumente.

Neni 36



## **Variantet**

1. Nëse kriteri për shpalljen e kontratës fituese është ai i ofertës me përfitim më të madh ekonomik, subjektet kontraktuese mund të marrin parasysh variantet që janë paraqitur nga një ofertues dhe plotësojnë kërkesat minimale të specifikuara nga subjektet kontraktuese.

Subjektet kontraktuese tregojnë në specifikime nëse autorizojnë apo jo variante dhe, nëse është kështu, kërkesat minimale që duhet të plotësohen nga variantet dhe çdo kërkesë specifike për paraqitjen e tyre.

2. Në procedurat për shpalljen e kontratave fituese për furnizim ose shërbim, autoritetet kontraktuese që kanë autorizuar variante sipas pikës 1 nuk mund të refuzojnë një variant me arsyen e vetme që, nëse është i suksesshëm, do të çojë në një kontratë shërbimi në vend të një kontrate furnizimi, ose në një kontratë furnizimi në vend të një kontrate shërbimi.

### **Neni 37**

#### **Nënkontraktimi**

Subjekti kontraktues në dokumentet e kontratave mund të kërkojë ose atij mund t'i kërkohet nga një Shtet Anëtar t'i kërkojë ofertuesit të tregojë në ofertën e tij çdo pjesë të kontratës për të cilën synon të nënkontrakttojë palë të treta dhe çdo nënkontraktues të propozuar. Kjo nuk cenon çështjen e përgjegjësisë parësore të operatorit ekonomik.

### **Neni 38**

#### **Kushtet e zbatimit të kontratave**

Subjektet kontraktuese mund të përcaktojnë kushtet e veçanta në lidhje me zbatimin e një kontrate, nëse këto janë në përputhje me legjislacionin komunitar dhe të tregohen në njoftimin e përdorur si mënyrë për të ftuar për konkurrim ose në specifikime. Kushtet që rregullojnë zbatimin e një kontrate, në veçanti, mund të përfshijnë konsiderata sociale dhe mjedisore.

### **Neni 39**

#### **Detyrimet në lidhje me tatimet, mbrojtjen mjedisore, dispozitat e mbrojtjes së marrëdhënieve të punës dhe kushtet e punës**

1. Subjekti kontraktues mund të përcaktojë në dokumentet e kontratave, ose mund t'ia kërkojë një Shtet Anëtar të përcaktojë, organin ose organet nga të cilat një kandidat ose një ofertues mund të marrë informacionin e duhur për detyrimet në lidhje me tatimet, mbrojtjen mjedisore, dispozitat e mbrojtjes dhe kushtet e punës që janë në fuqi në Shtetin Anëtar, në rajonin ose në vendin ku ofrohen shërbimet dhe që janë të zbatueshme për punimet e kryera në vend ose për shërbimet e ofruara gjatë zbatimit të kontratës.

2. Subjekti kontraktues që siguron informacionin e përmendur në pikën 1 u kërkon ofertuesve ose kandidatëve në procedurën e shpalljes së kontratave fituese të tregojnë që i kanë marrë parasysh, në hartimin e ofertës së tyre, detyrimet që lidhen me dispozitat e mbrojtjes së marrëdhënieve të punës dhe kushtet e punës që janë në fuqi në vendin ku do të ofrohet shërbimi.

Paragrafi i parë nuk cenon zbatimin e nenit 57.

## **KAPITULLI V**

### **Procedurat**

### **Neni 40**

#### **Përdorimi i procedurave të hapura, të kufizuara dhe me negociim**

1. Në shpalljen e kontratave fituese për furnizime, punime ose shërbime, subjektet kontraktuese përdorin procedurat e rregulluara për qëllimet e kësaj direktive.

2. Subjektet kontraktuese mund të zgjedhin një nga procedurat e përcaktuara në nenin 1 pika 9 shkronja (a), (b) ose (c) nëse, sipas pikës 3, ftesa për konkurrim është bërë në përputhje me nenin 42.

3. Subjektet kontraktuese mund të përdorin një procedurë pa ftesën paraprake për konkurrim në rastet e mëposhtme:

(a) nëse nuk është paraqitur asnjë ofertë ose ofertë e përshtatshme ose asnjë aplikim në përgjigje të një procedure me ftesë paraprake për konkurrim, me kusht që kushtet fillestare të kontratës të mos ndryshohen në mënyrë thelbësore;

(b) nëse një kontratë është krejtësisht për qëllim kërkimi, eksperimenti, studimi ose zhvillimi dhe jo për qëllim të sigurimit të një përfitimi ose rikuperimi të kostove për kërkim dhe zhvillim, dhe në masën që shpallja e kësaj kontrate fituese nuk cenon, në kushtet e konkurrencës, fitimin e kontratave vijuese të cilat nuk synojnë, arritjen e atyre qëllimeve në veçanti;

(c) nëse, për arsye teknike ose artistike, ose për arsye që lidhen me mbrojtjen e të drejtave ekskluzive, kontrata mund të ekzekutohet vetëm nga një operator i veçantë ekonomik;

(d) për aq sa është rigorozisht e nevojshme, nëse për shkak të një urgjencë ekstreme të shkaktuar nga ngjarje të paparashikueshme nga subjektet kontraktuese, nuk mund të respektohen afatet kohore të përcaktuara për procedurat e hapura, procedurat e kufizuara dhe procedurat me negociim me ftesë paraprake për konkurrim;

(e) në rastin e kontratave të furnizimit për dërgesa shtesë nga furnizuesi fillestar që janë ose zëvendësim i pjesshëm i furnizimeve të zakonshme ose instalimeve ose shtrirje e furnizimeve ose instalimeve ekzistuese, nëse një ndryshim i furnizuesit do të detyronte subjektin kontraktues të siguronte material me karakteristika të ndryshme teknike, përdorimi ose mirëmbajtja e të cilit do të rezultonte në papajtueshmëri ose vështirësi teknike në disproporcion;

(f) për punime ose shërbime shtesë që nuk janë përfshirë në projektin e shpallur fillimisht fitues ose në kontrata të lidhura në fillim por që, nëpërmjet rrethanave të paparashikuara, janë bërë të rëndësishme për zbatimin e kontratës, me kusht që kontrata fituese të shpallet për kontraktuesin ose ofruesin e shërbimit që ekzekuton kontratën fillestare:

- nëse këto punime ose shërbime shtesë nuk mund të ndahen teknikisht apo ekonomikisht nga kontrata kryesore, pa shkaktuar problem të madh për subjektet kontraktuese, ose

- nëse këto punime ose shërbime shtesë, edhe pse mund të ndahen nga zbatimi i kontratës fillestare, janë rigorozisht të nevojshme në fazat e mëtejshme të saj;

(g) në rastin e kontratave për punë, punë të reja që kanë të bëjnë me përsëritjen e punimeve të njëjta që i janë ngarkuar sipërmarrësit për të cilin të njëjtat subjekte kontraktuese kanë shpallur kontratën fituese të mëparshme, me kusht që këto punime të jenë në përputhje me një projekt bazë për të cilin është shpallur fituese kontrata e parë pas një ftesë për konkurrim; sapo projekti i parë paraqitet për ofertë, jepet njoftim që kjo procedurë mund të miratohet dhe kostoja totale e çmuar e punimeve vijuese do të merret parasysh nga subjektet kontraktuese kur të zbatojnë dispozitat e nenit 16 dhe 17;

(h) për furnizime të kuotuar dhe të blera në tregun e mallrave;

(i) për kontrata që shpallen fituese në bazë të një marrëveshjeje kuadër, me kusht që të plotësohet kushti i përmendur në nenin 14 pika 2;

(j) për blerje me leverdi, nëse është e mundur prokurimi i furnizimeve duke përfituar nga një mundësi veçanërisht përfituese në dispozicion për një kohë shumë të shkurtër me çmim më të ulët sesa çmimet normale në treg;

(k) për blerje të furnizimeve në kushte veçanërisht fitimprurëse ose nga një furnizues që mbyll përfundimisht veprimtarinë e biznesit, ose nga marrësit apo likuiduesit e një falimentimi, një marrëveshjeje me kreditorët ose një procedure të ngjashme sipas ligjeve ose rregulloreve kombëtare;

(l) nëse kontrata për shërbimin në fjalë është pjesë e vazhimit të një konkursi projektimi të organizuar në përputhje me dispozitat e kësaj direktive dhe, në përputhje me rregullat përkatëse, shpallet fituese nga një fitues ose disa fitues të konkursit; në rastin e fundit, të gjithë fituesit ftohen të marrin pjesë në negociim.

## KAPITULLI VI

### Rregullat për publikimin dhe transparencën

#### Seksioni 1

#### Publikimi i njoftimeve

## Neni 41

### **Njoftimet periodike orientuese dhe njoftimet për ekzistencën e një sistemi kualifikimi**

1. Subjektet kontraktuese bëjnë të ditur, të paktën një herë në vit, me anë të një njoftimi periodik orientues siç përmendet në Shtojcën XV A të publikuar nga Komisioni ose nga ata vetë në “profilin e blerësit”, siç e përshkruan pika 2 shkronja (b) e Shtojcës XX:

(a) kur bëhet fjalë për furnizime, vlerën totale të çmuar të kontratave ose marrëveshjeve kuadër sipas fushës së produktit, të cilat synojnë të shpallin fituese gjatë 12 muajve të ardhshëm, nëse vlera totale e çmuar, duke pasur parasysh dispozitat e nenit 16 dhe 17 është e njëjtë ose më e madhe se 750 000 euro.

Zona e produktit përcaktohet nga subjektet kontraktuese duke u mbështetur në nomenklaturën FPP:

(b) kur bëhet fjalë për shërbime, vlerën totale të çmuar të kontratave ose marrëveshjeve kuadër në secilën kategori të shërbimeve të renditura në Shtojcën XVII A, të cilat synojnë të shpallin fituese gjatë periudhës së ardhshme 12-mujore, vlera totale e çmuar, duke pasur parasysh dispozitat e nenit 16 dhe 17, është e njëjtë ose më e madhe se 750 000 euro;

(c) kur bëhet fjalë për punime, karakteristikat thelbësore të kontratave të punimeve ose marrëveshjeve kuadër që synojnë të shpallin fituese gjatë 12 muajve të ardhshëm, vlera e çmuar e të cilave është e barabartë ose më e madhe se kufiri monetar i specifikuar në nenin 16, duke pasur parasysh dispozitat e nenit 17.

Njoftimet e përmendura në shkronjat (a) dhe (b) i dërgohen Komisionit ose publikohen në profilin e blerësit sa më shpejt që të jetë e mundur pas fillimit të vitit buxhetor.

Njoftimi i përmendur në shkronjën (c) i dërgohet Komisionit ose publikohet në profilin e blerësit sa më shpejt që të jetë e mundur pas vendimit që miraton planifikimin e kontratave të punëve ose marrëveshjeve kuadër që subjektet kontraktuese synojnë të shpallin fituese.

Subjektet kontraktuese që publikojnë një njoftim periodik orientues në profilet e blerësve të tyre i përcjellin Komisionit, në rrugë elektronike, një kopje të njoftimit periodik orientues të publikuar në profilin e blerësit, në përputhje me formatin dhe procedurat për përcjelljen elektronike të njoftimeve të përmendur në pikën 3 të Shtojcës XX.

Publikimi i njoftimeve të përmendura në shkronjat (a), (b) dhe (c) është i detyrueshëm vetëm nëse subjektet kontraktuese zgjedhin mundësinë e shkurtimit të afateve kohore për marrjen e ofertave, siç e përcakton neni 45 pika 4.

Kjo pikë nuk zbatohet për procedurat pa ftesë paraprake për konkurrim.

2. Subjektet kontraktuese mund të publikojnë veçanërisht ose të rregullojnë që Komisioni të publikojë njoftime periodike orientuese në lidhje me projekte të mëdha, pa përsëritur informacion të përfshirë më përpara në njoftimin periodik orientues, nëse vihet qartë në dukje që këto njoftime janë shtesë krahas të tjerave.

3. Nëse subjektet kontraktuese zgjedhin të krijojnë një sistem kualifikimi në përputhje me nenin 53, sistemi i nënshtrohet një njoftimi siç e përcakton Shtojca XVI, i cili tregon qëllimin e sistemit të kualifikimit dhe mënyrën e dhënies së mundësisë së shikimit të rregullave në lidhje me funksionimin e tij. Nëse sistemi ka kohëzgjatje më të madhe se tre vjet, njoftimi publikohet çdo vit. Nëse sistemi është me kohëzgjatje më të shkurtër, mjafton një njoftim fillestar.

## Neni 42

### **Njoftimet e përdorura si mjete për të ftuar për konkurrim**

1. Në rast të kontratave për furnizim, punë ose shërbim, ftesa për konkurrim mund të bëhet:

(a) me anë të një njoftimi periodik orientues siç përcaktohet në Shtojcën XVA; ose

(b) me anë të një njoftimi për ekzistencën e një sistemi kualifikimi siç përcaktohet në Shtojcën XIV; ose

(c) me anë të një njoftimi kontrate siç përcaktohet në Shtojcën XII A, B ose C.

2. Në rast të sistemeve dinamike të blerjeve, ftesa për konkurrim e sistemit bëhet me njoftim kontrate siç përcakton pika 1 shkronja (c) ndërsa ftesa për konkurrim për kontrata të bazuar në këto sisteme bëhet me kontratë njoftimi të thjeshtuar siç përcaktohet në Shtojcën XIII D.

3. Nëse ftesa për konkurrim bëhet me anë të një njoftimi periodik orientues, njoftimi:

(a) përmend në mënyrë specifike furnizimet, punët ose shërbimet që janë objekt i kontratës e cila do të shpallet fituese;

(b) tregon që kontrata do të shpallet fituese me procedurë të kufizuar ose me negociim pa publikim të mëtejshëm të njoftimit për ftesë për konkurrim dhe fton operatorët ekonomikë të interesuar të shprehin interesin e tyre me shkrim; dhe

(c) publikohet në përputhje me Shtojcën XX jo më shumë se 12 muaj përpara datës së dërgimit të ftesës së përmendur në nenin 47 pika 5. Gjithashtu, subjekti kontraktues respekton afatet kohore të përcaktuara në nenin 45.

#### Neni 43

### Njoftimet e kontratës fituese

1. Subjektet kontraktuese që kanë shpallur fituese një kontratë ose marrëveshje kuadër, brenda dy muajve nga shpallja fituese e kontratës ose marrëveshjes kuadër, dërgojnë një njoftim për shpalljen e kontratës fituese siç përmendet në Shtojcën XVI sipas kushteve që duhen përcaktuar nga Komisioni në përputhje me procedurën e përmendur në nenin 68 pika 2.

Në rast të kontratave të shpallura fituese sipas një marrëveshjeje kuadër sipas kuptimit të nenit 14 pika 2, subjektet kontraktuese nuk janë të detyruara të dërgojnë njoftim për rezultatin e procedurës së shpalljes së kontratës fituese për asnjë kontratë të bazuar në atë marrëveshje.

Subjektet kontraktuese dërgojnë njoftim për shpalljen e kontratës fituese bazuar në një sistem dinamik blerjeje brenda dy muajve pas shpalljes kontratës fituese. Megjithatë, ato mund të grupojnë këto njoftime çdo tremujor. Në këtë rast, ato i dërgojnë njoftimet e grupuara brenda dy muajve nga fundi i çdo tremujori.

2. Informacioni që jepet në përputhje me Shtojcën XVI dhe i synuar për t'u publikuar publikohet në përputhje me Shtojcën XX. Në këtë drejtim, Komisioni respekton çdo aspekt tregtar delikat që subjektet kontraktuese mund të vënë në dukje kur dërgojnë këtë informacion, në lidhje me numrin e ofertave të marra, identitetin e operatorëve ekonomikë, ose çmimet.

3. Nëse subjektet kontraktuese shpallin fituese një kontratë shërbimi për kërkim dhe zhvillim ("kontratë K&ZH") me anë të një procedure pa ftesë për konkurrim, në përputhje me nenin 40 pika 3 shkronja (b), ato, kur përmendin "shërbimin e kërkimit dhe zhvillimit", mund të kufizojnë informacionin që duhet dhënë në përputhje me Shtojcën XVI në lidhje me natyrën dhe sasinë e shërbimeve të ofruara.

Nëse subjektet kontraktuese shpallin fituese një kontratë K&ZH që nuk mund të shpallet fituese me anë të një procedure pa ftesë për konkurrim në përputhje me nenin 40 pika 3 shkronja (b), ato, për arsye të kondifencialitetit tregtar, e kufizojnë informacionin që duhet të jepet në përputhje me Shtojcën XVI në lidhje me natyrën dhe sasinë e shërbimeve të ofruara.

Në këto raste, subjektet kontraktuese sigurohen që informacioni i publikuar sipas kësaj pike të mos jetë më pak i detajuar sesa ai që përmban njoftimi për ftesën për konkurrim i publikuar në përputhje me nenin 42 pika 1.

Nëse përdorin sistem kualifikimi, subjektet kontraktuese në këto raste sigurohen që informacioni të mos jetë më pak i detajuar sesa kategoria e përmendur në listën e ofruesve të shërbimit të kualifikuar të hartuar në përputhje me nenin 53 pika 7.

4. Në rastin e kontratave të shpallura fituese për shërbimet e renditura në Shtojcën XVII B, subjektet kontraktuese tregojnë në njoftim nëse pranojnë apo jo publikimin e tyre.

5. Informacioni i siguruar në përputhje me Shtojcën XVI dhe i shënuar si informacion që nuk është synuar për publikim, publikohet vetëm në formë të thjeshtuar dhe në përputhje me Shtojcën XX për qëllime statistikore.

### **Forma dhe mënyra e publikimit të njoftimeve**

1. Njoftimet përfshijnë informacionin e përmendur në Shtojcat XIII, XIV, XV A, XV B dhe XVI dhe sipas rastit, çdo informacion tjetër që konsiderohet i nevojshëm nga subjekti kontraktues në formatin e formularëve standardë të miratuar nga Komisioni në përputhje me procedurën e përmendur në nenin 68 pika 2.

2. Njoftimet e dërguara nga subjektet kontraktuese tek Komisioni dërgohen ose me mjete elektronike, në përputhje me formatin dhe procedurat për transmetim të cilat përcaktohen në pikën 3 të Shtojcës XX, ose me mjete të tjera.

Njoftimet e përmendura në nenet 41, 42 dhe 43 publikohen në përputhje me karakteristikat teknike për publikim të përcaktuara në pikën 1 shkronja (a) dhe (b) të Shtojcës XX.

3. Njoftimet e hartuara dhe të transmetuara me mjete elektronike në përputhje me formatin dhe procedurat për transmetim të cilat përcaktohen në pikën 3 të Shtojcës XX, publikohen jo më vonë se pesë ditë pas dërgimit të tyre.

Njoftimet që nuk përcillen me mjete elektronike sipas formatit dhe procedurës për transmetim të përcaktuar në pikën 3 të Shtojcës XX publikohen jo më vonë se 12 ditë pas dërgimit të tyre. Megjithatë, në raste përjashtimore, njoftimet e kontratave të përmendura në nenin 42 pika 1 shkronja (c) publikohen brenda pesë ditëve në përgjigje të një kërkesë nga subjekti kontraktues, me kusht që njoftimi të jetë dërguar me faks.

4. Njoftimet e kontratave publikohen të plota në gjuhën zyrtare të Komunitetit të zgjedhur nga subjekti kontraktues; ky variant në gjuhë origjinale përbën tekstin e vetëm origjinal. Një përmbledhje e elementeve të rëndësishme të çdo njoftimi publikohet në gjuhët e tjera zyrtare.

Kostot e publikimit të njoftimeve nga Komisioni mbulohen nga Komuniteti.

5. Njoftimet dhe përmbajtja e tyre nuk mund të publikohen në nivel kombëtar përpara datës në të cilën i janë dërguar Komisionit.

Njoftimet e publikuara në nivel kombëtar nuk përmbajnë informacion tjetër nga ai që përmbajnë njoftimet dërguar Komisionit ose që janë publikuar në një profil blerësi në përputhje me paragrafin e parë të nenit 41 pika 1, por përcaktojnë datën e dërgimit të njoftimit tek Komisioni ose të publikimit të tij në profilin e blerësit.

Njoftimet periodike orientuese nuk mund të publikohen në profilin e blerësit përpara dërgimit tek Komisioni të njoftimit të publikimit në atë formë; ato tregojnë datën e dërgesës.

6. Subjektet kontraktuese sigurohen që të jenë në gjendje të sjellin provën e datave në të cilat janë dërguar njoftimet.

7. Komisioni i jep subjektit kontraktues konfirmimin e publikimit të informacionit të dërguar duke përmendur datën e atij publikimi. Ky konfirmim përbën provën e publikimit.

8. Subjektet kontraktuese mund të publikojnë në përputhje me pikat 1 deri në 7 njoftimet e kontratave që nuk i nënshtrohen kërkesave të publikimit të përcaktuara në këtë direktivë.

### **Seksioni 2 Afatet kohore**

### **Afatet kohore për marrjen e kërkesave për pjesëmarrje dhe për marrjen e ofertave**

1. Në përcaktimin e afateve kohore për kërkesat për pjesëmarrje dhe marrjen e ofertave, subjektet kontraktuese marrin veçanërisht parasysh kompleksitetin e kontratës dhe kohën e kërkuar për hartimin e ofertave, pa cenuar afatet minimale të përcaktuara nga ky nen.

2. Në rast të procedurave të hapura, afati kohor minimal për marrjen e ofertave është 52 ditë nga data e dërgimit të njoftimit të kontratës.

3. Në procedura të kufizuara dhe procedura me negociim me ftesën paraprake për konkurrim, zbatohen rregullat e mëposhtme:

(a) afati kohor për marrjen e kërkesës për pjesëmarrje, në përgjigje të një njoftimi të publikuar sipas nenit 42 pika 1 shkronja (c) ose në përgjigje të një ftese nga subjektet kontraktuese sipas nenit 47 pika 5, si rregull i përgjithshëm, përcaktohet jo më pak se 37 ditë nga data e dërgimit të njoftimit ose ftesës dhe në asnjë rast nuk mund të jetë më pak se 22 ditë nëse njoftimi është dërguar për publikim me mjete të ndryshme nga mjetet elektronike ose faks dhe jo më pak se 15 ditë nëse njoftimi është transmetuar me këto mjete;

(b) afati kohor për marrjen e ofertave mund të caktohet me marrëveshje të ndërsjellë ndërmjet subjektit kontraktues dhe kandidatëve të përzgjedhur nëse të gjithë kandidatët kanë kohë të njëjtë për të përgatitur dhe paraqitur ofertat e tyre;

(c) kur nuk është e mundur të lidhet një marrëveshje për afatin kohor për marrjen e ofertave, subjekti kontraktues përcakton një afat që si rregull i përgjithshëm është jo më pak se 24 ditë dhe në asnjë rast nuk është më pak se 10 ditë nga data e ftesës për ofertë.

4. Nëse subjektet kontraktuese kanë publikuar një njoftim periodik orientues, siç përmendet në nenin 41 pika 1 në përputhje me Shtojcën XX, afati minimal për marrjen e ftesave në procedura të hapura si rregull i përgjithshëm nuk është më pak se 36 ditë, por në asnjë rast nuk është më pak se 22 ditë nga data e dërgimit të njoftimit.

Këto afate kohore të shkurtuara lejohen nëse njoftimi periodik orientues përfshin, përveç informacionit të kërkuar nga Shtojca XVA, pjesa I, të gjithë informacionin e kërkuar në Shtojcën XV A, pjesa II, sa kohë që ky informacion i fundit është në dispozicion në kohën e publikimit të njoftimit dhe njoftimi është dërguar për publikim ndërmjet 52 ditëve dhe 12 muajve përpara datës së dërgimit të njoftimit të kontratës të përmendur në 42 pika 1 shkronja (c).

5. Nëse njoftimet hartohen dhe transmetohen me mjete elektronike në përputhje me formatin dhe procedurat për transmetim të përmendura në pikën 3 të Shtojcës XX, afatet kohore për marrjen e kërkesave për pjesëmarrje në procedura të kufizuara dhe me negociim dhe për marrjen e ftesave në procedura të hapura mund të shkurtohet me shtatë ditë.

6. Përveç rastit të një afati kohor të caktuar me marrëveshje të ndërsjellë në përputhje me pikën 3 shkronja (b), afatet kohore për marrjen e ofertave në procedura të hapura, të kufizuara dhe me negociim mund të shkurtohet më tej me pesë ditë nëse subjekti kontraktues ofron akses të drejtpërdrejtë të plotë dhe të pakufizuar në dokumentet e kontratave dhe çdo dokument tjetër shtesë me mjete elektronike nga data e publikimit të njoftimit të përdorur si mjet për ftesë për konkurrim, në përputhje me Shtojcën XX. Njoftimi duhet të specifikojë adresën e internetit ku mund të gjendet ky dokumentacion.

7. Në procedura të hapura, efekti i mbledhur i shkurtimeve të parashikuara në pikën 4, 5 dhe 6 në asnjë rast nuk mund të rezultojë në afat kohor për marrjen e ofertave më pak se 15 ditë nga data e dërgimit të njoftimit të kontratës.

Megjithatë, nëse njoftimi i kontratës nuk dërgohet me faks ose mjete elektronike, efekti gjithsej i shkurtimeve të parashikuara në pikat 4, 5 dhe 6 në asnjë rast nuk mund të rezultojë në një afat kohor për marrjen e ftesave në një procedurë të hapur më pak se 22 ditë nga data e dërgimit të njoftimit të kontratës.

8. Efekti gjithsej i shkurtimeve të parashikuara në pikat 4, 5 dhe 6 në asnjë rast nuk mund të rezultojë në një afat kohor për marrjen e ftesave për pjesëmarrje në përgjigje të një njoftimi të publikuar sipas nenit 42 pika 1 shkronja (c) ose në përgjigje të një ftese nga subjektet kontraktuese sipas nenit 47 pika 5, prej më pak se 15 ditë nga data e dërgimit të njoftimit të kontratës ose ftesës.

Në procedura të kufizuara dhe me negociim, efekti gjithsej i shkurtimeve të parashikuara në paragrafët 4, 5 dhe 6 në asnjë rast përveç atij të afatit kohor të përcaktuar me marrëveshje të

ndërsjellë në përputhje me pikën 3 shkronja (b), nuk mund të rezultojë në një afat kohor për marrjen e ofertave më pak se 10 ditë nga data e ftesës për ofertë.

9. Nëse, për çfarëdo arsye, dokumentet e kontratës dhe dokumentet mbështetëse ose informacionet shtesë, edhe pse të kërkuara në kohë, nuk janë siguruar brenda afateve kohore të përcaktuara në nenin 46 dhe 47, ose nëse ofertat mund të bëhen vetëm pas një vizite në vend ose pas një kontrolli në vend të dokumenteve në mbështetje të dokumenteve të kontratës, afatet kohore për marrjen e ftesës shtyhen sipas rastit, përveç rastit të afatit kohor të caktuar me marrëveshje të ndërsjellë në përputhje me pikën 3 shkronja b, në mënyrë që të gjithë operatorët ekonomikë të përfshirë të jenë në dijeni të informacionit të nevojshëm për përgatitjen e një oferte.

10. Tabela përmbledhëse e afateve kohore të përcaktuara në këtë nen jepet në Shtojcën XXII.

#### Neni 46

### **Procedurat e hapura: specifikimet, dokumentet dhe informacioni shtesë**

1. Në procedura të hapura, nëse subjektet kontraktuese nuk ofrojnë liri shikimi të drejtpërdrejtë, të plotë dhe të pakufizuar me anë të mjeteve elektronike, në përputhje me nenin 45 pika 6 për specifikimet dhe çdo dokument tjetër mbështetës, specifikimet dhe dokumentet mbështetëse u dërgohen operatorëve ekonomikë brenda gjashtë ditëve nga marrja e kërkesës, me kusht që kërkesa të jetë bërë në kohë përpara afatit për paraqitjen e ofertave.

2. Informacioni shtesë në lidhje me specifikimet, me kusht që të jetë kërkuar në kohë, sigurohet nga subjektet kontraktuese ose departamentet kompetente jo më vonë se gjashtë ditë përpara afatit kohor të caktuar për marrjen e ofertave.

#### Neni 47

### **Ftesa për ofertë ose për negociim**

1. Në procedura të kufizuara dhe procedura me negociim, subjektet kontraktuese njëkohësisht dhe me shkrim ftojnë kandidatët e përzgjedhur të paraqesin ofertat e tyre ose të negociojnë. Ftesa për kandidatët përfshin ose:

- një kopje të specifikimeve dhe dokumentacion mbështetës, ose
- një lidhje ku t'i shohin specifikimet dhe dokumentet mbështetëse të treguara në pikën e parë, nëse ato vihen direkt në dispozicion me anë të mjeteve elektronike në përputhje me nenin 45 pika 6.

2. Nëse specifikimet dhe/ose dokumentet mbështetëse mbahen nga një subjekt tjetër që nuk është subjekti kontraktues përgjegjës për procedurën e shpalljes së kontratës fituese, në ftesë tregohet adresa ku mund të kërkohen këto specifikime dhe dokumente, dhe, sipas rastit, data e mbylljes së afatit për kërkimin e këtyre dokumenteve, shumën që duhet paguar për t'i marrë ato dhe procedurat e pagesës. Departamenti kompetent me të marrë kërkesën i dërgon dokumentacionin operatorit ekonomik.

3. Informacioni shtesë për specifikimet ose dokumentet mbështetëse dërgohet nga subjekti kontraktues ose departamenti kompetent jo më vonë se gjashtë ditë përpara datës përfundimtare të caktuar për marrjen e ftesave, me kusht që të kërkohet në kohë.

4. Ftesa, gjithashtu përmban të paktën sa më poshtë:

- (a) sipas rastit, afatin kohor për të kërkuar dokumente shtesë, si dhe shumën dhe kushtet e pagesës të çdo shume që duhet paguar për këto dokumente;
- (b) datën përfundimtare të marrjes së ofertave, adresën ku drejtohen dhe gjuhën ose gjuhët në të cilat duhet të hartohen;
- (c) faktin e publikimit të njoftimit të kontratës ;
- (d) listën e dokumenteve që duhen bashkëlidhur;
- (e) kriteret për shpalljen e kontratës fituese, nëse nuk tregohen në njoftimin për ekzistencën e sistemit të kualifikimit të përdorur si mjet për ftesën për konkurrim;

(f) shkallën e rëndësisë relative të kriterëve për shpalljen e kontratës fituese, ose sipas rastit, radhën e rëndësisë së këtyre kriterëve, nëse ky informacion nuk jepet në njoftimin e kontratës, njoftimin për ekzistencën e një sistemi kualifikimi ose në specifikime.

5. Nëse një ftesë për konkurrim bëhet me anë të një njoftimi periodik orientues, subjektet kontraktuese ftojnë në vijimësi të gjithë kandidatët të konfirmojnë interesin e tyre në bazë të informacionit të detajuar për kontratën në fjalë përpara fillimit të përzgjedhjes së ofertuesve ose pjesëmarrësve në negociata.

Kjo ftesë përfshin të paktën informacionin e mëposhtëm:

(a) natyrën dhe sasinë, duke përfshirë të gjitha mundësitë në lidhje me kontratat plotësuese dhe, nëse është e mundur, kohën e vlerësuar në dispozicion për të ushtruar këto mundësi për ripërtëritje të kontratave, natyrën dhe sasinë dhe, nëse është e mundur, datat e mundshme të publikimit të njoftimeve të ardhshme për konkurrim për punime, furnizime ose shërbime që duhet të paraqiten për ofertë;

(b) llojin e procedurës: e kufizuar ose me negociim;

(c) sipas rastit, datën e fillimit ose mbarimit të dorëzimit të furnizimeve ose ekzekutimit të punëve ose shërbimeve;

(d) adresën dhe afatin për paraqitjen e kërkesave për dokumentet e ofertave dhe gjuhën ose gjuhët në të cilën duhet të hartohen;

(e) adresën e subjektit që do të shpallë kontratën fituese dhe informacionin e nevojshëm për të siguruar specifikimet dhe dokumentet e tjera;

(f) kushtet ekonomike dhe teknike, garancitë dhe informacionin financiar të kërkuar nga operatorët ekonomikë;

(g) shumën dhe procedurat e pagesës për çdo shumë të pagueshme për të marrë dokumentet e ofertës;

(h) formularin e kontratës që i nënshtrohet ftesës për ofertë; blerje, qiradhënie, blerje me këste, ose çdo kombinim të këtyre; dhe

(i) kriteret e shpalljes së kontratës fituese dhe shkallën e rëndësisë së tyre, ose sipas rastit, radhën e rëndësisë së këtyre kriterëve, nëse ky informacion nuk jepet në njoftimin orientues ose në specifikime ose në ftesën për ofertë ose për negociim.

### Seksioni 3

#### Komunikimi dhe informacioni

#### Neni 48

#### **Rregullat e zbatueshme për komunikimin**

1. I gjithë komunikimi dhe shkëmbimi i informacionit të përmendur në këtë Titull mund të bëhet me anë të postës, faksit, mjeteve elektronike në përputhje me pikat 4 dhe 5, me telefon në rastet dhe rrethanat e përmendura në pikën 6, ose me ndërthurje të këtyre mjeteve, sipas zgjedhjes së subjektit kontraktues.

2. Mjetet e komunikimit të zgjedhura përgjithësisht janë në dispozicion dhe kështu nuk kufizojnë hyrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e tenderimit.

3. Komunikimi dhe shkëmbimi e ruajtja e informacionit bëhet në mënyrë të tillë që të sigurojë ruajtjen e integritetit të të dhënave dhe konfidencialitetit të ofertave dhe kërkesave për pjesëmarrje dhe që subjektet kontraktuese të shqyrtojnë përmbajtjen e ofertave dhe kërkesave për pjesëmarrje vetëm pas mbarimit të afatit të përcaktuar për paraqitjen e tyre.

4. Mjetet që duhen përdorur për komunikimin e mjeteve elektronike, si dhe karakteristikat e tyre teknike, janë jo diskriminuese, përgjithësisht në dispozicion dhe të ndërkëmbyeshme me produktet e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit në përdorim të përgjithshëm.

5. Rregullat e mëposhtme janë të zbatueshme për pajisjet për transmetimin elektronik dhe marrjen e ftesave dhe për pajisjet për marrjen elektronike të kërkesave për pjesëmarrje:



(a) informacioni në lidhje me specifikimet e nevojshme për paraqitjen elektronike të ftesave dhe kërkesave për pjesëmarrje, duke përfshirë kodimin, vihet në dispozicion të palëve të interesuara. Gjithashtu, pajisjet për marrjen elektronike të ofertave dhe kërkesave për pjesëmarrje plotësojnë kërkesat e Shtojcës XXIV;

(b) Shtetet Anëtare, në përputhje me nenin 5 të Direktivës 1999/93/KE mund të kërkojnë që ftesat elektronike të shoqërohen me nënshkrim elektronik të avancuar në përputhje me pikën 1 të saj.

(c) Shtetet Anëtare mund të prezantojnë ose të mbajnë skema të akreditimit vullnetar me synim nivelet e përforcuara të ofrimit të shërbimit të certifikimit për këto pajisje;

(d) ofertuesit ose kandidatët marrin përsipër të paraqesin, përpara mbarimit të afatit kohor të përcaktuar për paraqitjen e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje, dokumentet, certifikatat dhe deklaratat e përmendura në nenin 52 pika 2, 52 pika 3 dhe 54 nëse nuk ekzistojnë në format elektronik.

6. Rregullat e mëposhtme zbatohen për dërgimin e kërkesave për pjesëmarrje:

(a) kërkesat për pjesëmarrje në procedura për shpalljen e kontratave fituese mund të bëhen me shkrim ose me telefon;

(b) nëse kërkesat për pjesëmarrje bëhen me telefon, duhet të dërgohet një konfirmim me shkrim përpara mbarimit të afatit të caktuar për marrjen e tyre;

(c) subjektet kontraktuese mund të kërkojnë që kërkesat për pjesëmarrje të bëra me faks të konfirmohen me postë ose mjete elektronike, nëse kjo është e nevojshme për qëllim të provës ligjore. Çdo kërkesë e tillë, së bashku me afatin kohor për dërgimin e konfirmimit me postë ose mjete elektronike, duhet të tregohet nga subjekti kontraktues në njoftimin e përdorur si mjet për të thirrur për konkurrim, ose në ftesën e përmendur në nenin 47 pika 5.

Neni 49

### **Informacion për aplikantët për kualifikim, kandidatët dhe ofertuesit**

1. Subjektet kontraktuese sa më shpejt që të jetë e mundur njoftojnë operatorët ekonomikë të përfshirë për vendimet e marra në lidhje me përfundimin e një marrëveshjeje kuadër, shpalljen e kontratës fituese, ose pranimin në një sistem dinamik blerjeje, duke përfshirë arsyet për vendimin për moslidhjen e një marrëveshjeje kuadër ose shpalljen e një kontrate fituese për të cilën ka pasur një ftesë për konkurrim ose për të mos rifilluar procedurën, ose për të mos zbatuar një sistem dinamik blerjeje; ky informacion jepet me shkrim nëse subjekteve kontraktuese u kërkohet kjo gjë.

2. Me kërkesë të palës së interesuar, subjektet kontraktuese, sa më shpejt që të jetë e mundur, njoftojnë:

- çdo kandidat të pasuksesshëm për arsyet e refuzimit të aplikimit të tij,

- çdo ofertues të pasuksesshëm për arsyet e refuzimit të ofertës së tij, përfshirë këtu rastet e përmendura në nenin 34 pika 4 dhe 5, arsyet për vendimin e tyre të mos njëjtësimi ose vendimin e tyre që punimet, furnizimet ose shërbimet nuk plotësojnë kërkesat e zbatimit ose funksionale,

- çdo ofertues që ka bërë një ofertë të pranueshme të karakteristikave dhe avantazheve relative të ofertuesit të përzgjedhur, si dhe emrin e ofertuesit të suksesshëm ose palëve në marrëveshjen kuadër.

Koha e nevojshme për këtë në asnjë rrethanë nuk kalon 15 ditë nga marrja e kërkesës me shkrim.

Megjithatë, subjektet kontraktuese mund të vendosin që të mbahet informacioni i caktuar për shpalljen e kontratës fituese ose lidhjen e marrëveshjes kuadër ose për pranimin në një sistem dinamik blerjeje, përmendur në pikën 1, nëse dhënia e këtij informacioni do të pengonte zbatimin e ligjit, ose në të kundërt do të ishte në kundërshtim me interesin publik ose do të cenonte interesat tregtare legjitime të një operatori ekonomik të caktuar, publik ose privat, përfshirë interesat e operatorit ekonomik që ka fituar kontratën, ose nëse do të cenonte konkurrencën e drejtë ndërmjet operatorëve ekonomikë.

3. Subjektet kontraktuese që krijojnë dhe përdorin një sistem kualifikimi njoftojnë aplikantët për vendimin e tyre në lidhje me kualifikimin brenda një periudhe gjashtë mujore.

Nëse vendimi kërkon më shumë se katër muaj nga paraqitja e aplikimit, subjekti kontraktues njofton aplikantin brenda dy muajve nga aplikimi, për arsyet që justifikojnë periudhën më të gjatë dhe për datën deri kur aplikimi i tij do të pranohet ose refuzohet.

4. Aplikantët, kualifikimi i të cilëve është refuzuar, vihen në dijeni për këtë vendim dhe arsyet e refuzimit sa më shpejt që të jetë e mundur dhe në asnjë rrethanë jo më vonë se 15 ditë nga data e vendimit. Arsyet bazohen në kriteret për kualifikim të përmendura në nenin 53 pika 2.

5. Subjektet kontraktuese që krijojnë dhe vënë në punë një sistem kualifikimi mund të përfundojnë kualifikimin e një operatori ekonomik vetëm për arsye të bazuara në kriteret për kualifikim të përmendura në nenin 53 pika 2. Çdo synim për të përfunduar një kualifikim i njoftohet me shkrim operatorit ekonomik të paktën 15 ditë përpara datës kur duhet të mbarojë kualifikimi, së bashku me arsyen ose arsyet që justifikojnë veprimin e propozuar.

#### Neni 50

### **Informacioni që duhet ruajtur në lidhje me kontratat e shpallura fituese**

1. Subjektet kontraktuese për çdo kontratë mbajnë informacionin e duhur që do të jetë i mjaftueshëm për të bërë të mundur që ato që në një datë të mëvonshme të justifikojnë vendimet e marra në lidhje me:

- (a) kualifikimin dhe përzgjedhjen e operatorëve ekonomikë dhe shpalljen e kontratave fituese;
- (b) përdorimin e procedurave pa një ftesë paraprake për konkurrim për shkak të nenit 40 pika 3;
- (c) moszbatimin e Kapitullit III deri në VI të këtij Titulli për shkak të shmangieve të parashikuara në Kapitullin II të Titullit I dhe në Kapitullin II të këtij Titulli.

Subjektet kontraktuese marrin masat e duhura për të dokumentuar ecurinë e procedurave të shpalljes së fituesit të kryera me anë të mjeteve elektronike.

2. Informacioni ruhet të paktën katër vjet nga data e shpalljes së kontratës fituese në mënyrë që subjekti kontraktues të jetë në gjendje gjatë kësaj kohe të sigurojë informacionin e nevojshëm për Komisionin nëse e kërkon ky i fundit.

## KAPITULLI VII

### Zhvillimi i procedurës

#### Neni 51

### **Dispozita të përgjithshme**

1. Për qëllim të përzgjedhjes së pjesëmarrësve në procedurat e shpalljes së tyre fitues:

- (a) subjektet kontraktuese që kanë vendosur rregulla dhe kritere për përjashtimin e ofertuesve ose kandidatëve në përputhje me nenin 54 pika 1, 2 ose 4 i përjashtojnë operatorët ekonomikë që plotësojnë këto rregulla dhe kritere;
- (b) ato i përzgjedhin ofertuesit dhe kandidatët në përputhje me objektivat dhe kriteret objektive të përcaktuara sipas nenit 54;
- (c) në procedura të kufizuara dhe në procedura me negociim me ftesë për konkurrim, sipas rastit, ato e shkurtojnë në përputhje me nenin 54, numrin e kandidatëve të përzgjedhur sipas shkronjave (a) dhe (b).

2. Nëse bëhet një ftesë për konkurrim me anë të një njoftimi për ekzistencën e një sistemi kualifikimi dhe për qëllim të përzgjedhjes së pjesëmarrësve në procedura të shpalljes së fituesit për kontrata specifike që i nënshtrohen ftesës për konkurrim, subjektet kontraktuese:

- (a) kualifikojnë operatorë ekonomikë në përputhje me dispozitat e nenit 53;
- (b) zbatojnë për këta operatorë të kualifikuar ekonomikë ato dispozita të pikës 1 që janë të rëndësishme për procedura të kufizuara ose me negociim.

3. Subjektet kontraktuese verifikojnë që ofertat e paraqitura nga ofertuesit e përzgjedhur të respektojnë rregullat dhe kërkesat e zbatueshme për ofertat dhe shpalljen e kontratës fituese në bazë të kriterëve të përcaktuara në nenin 55 dhe 57.

## Kualifikimi dhe përzgjedhja cilësore

### Neni 52

#### **Njohja e ndërsjellë në lidhje me kushtet administrative, teknike ose financiare dhe vërtetimet, testimet dhe provat**

1. Subjektet kontraktuese, kur përzgjedhin pjesëmarrësit për një procedurë të kufizuar ose me negociim, për të marrë vendimin e tyre për kualifikimin ose kur përditësohen kriteret dhe rregullat:
  - (a) nuk vënë kushte administrative, teknike ose financiare mbi disa operatorë ekonomikë, nëse këto kushte nuk do të viheshin për të tjerët;
  - (b) nuk kërkojnë teste ose prova që do të dyfishonin provën objektive tashmë në dispozicion.
2. Subjektet kontraktuese, kur kërkojnë vërtetime të hartuara nga organet e pavarura që provojnë respektimin nga operatori ekonomik të disa standardeve të sigurimit të cilësisë, mbështeten në sistemet e sigurimit të cilësisë bazuar në një sërë standardesh të rëndësishme europiane të certifikuar nga organet që respektojnë serinë e standardeve europiane në lidhje me vërtetimin. Subjektet kontraktuese njohin vërtetimet ekuivalente nga organet e krijuara në Shtete të tjera Anëtare. Ato pranojnë gjithashtu prova të tjera të masave të njëjta të sigurimit të cilësisë nga operatorët ekonomikë.
3. Subjektet kontraktuese për kontratat për punë dhe shërbime, dhe vetëm në raste të përshtatshme, me qëllim verifikimin e aftësive teknike të operatorit ekonomik, mund të kërkojnë të dhëna për masat e menaxhimit mjedisor që operatori ekonomik do të jetë në gjendje të zbatojë në realizimin e kontratës. Në këto raste, nëse subjektet kontraktuese kërkojnë vërtetime të hartuara nga organe të pavarura që vërtetojnë respektimin nga operatori ekonomik të disa standardeve të menaxhimit mjedisor, ato mbështeten në Skemën e Menaxhimit dhe Kontrollit Ekologjik ose në standardet e menaxhimit mjedisor sipas standardeve të rëndësishme europiane ose ndërkombëtare të certifikuar nga organet që respektojnë legjislacionin komunitar ose standarde të rëndësishme europiane ose ndërkombëtare në lidhje me vërtetimin. Subjektet kontraktuese njohin vërtetimet ekuivalente nga organet e krijuara në Shtete të tjera Anëtare. Ato pranojnë gjithashtu prova të tjera të masave të njëjta të menaxhimit mjedisor nga operatorët ekonomikë.

### Neni 53

#### **Sistemet e kualifikimit**

1. Subjektet kontraktuese sipas dëshirës mund të krijojnë dhe përdorin sisteme kualifikimi të operatorëve ekonomikë. Subjektet kontraktuese që krijojnë ose përdorin sisteme kualifikimi sigurohen që operatorët ekonomikë të jenë në çdo kohë në gjendje të kërkojnë kualifikim.
2. Sistemi sipas pikës 1 mund të përfshijë faza të ndryshme kualifikimi. Ai përdoret në bazë të kriterëve dhe rregullave objektive për kualifikim që përcaktohen nga subjekti kontraktues. Nëse këto kriteret dhe rregulla përfshijnë specifikime teknike, zbatohen dispozitat e nenit 34. Kriteret dhe rregullat mund të përditësohen sipas nevojës.
3. Kriteret dhe rregullat për kualifikim të përmendura në pikën 2 mund të përfshijnë kriteret përjashtimi të renditura në nenin 45 të Direktivës 2004/18/KE për afatet dhe kushtet e përcaktuara në to. Nëse subjekti kontraktues është autoritet kontraktues sipas kuptimit të nenit 2 pika 1 shkronja (a), këto kriteret dhe rregulla përfshijnë kriteret përjashtimi të renditura në nenin 45 pika 1 të Direktivës 2004/18/KE.
4. Nëse kriteret dhe rregullat për kualifikim të përmendura në pikën 2 përfshijnë kërkesa në lidhje me kapacitetin ekonomik dhe financiar të operatorit ekonomik, ky i fundit kur është e nevojshme mund

të mbështetet në kapacitetin e subjekteve të tjera, cilado qoftë natyra juridike e lidhjes ndërmjet tij dhe atyre subjekteve. Në këtë rast operatori ekonomik mund t'i provojë subjektin kontraktues që këto burime janë në dispozicion të tij gjatë periudhës së vlefshmërisë së sistemit të kualifikimit për shembull duke u angazhuar nga këto subjekte për atë qëllim.

Sipas të njëjtave kushte, grupi i operatorëve ekonomikë të përmendur në nenin 11 mund të mbështetet në aftësinë e pjesëmarrësve në grup ose të subjekteve të tjera.

5. Nëse kriteret dhe rregullat për kualifikim të përmendura në pikën 2 përfshijnë kërkesa në lidhje me kapacitetin ekonomik dhe/ose aftësitë profesionale të operatorit ekonomik, ky i fundit kur është e nevojshme mund të mbështetet në kapacitetin e subjekteve të tjera, cilado qoftë natyra juridike e lidhjes ndërmjet tij dhe atyre subjekteve. Në këtë rast operatori ekonomik mund t'i provojë subjektin kontraktues që këto burime do t'i ketë në dispozicion të tij gjatë periudhës së vlefshmërisë së sistemit të kualifikimit për shembull përmes krijimit të një ndërmarrje me pjesëmarrjen e këtyre subjekteve me qëllim vendosjen e burimeve në dispozicion.

Sipas të njëjtave kushte, grupi i operatorëve ekonomikë i përmendur në nenin 11 mund të mbështetet në aftësitë e pjesëmarrësve në grup ose të subjekteve të tjera.

6. Kriteret dhe rregullat për kualifikim të përmendura në pikën 2 vihen në dispozicion të operatorëve ekonomikë sipas kërkesës. Përditësimi i këtyre kriterëve dhe rregullave u komunikohet operatorëve ekonomikë të interesuar.

Nëse një subjekt kontraktues konsideron që sistemi i kualifikimit i disa subjekteve të tjera ose organeve i plotëson kërkesat e tij, ua komunikon operatorëve ekonomikë të interesuar emrat e këtyre subjekteve ose organeve.

7. Mund të mbahet me shkrim regjistri i operatorëve ekonomikë të kualifikuar; ai mund të ndahet në kategori sipas llojit të kontratës për të cilën është i vlefshëm kualifikimi.

8. Subjektet kontraktuese, kur krijojnë ose përdorin një sistem kualifikimi, respektojnë në veçanti dispozitat e nenit 41 pika 3 në lidhje me njoftimet për ekzistencën e një sistemi kualifikimi, dispozitat e nenit 49 pika 3, 4, dhe 5 në lidhje me informacionin që duhet t'i jepet operatorëve ekonomikë që kanë aplikuar për kualifikim, dispozitat e nenit 51 pikë 2 në lidhje me përzgjedhjen e pjesëmarrësve kur bëhet një ftesë për konkurrim me anë të një njoftimi për ekzistencën e një sistemi kualifikimi si dhe dispozitat e nenit 52 për njohjen e ndërsjellë në lidhje me kushtet administrative, teknike ose financiare, vërtetimet, testimet dhe provat.

9. Nëse ftesa për konkurrim bëhet me anë të një njoftimi për ekzistencën e një sistemi kualifikimi, ofertuesit në një procedurë të kufizuar ose pjesëmarrësit në një procedurë me negociuar përzgjidhen nga kandidatët e kualifikuar në përputhje me këtë sistem.

#### Neni 54

### **Kriteret për përzgjedhjen cilësore**

1. Subjektet kontraktuese që përcaktojnë kriteret të përzgjedhjes në një procedurë të hapur veprojnë në përputhje me rregullat dhe kriteret objektive që janë në dispozicion të operatorëve ekonomikë të interesuar.

2. Subjektet kontraktuese që përzgjedhin kandidatët për procedura me negociim ose të kufizuara veprojnë në përputhje me rregullat dhe kriteret objektive që kanë përcaktuar dhe që janë në dispozicion të operatorëve ekonomikë.

3. Në procedura të kufizuara ose me negociim, kriteret mund të bazohen në nevojën objektive të subjektit kontraktues për të ulur numrin e kandidatëve në një nivel që justifikohet nga nevoja për të balancuar karakteristikat e veçanta të procedurës së prokurimit me burimet e kërkuara për ta kryer atë. Numri i kandidatëve të përzgjedhur, megjithatë, merr parasysh nevojën për të siguruar konkurrencën e duhur.

4. Kriteret e përcaktuara në pikën 1 dhe 2 mund të përfshijnë kritere përjashtimi të renditura në nenin 45 të Direktivës 2004/18/KE për afatet dhe kushtet e përcaktuara në to.

Nëse subjekti kontraktues është autoritet kontraktues sipas kuptimit të nenit 2 pika 1 shkronja (a), kriteret dhe rregullat e përmendura në pikën 1 dhe 2 të këtij neni përfshijnë kritere përjashtimi të renditura në nenin 45 pika 1 të Direktivës 2004/18/KE.

5. Nëse kriteret e përmendura në pikën 1 dhe 2 përfshijnë kërkesa në lidhje me kapacitetin ekonomik dhe financiar të operatorit ekonomik, ky i fundit kur është e nevojshme dhe për një kontratë të veçantë mund të mbështetet në kapacitetin e subjekteve të tjera, cilado qoftë natyra juridike e lidhjes ndërmjet tij dhe këtyre subjekteve. Në këtë rast operatori ekonomik i provon subjektin kontraktues që ai ka në dispozicion burimet e nevojshme, për shembull përmes krijimit të një ndërmarrjeje me pjesëmarrjen e këtyre subjekteve për këtë qëllim.

Sipas të njëjtave kushte, grupi i operatorëve ekonomikë i përmendur në nenin 11 mund të mbështetet në aftësitë e pjesëmarrësve në grup ose të subjekteve të tjera.

6. Nëse kriteret dhe rregullat për kualifikim të përmendura në pikën 2 përfshijnë kërkesa në lidhje me kapacitetin ekonomik dhe financiar të operatorit ekonomik, ky i fundit kur është e nevojshme mund të mbështetet në kapacitetin e subjekteve të tjera, cilado qoftë natyra juridike e lidhjes ndërmjet tij dhe atyre subjekteve. Në këtë rast operatori ekonomik i provon subjektin kontraktues që ai ka në dispozicion burimet e nevojshme, përmes krijimit të një ndërmarrjeje me pjesëmarrjen e këtyre subjekteve për këtë qëllim.

Sipas të njëjtave kushte, grupi i operatorëve ekonomikë i përmendur në nenin 11 mund të mbështetet në aftësitë e pjesëmarrësve në grup ose të subjekteve të tjera.

## Seksioni 2

### Shpallja e kontratës fituese

#### Neni 55

#### **Kriteret për shpalljen e kontratës fituese**

1. Pa cenuar aktet ligjore, ose nënligjore kombëtare për shpërblimin e disa shërbimeve, kriteret mbi të cilat subjektet kontraktuese mbështesin shpalljen e kontratave fituese:

(a) nëse kontrata shpallet fituese në bazë të ofertës me përfitim më të madh ekonomik nga këndvështrimi i subjektit kontraktues, janë kritere të ndryshme që lidhen me objektin e kontratës në fjalë siç janë data e dorëzimit ose përfundimit, kostot e funksionimit, efektshmëria e kostos, cilësia, karakteristikat estetike dhe funksionale, karakteristikat mjedisore, meritat teknike, shërbim pas-shitjes dhe asistencë teknike, angazhimi në lidhje me pjesët, sigurimin e furnizimeve, dhe çmimi ose të tjera

(b) është vetëm çmimi më i ulët.

2. Pa cenuar dispozitat e paragrafit të tretë, në rastin e përmendur në pikën 1 shkronja (a) subjekti kontraktues specifikon koeficientin e rëndësisë relative që i jep çdo kriteri të përzgjedhur për të përcaktuar ofertën me përfitim më të madh ekonomik.

ky koeficient ponderimi mund të shprehet duke parashikuar një varg vlerash me gjerësinë e duhur maksimale.

Nëse subjekti kontraktues mendon se ponderimi nuk është i mundur për arsye që mund të dëshmojnë, subjekti kontraktues i përcakton kriteret në rend zbritës të rëndësisë.

Ponderimi relativ ose radha e rëndësisë specifikohen, siç duhet, në njoftimin e përdorur si mjet për ftesën për konkurrim, në ftesën për të konfirmuar interesin e përmendur në nenin 47 pika 5, në ftesën për ofertë ose për të negociuar ose në specifikime.

#### Neni 56

#### **Përdorimi i ankandeve elektronike**

1. Shtetet Anëtare mund të parashikojnë që subjektet kontraktuese të përdorin ankande elektronike.

2. Në procedura të hapura, të kufizuara ose me negociim me ftesë paraprake për konkurrim, subjektet kontraktuese mund të vendosin që shpallja e një kontrate fituese të paraprihet nga një ankand elektronik nëse specifikimet e kontratës mund të përcaktohen me saktësi.

Në të njëjtat rrethana, ankandi elektronik mund të zhvillohet për hapjen e konkurrit të kontratave që do të shpallen fituese sipas sistemit dinamik të blerjes të përmendur në nenin 15.

Ankandi elektronik bazohet:

(a) ose vetëm në çmime nëse kontrata fituese është ajo me çmim më të vogël;

(b) ose në çmime dhe/ose vlera të reja të veçorive të ofertave të treguara në specifikim, nëse kontrata fituese është oferta me përfitim më të madh ekonomik.

3. Subjektet kontraktuese që vendosin të zhvillojnë ankand elektronik e shprehin këtë fakt në njoftimin e përdorur si mjet për të ftuar për konkurrim.

Specifikimet përfshijnë, ndër të tjera, detajet e mëposhtme:

(a) veçoritë vlera e të cilave do t'i nënshtrohet ankandit elektronik, me kusht që këto veçori të jenë të matshme dhe të shprehen në shifra ose përqindje;

(b) çdo kufizim për vlerat që mund të paraqiten, siç rezultojnë nga specifikimet në lidhje me subjektin e kontratës;

(c) informacionin që u vihet në dispozicion ofertuesve gjatë ankandit elektronik dhe, sipas rastit, kur t'u vihet në dispozicion atyre;

(d) informacioni i rëndësishëm në lidhje me procesin e ankandit elektronik;

(e) kushtet sipas të cilave ofertuesit do të jenë në gjendje të bëjnë ofertën dhe sidomos dallimet minimale që, sipas rastit, do të kërkohen kur të bëhet oferta;

(f) informacioni i rëndësishëm në lidhje me pajisje elektronike të përdorura dhe rregullat dhe specifikimet teknike për lidhjen.

4. Subjektet kontraktuese përpara se të fillojë ankandi elektronik bëjnë një vlerësim të plotë fillestar të ofertave në përputhje me kriterin/kriteret e përcaktuara të shpalljes së kontratës fituese dhe shkallës së rëndësisë që caktohet për ato.

Të gjithë ofertuesit që kanë paraqitur oferta të pranueshme ftohen njëkohësisht me mjete elektronike të paraqesin çmime të reja dhe/ose vlera të reja; ftesa përmban të gjithë informacionin e rëndësishëm për sa i përket lidhjes individuale me pajisjen elektronike që përdoret dhe përcakton datën dhe kohën e fillimit të ankandit elektronik. Ankandi elektronik mund të bëhet në disa faza të njëpasnjëshme. Ankandi elektronik nuk mund të fillojë më shpejt se dy ditë pune pas datës së dërgimit të ftesave.

5. Ftesa, nëse kontrata duhet shpallur fituese në bazë të ofertës me përfitim më të madh ekonomik, shoqërohet me rezultatin e një vlerësimi të plotë të ofertës përkatëse të kryer në përputhje me shkallën e rëndësisë e parashikuar në pikën e parë të nenit 55 pika 2.

Ftesa shpreh gjithashtu formulën matematikore që do të përdoret në ankandin elektronik për të përcaktuar renditjen përsëri automatike në bazë të çmimeve të reja dhe/ose vlerave të reja të paraqitura. Kjo formulë përfshin koeficientin e ponderimit të gjitha kriterëve të përcaktuara për të vendosur për ofertën me përfitim më të madh ekonomik, siç e tregon njoftimi i përdorur për ftesën për konkurrim ose specifikimet; megjithatë për këtë qëllim, mesataret reduktohen paraprakisht në një vlerë të specifikuar.

Nëse autorizohen variante, për çdo variant parashikohet një formulë e veçantë.

6. Subjektet kontraktuese gjatë çdo faze të një ankand elektronik u komunikojnë menjëherë të gjithë ofertuesve informacionin e mjaftueshëm për të bërë të mundur renditjet e tyre relative në çdo moment. Ato gjithashtu mund të komunikojnë informacion tjetër në lidhje me çmime ose vlera të tjera të paraqitura, me kusht që kjo të përcaktohet në specifikime. Ato gjithashtu mund të shpallin në çdo kohë numrin e pjesëmarrësve në atë fazë të ankandit. Megjithatë, në çdo rast, ato nuk mund të zbulojnë ofertuesit gjatë çdo faze të ankandit elektronik.

7. Subjektet kontraktuese e mbyllin një ankand elektronik në një ose më shumë mënyrat e mëposhtme:

(a) në ftesën për pjesëmarrje në ankand ato tregojnë datën dhe kohën e caktuar paraprakisht;

(b) nëse nuk marrin më çmime të reja ose vlera të reja që plotësojnë kërkesat në lidhje me dallimet minimale. Në këtë rast, subjektet kontraktuese përcaktojnë në ftesën për pjesëmarrje në ankand kohën që do të lejojnë të kalojnë pas marrjes së ofertave të fundit përpara se të mbyllin ankandin elektronik;

(c) nëse është arritur numri i fazave në ankand, i caktuar në ftesën për pjesëmarrje në ankand. Nëse subjektet kontraktuese vendosin ta mbyllin një ankand elektronik në përputhje me shkronjën (c), mundësisht së bashku me rregullat e përcaktuara në shkronjën (b), ftesa për pjesëmarrje në ankand tregon afatin kohor për çdo fazë të ankandit.

8. Subjektet kontraktuese, pas mbylljes së një ankandi elektronik, shpallin kontratën fituese në përputhje me nenin 55 në bazë të rezultateve të ankandit elektronik.

9. Subjektet kontraktuese nuk mund të përdorin ankandet elektronike të papërshtatshme, as nuk mund t'i përdorin ato në mënyrë të tillë që pengon, kufizon ose shtrembëron konkurrencën ose ndryshon objektin e kontratës, siç e përcakton njoftimi i përdorur si mjet për ftesën për konkurrim dhe specifikimi.

#### Neni 57

### **Ofertat jonormale të ulëta**

1. Nëse, për një kontratë të caktuar, oferta në lidhje me mallrat, punimet ose shërbimet duket jonormalisht e ulët, subjekti kontraktues përpara refuzimit të këtyre ofertave, mund të kërkojë me shkrim detaje të elementëve përbërës të ofertës, që i konsideron të rëndësishme.

Këto detaje në veçanti mund të lidhen me:

- (a) ekonominë e procesit të prodhimit, të shërbimeve të ofruara dhe të metodës së ndërtimit;
- (b) zgjidhjet teknike të zgjedhura dhe/ose çdo kusht përjashtimisht të favorshëm në dispozicion të ofertuesit për furnizimin e mallrave ose shërbimeve ose për ekzekutimin e punës;
- (c) origjinalitetin e furnizimeve, shërbimeve ose punës të propozuar nga ofertuesi;
- (d) respektimin e dispozitave në lidhje me mbrojtjen e punësisimit dhe kushtet e punës në fuqi në vendin ku do të kryhet punimi, shërbimi ose furnizimi;
- (e) mundësinë e ofertuesit për të marrë ndihmë shtetërore.

2. Subjekti kontraktues verifikon këto elemente përbërëse në konsultim me ofertuesin, duke pasur parasysh provën e dhënë.

3. Nëse një subjekt kontraktues përcakton që një ofertë është jonormalisht e ulët për shkak se ofertuesi ka fituar ndihmë shtetërore, oferta mund të refuzohet për këtë arsye vetëm pas konsultimit me ofertuesin nëse ky i fundit nuk mund të provojë, brenda një afati kohor të mjaftueshëm të caktuar nga subjekti kontraktues, që ndihma në fjalë është dhënë në mënyrë të ligjshme. Nëse subjekti kontraktues refuzon një ofertë në këto rrethana, ai e vë në dijeni Komisionin për këtë fakt.

#### Seksioni 3

Ofertat që përfshijnë produkte me origjinë nga vende të treta dhe marrëdhëniet me këto vende

#### Neni 58

### **Oferta që përfshijnë produkte me origjinë nga vende të treta**

1. Ky nen zbatohet për ofertat që mbulojnë produktet me origjinë në vende të treta me të cilat Komuniteti nuk ka lidhur ndonjë marrëveshje shumëpalëshe apo dypalëshe që të sigurojë akses të krahasueshëm dhe të efektshëm për ndërmarrjet komunitare në tregjet e këtyre vendeve të treta. Ky nen nuk cenon detyrimet e Komunitetit ose Shteteve Anëtare të tij në lidhje me vendet e treta.

2. Çdo ofertë e paraqitur për të fituar një kontratë furnizimi mund të refuzohet nëse përqindja e produkteve me origjinë në vende të treta, siç përcaktohet në përputhje me Rregulloren e Këshillit (KEE) nr. 2913/92 të 12 tetorit që përcakton Kodin Doganor Komunitar [30], tejkalon 50% të vlerës totale të produkteve që përbëjnë ofertën. Për qëllime të këtij neni, software i përdorur në pajisjen e rrjetit të telekomunikacionit do të konsiderohet produkt.

3. Nëse dy ose më shumë ofertues, sipas paragrafit të dytë, janë të barabartë sa u përket kritereve të shpalljes së kontratës fituese të përcaktuara në nenin 55, preferohen ato oferta që nuk mund të refuzohen sipas pikës 2. Çmimet e këtyre ofertave konsiderohen ekuivalente për qëllime të këtij neni, nëse ndryshimi i çmimeve nuk tejkalon 3%.

Megjithatë një ofertë nuk do të preferohet ndaj një tjetre, sipas paragrafit të parë, nëse pranimi i saj do ta detyronte subjektin kontraktues të siguronte pajisje me karakteristika teknike të ndryshme nga ato të pajisjes ekzistuese, duke rezultuar në papajtueshmëri, vështirësi teknike në funksionim dhe mirëmbajtje ose kosto disproporcionale.

4. Për qëllimet e këtij neni, vendet e treta për të cilat përfitimi nga dispozitat e kësaj direktive është shtrirë me Vendimin e Këshillit në përputhje me pikën 1 nuk merren parasysh për të përcaktuar përqindjen e produkteve me origjinë në vende të treta, të përmendur në pikën 2.

5. Komisioni mund t'i paraqesë Këshillit një raport vjetor që fillon në gjysmën e dytë të vitit të parë pas hyrjes në fuqi të kësaj direktive për progresin e arritur në negociata shumëpalëshe ose dypalëshe në lidhje me hyrjen e ndërmarrjeve komunitare në tregjet e vendeve të treta në fushat që mbulon kjo direktivë, për çdo rezultat që mund të jetë arritur në këto negociata dhe për zbatimin në praktikë të të gjitha marrëveshjeve që janë lidhur.

Këshilli, që vendos me shumicë të cilësuar me propozim të Komisionit, mund të ndryshojë dispozitat e këtij neni nisur nga këto zhvillime.

#### Neni 59

### **Marrëdhëniet me vendet e treta në lidhje me kontratat për punë, furnizime dhe shërbime**

1. Shtetet Anëtare vënë në dijeni Komisionin për çdo vështirësi, juridike ose faktike, të hasur dhe të raportuar nga sipërmarrjet e tyre në shpalljen e kontratave fituese në vende të treta.

2. Komisioni i raporton Këshillit përpara 31 dhjetorit 2005 dhe rregullisht më pas, për hapjen e kontratave për shërbim në vende të treta dhe për progresin në negociata me këto vende për këtë çështje, sidomos brenda kuadrit të OBT-së.

3. Komisioni, duke ju drejtuar vendit të tretë të përfshirë, përpiqet të zgjidhë çdo situatë me anë të së cilës konstaton, në bazë të raporteve të përmendur në pikën 2 ose informacioni tjetër, që në kontekst të shpalljes së kontratës fituese, një vend i tretë:

(a) nuk u jep ndërmarrjeve komunitare liri hyrjeje të efektshme të krahasueshme me atë që jepet nga Komuniteti për ndërmarrjet nga ai vend; ose

(b) nuk i trajton ndërmarrjet komunitare njësoj si ato kombëtare ose nuk u jep mundësi të njëjta konkurruese me ato që u ofron ndërmarrjeve kombëtare; ose

(c) i trajton ndërmarrjet e vendeve të tjera të treta në mënyrë më të favorshme sesa ndërmarrjet komunitare.

4. Shtetet Anëtare vënë në dijeni Komisionin për çdo vështirësi, juridike ose faktike, të hasur dhe të raportuar nga sipërmarrjet e tyre dhe që janë për shkak të mosrespektimit të dispozitave të së drejtës ndërkombëtare të punës të renditura në Shtojcën XXIII kur këto ndërmarrje janë përpjekur të sigurojnë shpalljen e kontratave fituese në vende të treta.

5. Në rrethanat e përmendura në pikën 3 dhe 4, Komisioni në çdo kohë mund të propozojë që Këshilli të vendosë të pezullojë ose kufizojë, për një periudhë të përcaktuar në vendim, shpalljen fituese të kontratave për shërbim për:

(a) ndërmarrjet e rregulluara me legjislacionin e vendit të tretë në fjalë;

(b) ndërmarrjet e lidhura me ndërmarrjet e specifikuar në shkronjën (a) dhe që e kanë selinë e regjistruar në Komunitet, por që nuk lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe të efektshme me ekonominë e një Shteti Anëtar;

(c) ndërmarrjet që paraqesin oferta që kanë si objekt shërbimet me origjinë në vendin e tretë në fjalë.

Këshilli vendos me shumicë të cilësuar sa më shpejt që të jetë e mundur.



Komisioni mund të propozojë këto masa me nismën e tij ose me kërkesë të një Shteti Anëtar.

6. Ky nen nuk cenon angazhimet e Komunitetit në marrëdhënie me vende të treta, rezultat i marrëveshjeve ndërkombëtare për prokurimin publik, sidomos brenda kuadrit të OBT-së.

### TITULLI III RREGULLAT QË RREGULLOJNË KONKURSET E PROJEKTIMIT

Neni 60

#### **Dispozita të përgjithshme**

1. Rregullat për organizimin e një konkursi projektimi janë në përputhje me pikën 2 të këtij neni dhe me nenin 61 dhe 63 deri në 66 dhe vihen në dispozicion të të interesuarve për pjesëmarrje në konkurs.

2. Pranimi i pjesëmarrësve në konkurse projektimi nuk kufizohet:

(a) duke kërkuar lidhjen me një territor ose një pjesë territori të një Shteti Anëtar;

(b) për arsye që, sipas ligjit të Shtetit Anëtar ku është organizuar konkursi, atyre do t'u kërkohej të ishin persona fizikë ose juridikë;

Neni 61

#### **Kufijtë monetarë**

1. Ky titull nuk zbatohet për konkurse projektimi të organizuara si pjesë e një procedure prokurimi për shërbime vlera e llogaritur e të cilave, pa TVSH, është e barabartë ose më e madhe se 499.000 euro. Për qëllime të kësaj pike, "kufi monetar" është vlera e llogaritur pa TVSH-në e kontratës së shërbimit, duke përfshirë çdo çmim të mundshëm dhe/ose pagesa për pjesëmarrësit.

2. Ky titull nuk zbatohet për konkurse projektimi të organizuara nëse shuma totale e çmimeve të konkursit dhe pagesave për pjesëmarrësit është e barabartë ose më e madhe se 499.000 euro.

Për qëllime të këtij paragrafi, "kufi monetar" është shuma totale e çmimeve dhe pagesave, duke përfshirë vlerën e llogaritur, pa TVSH, të kontratës për shërbim që rrjedhimisht mund të lidhet sipas nenit 40 pika 3 nëse subjekti kontraktues nuk përjashton shpalljen e kontratës fituese në njoftimin e konkursit.

Neni 62

#### **Konkurset e projektimit të përjashtuara**

Ky titull nuk zbatohet për:

(1) konkurset që janë organizuar në të njëjtat raste siç përcaktohet në nenet 20, 21 dhe 22 për kontrata shërbimi;

(2) konkurset në sektorin e shërbimit, të organizuara për ndjekjen në Shtetin Anëtar në fjalë e një veprimtarie për të cilën zbatueshmëria e pikës 1 të nenit 30 është përcaktuar me një vendim të Komisionit ose është gjykuar e zbatueshme sipas pikës 2, paragrafit të dytë ose të tretë ose pikës 5, paragrafit të katërt të atij neni.

Neni 63

#### **Rregullat për shpalljen dhe transparencën**

1. Subjektet kontraktuese që dëshirojnë të organizojnë një konkurs projektimi bëjnë ftesë për konkurrim me anë të një njoftimi për konkurrim. Subjektet kontraktuese që kanë zhvilluar një konkurs projektimi bëjnë të ditur rezultatet me anë të një njoftimi. Ftesa për konkurrim përmban informacionin e përmendur në Shtojcën XVIII dhe njoftimi i rezultateve të një konkursi projektimi

përmban informacionin e përmendur në Shtojcën XIX në përputhje me formatin e formularëve standardë të miratuar nga Komisioni në përputhje me procedurën e nenit 68 pika 2.

Njoftimi i rezultateve të konkursit të projektimit i dërgohet Komisionit brenda dy muajve nga mbyllja e konkursit të projektimit dhe sipas kushteve që duhen përcaktuar nga Komisioni në përputhje me procedurën e përmendur në nenin 68 pika 2. Në këtë drejtim, Komisioni respekton aspektet delikate tregtare që mund të vënë në dukje subjektet kontraktuese kur dërgojnë këtë informacion, në lidhje me numrin e projekteve ose planeve të marra, identitetin e operatorëve ekonomikë dhe çmimeve të ofruara.

2. Neni 44 pika 2 deri në 8 zbatohet edhe për njoftimet në lidhje me konkurse projektimi.

#### Neni 64

### **Mjetet e komunikimit**

1. Neni 48 pika 1, 2 dhe 4 zbatohet për të gjitha komunikimet në lidhje me konkurset.

2. Komunikimi, shkëmbimi dhe ruajtja e informacionit janë të tilla që të sigurojnë ruajtjen e integritetit dhe konfidencialitetit të të gjithë informacionit të komunikuar nga pjesëmarrësit në konkurs dhe që juria të sigurojë përmbajtjen e planeve dhe projekteve vetëm pas mbarimit të afatit kohor për paraqitjen e tyre.

3. Rregullat e mëposhtme zbatohen për pajisjet për marrjen elektronike të planeve dhe projekteve:

(a) në dispozicion të palëve vihet informacion në lidhje me specifikimet që është i nevojshëm për prezantimin e planeve dhe projekteve me mjete elektronike, duke përfshirë kodimin. Gjithashtu, pajisjet për marrjen elektronike të planeve dhe projekteve plotësojnë kërkesat e Shtojcës XXIV;

(b) Shtetet Anëtare mund të prezantojnë ose të mbajnë skema të akreditimit vullnetar me synim nivelet e përforcuara të ofrimit të shërbimit të certifikimit për këto pajisje.

#### Neni 65

### **Rregullat për organizimin e konkurseve të projektimit, përzgjedhjen e pjesëmarrësve dhe jurisë**

1. Në organizimin e konkurseve të projektimit, subjektet kontraktuese zbatojnë procedurat që janë përshtatur me dispozitat e kësaj direktive.

2. Nëse konkurset e projektimi kufizohen me një numër të kufizuar pjesëmarrësish, subjektet kontraktuese përcaktojnë kriteret e qarta dhe mosdiskriminuese përzgjedhjeje. Në çdo rast, numri i kandidatëve të ftuar për të marrë pjesë duhet të jetë i mjaftueshëm për të siguruar konkurrencën e vërtetë.

3. Juria përbëhet ekskluzivisht nga persona fizikë që janë të pavarur nga pjesëmarrësit në konkurs. Nëse pjesëmarrësve në konkurs u kërkohet një kualifikim i veçantë profesional, të paktën një e treta e anëtarëve të jurisë duhet të jetë të njëjtin kualifikim ose kualifikim të njëjtë.

#### Neni 66

### **Vendimet e jurisë**

1. Juria është autonome në vendimet ose opinionet e saj.

2. Ajo shqyrton planet dhe projektet e paraqitura nga kandidatët në mënyrë anonime dhe vetëm në bazë të kriterëve të përcaktuara në njoftimin e konkursit.

3. Ajo shënon renditjen e projekteve në një raport, të nënshkruar nga anëtarët e saj, të bazuar në meritat e çdo projekti, së bashku me shënimet dhe çdo pikë që mund të kërkojë qartësim.

4. Anonimiteti mund të respektohet deri në marrjen e një opinionit ose vendimit nga juria.

5. Kandidatët mund të ftohen, nëse është nevoja, t'ju përgjigjen pyetjeve që juria ka shënuar në procesverbal për të qartësuar çdo aspekt të projekteve.

6. Dialogu ndërmjet anëtarëve të jurisë dhe kandidatëve mbahet në procesverbal.

#### TITULLI IV

#### DETYRIME STATISTIKORE, KOMPETENCA EKZEKUTIVE DHE DISPOZITA TË FUNDIT

##### Neni 67

#### **Detyrime statistikore**

1. Shtetet Anëtare, në përputhje me rregullimet e përcaktuara sipas procedurës të parashikuar në nenin 68 pika 2, sigurojnë që Komisioni të marrë çdo vit një raport statistikor në lidhje me vlerën totale, të ndarë sipas Shtetit Anëtar dhe sipas kategorisë të veprimtarisë të cilës i referohen Shtojcat I deri në X, të kontratave të fituara nën kufirin monetar të përcaktuar në nenin 16, por që nëse nuk do të ishin këta kufij monetar do të mund të mbuloheshin nga kjo direktivë.

2. Në lidhje me kategoritë e veprimtarisë të cilat përmenden në Shtojcat II, III, V, IX dhe X, Shtetet Anëtare sigurojnë që Komisioni të marrë një raport statistikor për kontratat e shpallura fituese jo më vonë se 31 tetor 2004 për vitin e mëparshëm dhe përpara 31 tetorit të çdo viti më pas, në përputhje me rregullat që duhen përcaktuar sipas procedurës të parashikuar në nenin 68 pika 2. Raporti statistikor përmban informacionin e kërkuar për të verifikuar zbatimin e duhur të Marrëveshjes.

Informacioni i kërkuar sipas paragrafit të parë nuk përfshin informacionin e përfshirë në lidhje me kontratat për shërbimet K&ZH të renditura në kategorinë 8 të Shtojcën XVII A, për shërbimet e telekomunikacionit të renditura në kategorinë 5 të Shtojcës XVII, pozicionet FPP të të cilit janë të njëjta me kodet CPC 7524, 7525 dhe 7526, ose për shërbimet e renditura në Shtojcën XVII B.

3. Rregullat sipas pikës 1 dhe 2 përcaktohet në mënyrë të tillë që të sigurohet:

(a) për thjeshtimin administrativ, përjashtimi i kontratave me vlerë më të ulët, me kusht që të mos rrezikohet dobia e statistikave;

(b) respektimi i natyrës konfidenciale të informacionit të ofruar.

##### Neni 68

#### **Procedura në Komitet**

1. Komisioni ndihmohet nga Komiteti Këshillues për Kontratat Publike i krijuar me nenin 1 të Vendimit të Këshillit 71/306/KEE [31] (quajtur më poshtë “Komiteti”).

2. Kur përmendet kjo pikë zbatohen nenet 3 dhe 7 të Vendimit 1999/468/KE duke pasur parasysh dispozitat e nenit 8 të tij.

3. Komiteti miraton rregulloren e tij të brendshme.

##### Neni 69

#### **Rishikimi i kufijve monetarë**

1. Komisioni verifikon kufijtë monetarë të përcaktuara në nenin 16 çdo dy vjet nga 30 prilli 2004 dhe nëse është e nevojshme në lidhje me pikën e dytë, i rishikon ato në përputhje me procedurën e parashikuar në nenin 68 pika 2.

Llogaritja e vlerës së këtyre kufijve monetarë bazohet në vlerën ditore mesatare të euros, të shprehur në SDR, gjatë 24 muajve në përfundim të ditës së fundit të gushtit që i paraprin rishikimit, i cili hyri në fuqi që nga 1 janari. Vlera e kufijve monetarë të rishikuar, kur është e nevojshme, rumbullakoset me të mijten euro më të afërt për të siguruar respektimin e kufijve monetarë në fuqi të parashikuar nga marrëveshja, të shprehura në SDR.

2. Në të njëjtën kohë me rishikimin sipas pikës 1, Komisioni, në përputhje me procedurën e parashikuar në nenin 68 pika 2, i harmonizon kufijtë monetarë të përcaktuar në nenin 61 (konkurse projektimi) me kufijtë monetarë të rishikuar të zbatueshëm për kontratat për shërbime.

Vlerat e kufijve monetarë të përcaktuar në përputhje me pikën 1 në valutë kombëtare të Shteteve Anëtare që nuk marrin pjesë në Bashkimin Monetar, në parim, rishikohen çdo dy vjet nga 1 janari 2004. Llogaritja e kësaj vlere bazohet në vlerat ditore mesatare të këtyre valutave, të shprehura në euro, gjatë 24 muajve që përfundojnë ditën e fundit të gushtit që i paraprin rishikimit i cili hyn në fuqi nga 1 janari.

3. Kufijtë monetarë të rishikuar të përmendur në pikën 1, vlerat e tyre në valutë kombëtare dhe kufijtë monetar të harmonizuar të përmendur në pikën 2 publikohen nga Komisioni në Gazetën Zyrtare të Bashkimit European në fillim të muajit nëntor pas rishikimit të tyre.

#### Neni 70 **Ndryshimet**

Komisioni, në përputhje me procedurën e parashikuar në nenin 68 pika 2 mund të ndryshojë:

- (a) listën e subjekteve kontraktuese në Shtojcat I deri në X në mënyrë që të plotësojnë kriteret e përcaktuara në nenet 2 deri në 7;
- (b) procedurat për hartimin, transmetimin, marrjen, përkthimin, mbledhjen dhe shpërndarjen e njoftimeve të përmendura në nenet 41, 42, 43 dhe 63;
